



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec



01 Nr. 06/25
Rahovec, 19.6.2025

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal që të marrin pjesë në mbledhjen e **gjashtë (6)**, e cila do të mbahet më **30 qershor 2025 (e hëne)**, me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), 2026-2028;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor) ZK-Rahovec;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve 2025-2028;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 nr.47/25, i datës 29.4.2025, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV);
7. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor (janar – qershor 2025) të kryetarit të Komunës;
8. Shqyrtimi i Informatës rreth aktiviteteve të KKS-së për 6 mujorin e parë të vitit 2025;
9. Shqyrtimi i Raportit rreth aktiviteteve të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për 6 mujorin e parë të vitit 2025;
10. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e mbeturinave në Komunën e Rahovecit për 6 mujorin e parë të vitit 2025.

KRYESUESI I KUVENDIT

Arbër Zenuni



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **30.05.2025**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi se kuorumi për mbajtjen mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 31 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 22.

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, Nënkyetar **z. Fatmir Iska**, i nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-i medie, të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje të **pestë** me radhë të vitit 2025, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-01022-0, ZK-Hoçë e Madhe;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-01022-0, ZK-Hoçë e Madhe;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-01830-0, ZK-Rahovec- Respektivisht lokali te parku i qytetit;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-01830-0, ZK-Rahovec - Respektivisht lokali te parku i qytetit;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.46/25 të datës 29.04.2025, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale për rastet e veçanta;

Shtesë: Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 50 vjet, P-02240-76, zona kadastrale Rahovec.

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të kuvendit, përveç këtyre 7 pikave kemi edhe një pikë shtesë, që ka të bëjë me vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për 50 vjet, P- 02240-76, zona kadastrale Rahovec. E vendosim në votim, kush është “për”?... Konstatohet që unanimisht (20) votohet pika shtesë e rendit të ditës. Të nderuar anëtarë, tani e vendosim në votim rendin e ditës komplet. Kush është “për”?... Konstatohet që unanimisht (20) votohet rendi i ditës për sot.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit për fjalën! Përshëndetje për të gjithë! Unë e pata një kërkesë, por së pari ngushëllime për familjen Cena, për humbjen e kryefamiljarit të tyre Musa Cena, ish zyrtarit komunal, drejtorit të Ekonomisë dhe ish zv.ministrit. Andaj ju ftoj që, për bashkëpunëtorin e juaj dhe për të gjithë ata që e kanë njohur, si kuvend në shenjë respekti të mbajmë një minut heshtje.

Kryesuesi: ... Nderime veprës së Musa Cenës dhe i përjetshëm qoftë kujtimi për të!

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: Nëse dikush ka diçka rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Unanimisht (21) aprovohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:

Vlora Vuçiterna – Çmega: Përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, drejtorët e drejtorive, kolegë asambleistë, media dhe për të gjithë të tjerët që na përcjellin. Meqenëse kryetari kohëve të fundit e ka bërë si traditë citimin e ndonjë thënie të urtë, atëherë po e filloj edhe unë me disa vargje të shkurtëra në lidhje me punësimet partiake:

Në vendin tim s'ka rëndësi çfarë di,

Mjafton të kesh shokë të fortë në parti.

Diploma vlen vetëm për t'u varur në mur

Kur vendin e punës e jep një "burrë"!

Atëherë, unë si zakonisht pyetjet, kërkesat, kritikën e ndonjëherë edhe lëvdatat i drejtoj tek Drejtoria e Shëndetësisë. Gjithashtu edhe kësaj here njëjtë, por pak më lehtë se sa herave të tjera drejtoreshë. E kam një pyetje se çka po ndodh me mëditjet e stafit të QKMF-së? Pse disa po paguhet e disa jo? Kam informata të sigurt, mos të them të sakta 100% që mëditjet në tërësi nuk paguhet. Dje, si Komiteti i Shëndetësisë i kishim disa vizita në kuadër të rendit të punës, ndër to e kishim edhe vizitën në Hendikos. Drejtori aty na informoi më shumë se si funksionon Hendikosi. Ai kishte parashtruar disa kërksa, të cilat i kam edhe kopje. Ndër kërkesat e tij ishte për mjete të fizioterapisë që për një kohë janë mbajtur në QKMF. A keni marrë ndonjë vendim, se ku do të gërgohen ato mjete? Ku janë për momentin ato mjete? Meqenëse Hendikosi i ka mbi 1000 anëtarë, besoj që është e nevojshme që këto mjete të dërgohen në Hendikos, duke marrë parasysh që ka fizioterapeutë vullnetarë që do të marrin pjesë.

Edonë Kryeziu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! I nderuar kryetar, drejtorë të drejtorive, monitorus dhe të gjithë të tjerët që na përcjellin. Po e filloj fjalimin me një mesazh të ndjeshëm dhe të prekshëm që më ka arritur mua personalisht nga një familjar i një pacienti të hemodializës: "Hajde kqyre çfarë ushqimi hajnë pacientët e hemodializës". E nderuara drejtoreshë, i nderuari kryetar! A jeni ndalë për një çast për të menduar që nëse ky ushqim është për t'u ngrënë nga një njëri që ka nevojë për një kujdes të përditshëm shëndetësor. Ushqimi është pothuajse pa shije, nga skara dhe gjë që e dimë që ushqimet nga skara janë të pashëndetshme për të gjithë ne e le më për këtë kategori. E dimë që e keni pasë një kontratë, mirëpo e keni ndërprerë si pasojë e krizës financiare. Kur them që s'ka mjete të mjaftueshme, këtë e ka pranuar edhe drejtori i QKMF-së, Elbunit Kryeziu, ku ka potencuar që komuna nuk ka mjete financiare për shkak të borxheve dhe përmbaruesi i ka tërhequr nga buxheti komunal. Kryetar, nëse ndalemi dhe i analizojmë darkat dhe drekat zyrtare të juajat, janë vlerë që mund t'i mbulojnë shpenzimet e këtyre pacientëve, pasi fatmirësisht nuk është numër i madh, por bëhet fjalë vetëm për 20 pacientë. Nëse ekzekutivi luan dhe manipulon këtë kategori, atëherë çfarë mund të presin qytetarët tjerë. Drejtoreshë, me gjithë sinqeritetin të lus që ta bësh një zgjidhje sa më shpejt që është e mundur dhe nëse komuna nuk ka fonde të mjaftueshme, atëherë dil me një thirrje për sponsorë, pasi e dimë që Rahoveci së bashku me rrethinë kanë një zemër të madhe. Kjo nuk duhet të shihet si politikë, por si çështje njerëzore. Një pyetje të fundit për Drejtorinë e Shërbimeve Publike: Drejtor, në shumë seanca kam pasur kërkesë që t'i vizitosh nga afër rrugët brenda fshatit Xërxë. Kubëza të hapura, gropa të hapura dhe puseta të hapura. Kërkesë e banorëve është mirëmbajtja e tyre dhe instalimi i ndriçimit në rrugën "Hekurudha", e cila është bërë e pakalueshme gjatë natës për shkak të mungesës së ndriçimit.

Fahrije Lushi: I nderuar kryesues, kryetar! Unë dua t'i ngris disa shqetësime dhe kërkesa në të njëjtën kohë. Ju drejtohem personalisht juve kryetar, lidhur me problemin e shkaktoar kur e keni bërë kanalin e kullimit të ujit, në hyrje të fshatit Malësi e Vogël. Punimet i keni filluar në fushatën e zgjedhjeve, keni pasur mundësi që ta lini për tani, në korrik, sepse kultura e grurit e përfundon sezonën në muajin korrik. A keni treguar të paktën një lloj konsiderate dhe a keni biseduar me fermerin, thjesht për t'u solidarizuar, apo edhe t'i kërkuar falje që një pjesë të konsiderueshme të

asaj kulture ia keni degraduar. Gjithashtu, nga banorët e fshatit Malësi të Vogël kam një kërkesë, që ka të bëjë me rrugën afër shkollës fillore dhe që lidhet direkt në anën e dhjathtë, është fjala për rrugën "Kosova e Re". Kjo rrugë është ruajtë e banueshme, por nuk është ndërmarrë asnjëherë ndonjë veprim. I nevojitet pajetër edhe ndriçimi. I drejtohem drejtorit të Shërbimeve Publike, i cili afër e ka Sarandën që ka mundur t'ia kujtojë këtë rrugë. Në fshatin Ratkoc, rruga në lagjen "Morina", ku janë bërë dy shkatërrime të rrugës nga KRU Gjakova. Kjo kërkesë është ngritur edhe më herët nga unë. Në fillim të rrugës "Batalioni i tretë" në Ratkoc është mbyllur kanali i kullimit të ujërave atmosferike me anë të një ndërhyrje jo të drejtë dhe kur grumbullohen ujërat atmosferikë e vërshojnë pjesën e asaj rruge. Qytetarët kanë shqetësime kur ka reshje më të mëdha. Kërkoj nga kryetari të merret pak me shqetësimet e qytetarëve.

Melinda Iska Oruçi: Faleminderit kryesues! Përsëritje për juve, kryetarin, nënkryetarin, drejtorët, kolegët asambleistë dhe të gjithë të pranishmit. Sot, në këtë mbledhje të kuvendit do të paraqes një shqetësim që gjendet në sektorin e shëndetësisë – në sektorin më të ndjeshëm, atë të urgjencës. Ne, çdo ditë ballafaqohemi me probleme urgjente dhe jemi të rrethuar me faktorë që shkaktojnë probleme për shkak të dinamikës së jetës, si në shtëpi, rrugë, punë etj... Në vitin 2015, ne si parti kemi menduar që ta funksionalizojmë sektorin e urgjencës – pranë QKMF-së në Rahovec. Kjo gjë është e parapare me ligjet në fuqi. Gjithashtu edhe në atë kohë është debatuar në kuvend, si dhe kuvendi i atëhershëm e ka miratuar sektorin urgjent në statutin e QKMF-së. Nga drejtoria e atëhershme i është dhënë mbështetje kandidatit, i cili ka shprehur gatishmëri që të marrë specializimin e mjekësisë emergjente, dr. Skender Fetahu, i cili për 5 vite specializim ka qenë i mbështetur nga komuna jonë. Pas kryerjes së specializimit, dr. Skenderi kthehet në QKMF në Rahovec dhe fillon organizimin e punës në sektorin e emergjencës. Për shkak të infrastrukturës ende të papërfunduar, mungesës së mjeteve të punës, si dhe pandemisë Covid 19 ka pasur ngecje në këtë drejtim. Me lëshimin e objektit të ri, sigurimin e pajisjeve për sektorin e urgjencës – disa nga Ministria e Shëndetësisë dhe disa nga donacione të tjera, trajnimi bazë të stafit infermieror me program të akredituar nga oda e infermierëve të Kosovës, sektori i urgjencës fillon punën e plotë. 1 prill 2023, 12 orë ditën – 12 orë natën. Shërbim 24/7 me 4 ndërrime dhe konform ligjeve në fuqi për urgjencë mjekësore-paraspitalore. Gjatë kësaj periudhe është kryer punë profesionale e krahueshme me emergjencë spitalore, sepse është kryer edhe procedura më e avancuar emergjente – intubimi në disa raste, një ndër ta ka qenë edhe një familjar i imi dhe me rastin e transferimit të kujdesit intensiv në Gjakovë, kemi marrë edhe komplimente për këtë intervenim. Doktor Skenderi, me rastin e kryerjes së obligimit në institucionet tona është pranuar si staf i rregullt në spitalin rajonal në Gjakovë, spitali ku të gjithë pacientët e komunës tonë i marrin shërbimet sekondare. Në letërën e dorëheqjes, përveç falenderimeve të shprehura për institucionet tona, ka shprehur edhe gatishmërinë për të kontribuar përsëri në institucionet tona – në avancimin e shërbimeve shëndetësore. Gjatë kësaj kohe ka kontribuar shumë, ngase ka qenë urëlidhëse në mes dy institucioneve dhe ka bërë një bashkëpunim të mirë në mes ekipeve të dy institucioneve dhe përfituesit më të mëdhenj kanë qenë pacientët e komunës sonë. Në kërkesën e protokoluar të ju kryetar dhe drejtorisë për shëndetësi më datë 30 janar 2025 dhe i gjithë stafi i sektorit të urgjencës ka bërë kërkesë më datë 18 shkurt 2025, që doctor Skenderit t'i mundësohet qëndrimi në këto institucione për shkak të përgatitjes profesionale dhe bashkëpunimit me staf. Angazhimi i dr. Skenderit do të ishte shumë i rëndësishëm, sepse në çdo rast ballafaqohemi me raste emergjente. Në kërkesën që e ka bërë stafi, paralajmërohet se me iken e doktor Skenderit niveli i shërbimeve do të jetë më ulët. Kryetar, a i keni analizuar këto kërkesa dhe cila ka qenë arsyeja e mosrealizimit të kësaj kërkesë? Këtu e kam edhe kërkesën e stafit dhe nënshkrimet e 24 punëtorëve për rikthimin e dr. Skenderit.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të ekzekutivit, kolegë anëtarë të kuvendit komunal, përfaqësues të KFOR-it, qytetarë të komunës së Rahovecit. I kam disa çështje për diskutim. Drejtori i bujqësisë sapo na dorëzoi një përgjigje rreth vlerësimeve të dëmeve në bujqësi – në sektorin e vreshtarisë dhe pemëtarisë. Pyetja ime ka qenë që disa bujq janë ankuar që nuk ka anëtar komisioni. Ti e paske deklaruar që komisioni e ka këtë përbërje dhe komuna është e përfaqësuar me dy përfaqësues nga shoqata e vreshtarëve. Ky komision që është, a do ta bëjë raportin

final për krejt vreshtarët e komunës së Rahovecit? Kur do të paraqitet ky raport final. Çështja e rrugëve fushore, kërkoj që në seancën e radhës të na njoftoni për listën e rrugëve fushore të intervenuara nga komuna, përgjatë vitit 2024. Para 2-3 dite ka filluar intervenimi për rregullimin e rrugës fushore, Hoçë e Vogël – Nagac. Një kërkesë e vazhdueshme. A do të vazhdojë edhe në fshatin Brestoc dhe a do të kompetohen të gjitha rrugët fushore në Hoçë e Vogël? Te Drejtoria e Arsimit – çështja e bursave. Në vitin e kaluar e kam ngritë një shqetësim, që dy anëtarë të të njëjtës familje nuk kanë marrë bursë. Unë kam kërkuar që pavarësisht kësaj, komuna duhet të kujdeset dhe t'ju ofrohet bursa. Këtë vit keni dhënë, e pashë listën që po. Cilat kanë qenë plotësim-ndryshimet që i keni bërë në listën e kriterëve? Te Shërbimet Publike: kur do të fillojë kubëzimi i rrugëve lokale?

Kryetari: Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit, media, përfaqësues të LMT-së, të nderuar të pranishëm. Është me rëndësi të ketë sqarim për një çështje që ishte para disa dite shumë aktuale – çështja e ushqimit për pacientë të hemodializës dhe është mirë të sqarohet. Drejtoria për Shëndetësi e ka sqaruar edhe para opinionit përmes mediave. Besoj që edhe drejtori i QKMF-së e ka bërë të njëjtën gjë. Nga ana e mediave ka pasur edhe biseda me pacientë. E vërteta zyrtare dhe një e vërtetë që është vështirë të demantohet është kjo: E para, pacientën prej fillimit e deri tani kanë pasur ushqim. Iniciativa për sektorin e hemodializës ka nisur prej Florie Bashnjakut, ka vazhduar me rezultate të prekshme Idriz Vehapi (unë jam korrekt) dhe kanë vazhduar përpjekjet që të hapet reparti i hemodializës si njësi satelit e spitalit rajonal “dr. Daut Mustafa”. Së fundi, përmes Ministrisë së Shëndetësisë, spitalit rajonal të Prizrenit, vullnetit dhe vendosshmërisë së komunës që ky repart duhet të hapet, si dhe ShSKUK-së që ka qenë i përfshirë në këtë proces. Ky ka qenë lajmi më i gëzuar për qytetarët e Rahovecit, posaçërisht për familjet e atyre që i nënshtrohen këtij procesi 2 herë në javë. Numri i pacientëve është 18. Në javë kryhen rreth 54 dializa dhe në muaj 216 dializa. Mos ta harrojmë faktin që ky repart është në kompetencë të plotë të spitalit rajonal të Prizrenit. Objekti është i yni, salla është e jona, pajisjet mjekësore janë tonat dhe stafi menaxhohet tërësisht nga spitali rajonal i Prizrenit, kuptohet në bashkëveprim sipas nevojës edhe me ShSKUK-në dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Unë jam i lumtur para jush, para qytetarëve dhe para pacientëve që deri sa të funksionalizohet si tërësi, si komunë kemi marrë përsipër, meqenëse ky repart është në mjediset tona të pronës komunale. Gjithashtu kemi vazhduar edhe me investime shtesë, sepse vazhdimisht ka pasur kërkesa të reja. Si komunë kemi marrë përsipër: rrymën e paguajmë ne, ujin, punëtorët teknikë mirëmbajtës, shpenzimet e derivateve për barjten e pacientëve, derivatet për gjeneratorë, analizat për pacientë, barnat esenciale, larja e çarçafëve. Marrëveshja me dr. Shaip Krasniqi – Specialist i Mjekësisë Familjare është bërë në koordinim me spitalin rajonal, Ministrinë e Shëndetësisë dhe ShSKUK-në. Ne e bëjmë edhe mirëmbajtjen e objektit, si dhe ne merremi me mbetjet për asgjësim që i dërgojmë në Prizren. Ne e kemi edhe një marrëveshje mirëkuptimi, deri sa ata ta marrin përsipër tërësisht e kemi marrë përsipër që ne ta sigurojmë ushqimin. Mos të harrojmë që, nuk kemi pasur kontratë, sepse nuk mund të kemi kontratë kur nuk e kemi pasur të planifikuar. Në baza humane kemi gjetur zgjidhje dhe kemi marrë shujta për këta pacientë këtu në Rahovec ka 3.5€. Kjo shumë që u bë temë është rreth 2000€ dhe është mirë që bëhen temë 2000€, sepse na jep vullnet edhe më shumë për punë. Në plan të prokurimit, për këtë vit e kemi planifikuar që ta hapim një kontratë që për një vit të sigurojmë ushqim. Çka ka ndodhur në proces? Mjetet që janë planifikuar janë marrë nga thesari i Ministrisë së Financave për mbulimin e kontratës kolektive me procedurë përmbartimore. Ndërkohë edhe fituesi është shpallur dhe ndërmjet kësaj kohe janë marrë mjetet prej kategorisë mallra dhe shërbime. Viteve të fundit nuk ka mundësi të nënshkruash kontratë, nëse nuk ka mjete financiare. Thesari i ka tërhequr pasi e kemi shpallur fituesin dhe nuk kemi mundur të lidhim kontratë, sepse nuk ka mjete financiare. Përsëri ne kemi vazhduar t'i trajtojmë me ushqim pacientëve në hemodializë. Dikush i përmendi ndjenjat. Në baza ditore e kemi këtë ndjeshmëri. Sigurisht që kur e kemi dhënë në ushqimin ka qenë më i mirë. Tani ushqimi vjen prej Prizrenit, meqenëse tani ne skemi kontratë, si dhe iu kemi thënë që të bëjnë zgjidhje vet, pra prej spitalit të Prizrenit, sepse ata duhet të gjejnë zgjidhje për ushqim më të freskët etj... Ky që është ankuar në OShP, që me të drejtë ka pritur ta nënshkruaj kontratën, 10€ e ka pasur shujtën. Një pleskavicë e vogël, ndonjëherë mish të bardhë dhe ndonjëherë sallatë. Ndërsa ne, me 3.5€ dhe në të shumtën e rasteve në mënyrë vullnetare, sepse

"Shtavica" ka dashur verë, nuk ka aplikuar për kontratë. Nëse do të isha shef i prokurimit, do të më dukej 10€ shumë. Kështu që, në një mënyrë dubet të them që jam i lumtur që është anuluar kjo kontratë, por nuk jam i lumtur që na kanë marrë paratë. Unë do ta thërras drejtorin e spitalit rajonal të Prizrenit dhe shefin e hemodializës në Prizren, sepse ky repart i yni i subornohet spitalit të Prizrenit nga pikëpamja e kompetencave. Mos ta harrojmë faktin që asnjë ditë nuk kanë qenë pa ushqim. Nga komuna jonë të gjithë pacientët aty do të ndihen gjithmonë të përkrahur. E rëndësishme është që hemodializa është duke funksionuar. Ta krijojmë një shprehje për të mirë, për hir të pacientëve dhe për hir të këtij reparti që e kemi dhuratë, pas një punë të madhe të përbashkët. Sa i përket Urgjencës: Urgjencia funksionon mirë, por kuptohet që është humbje e madhe që se kemi Skender Fetahun. Skenderi është specialist i mirë. Ka edhe një ndërhyrje të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ShSKUK-së, sepse moti e kanë kërkuar si kuadër. Unë jam munduar ta ndal. Po ai ka vendosur ashtu, tëk e fundit ndoshta e ka edhe për ambicie specialistike. Sidoqoftë, ai është këtu dhe do të shohim nëse kemi mundësi së paku t'i lëmë gjysmë orari, por duhet të jemi në dijeni se në qfarë gjendje financiare jemi në raport me thesarin. Doktor, ka qenë anëtar i devotshëm i Lidhjes Demokratike të Kosovës, është mjeku i parë që është punësuar në komunën e Rahovecit, kur unë kam qenë kryetar i komunës. Ka mjekë të punësuar të të gjitha partive, ka mjekë që janë pa parti. Në të gjitha pushtetet janë punësuar mjekë. Luigj Gurakuqi i ka dija vargje:

"Veç një qëllim i natë t'bën me duru,

Zemrën ta forcon,

Ndër kundërshtime, kurrë s'vyn me u ligështu,

Mjerë ai që nuk qëndron".

I kuptoj rivalitetet politike. Ju ftoj ta bëni një listë dhe e shihni se sa janë me një parti, sa në parti tjetër e sa me një lëvizje, si dhe sa janë pa parti. Nëse do të ishte kështu siç mendoni, unë sot do të isha kryeministër para Albin Kurtit. Sikur të ishte njëmend kështu dhe ashtu siç ka dëshirë dikush të thur edhe vargje, atëherë besoj që balotazhi nuk do të ekzistonte në komunë të Rahovecit dhe besoj që kësaj radhe nuk do të ketë balotazh.

Vlora Vuçiterna – Çnuega: Dje, bashkë me anëtarët e komitetit ishim për vizitë në repartin e hemodializës. Objekti është për lëndatë, por edhe puna e stafit. Duhet ta falënderoj Ministrinë e Shëndetësisë dhe të gjithë të tjerët që kanë dhënë kontribut në këtë drejtim. Puna e ushqimit është bërë pak e madhe, sepse në pyetje janë 4 orë, pra procesi i trajtimit. Është shumë mirë nëse mund t'ju siguroni ushqim. Aty është një problem tjetër: Stafi ishin 5 anëtarë, 4 prej tyre infermierë dhe doktor Shaip Krasniqi. Në fillim, prej Ministrisë së Shëndetësisë janë punësuar 10 infermierë, 5 prej tyre kanë mbetë në punë në Prizren. Do të ishte mirë të shikohet mundësia që këta 5 infermierë të rikthehen në Rahovec, në mënyrë që të rritet stafi dhe puna të lehtësohet më shumë.

Kryetari: Rekrutimin e stafin e bën spitali rajonal i Prizrenit. Ne e kemi diskutuar këtë temë dhe besoj që stafi duhet të rritet. Realisht ne mund të kujdesemi që infermierët që vinë të jenë të rrethit tonë. Nuk kemi nevojë për eksportim të kuadrove prej komunave tjera, sepse i kemi kuadrot tona. Megjithatë nuk është e drejtë të ndërhyjmë, por ne ua kemi kërkuar këtë si mirëkuptim.

Bejtullah Deliu: Faleminderit i nderuar kryesues! I nderuar kryetar, zëvendëskryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, media, përfaqësues të KFOR-it. Një pyetje rreth komorës që është vendosur në pjesën ku mbahet edhe Hardhfesti, a ka plan konkret se çka do të bëhet me atë vend, çka është menduar të bëhet? Apo ngadalë mund të përfundojë të ndonjë privat, nëse nuk ka ide. E dyta, a marrin ndonjëherë fund punimet në rrugën "Gëzim Hamza"? Çdo muaj gati diçka punohet aty. Është asfaltu dhe riasfaltu, por prapë është keq. Lirisht mund të përdoret si pistë skijimi me pengesa.

Ilir Pallqa: Përshëndetje për të gjithë! Te punësimet që tha kryetari. "kam punësuar edhe të partive të tjera"! Po, e dimë, e ka punësuar edhe asambleisten e PDK-së. E dini çka ka pasur pastaj dhe sot ti je kryesues, përgëzime!

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Fillimisht e falënderoj qeverisjen komunale. E kam ngritur çështjen e rrugës Fortesë-Celinë dhe më vjen mirë që ky projekt ka filluar të realizohet. Faleminderit për angazhimin e bërë në këtë drejtim. Pyetja tjetër është kështu: Kryetar, rruga Qëndresë-

Krushë e Madhe është mësuar në herët. Kjo rrugë ka mbetur pa u përfunduar, sepse traseja ka qenë deri te varrezat e dëshmorëve. Me ndërtimin e çerdhes në Krushë është bërë pak problem, sepse është rrugë njëkahëshe. Nëse takohen dy makina në përballëkalim, nuk mund të kalojnë. Po e ngris edhe një herë këtë shqetësim dhe a ka mundësi që kjo trase e rrugës të përfundojë? A është pronë publike ajo? Është një segment shumë i shkurtër dhe nëse do të bëhej, konsideroj që projekti është i përfunduar. Për momentin mendoj që projekti është në gjysmë.

Kryetari: E falënderoj Ministrinë e Planifikimit, Mjedisit dhe Infrastrukturës, sepse kohëve të fundit kemi lajme të mira. Nëse do të ishte nga fillimi kështu, do të ishte shumë interesat. E falënderoj Liburnin edhe Hysen Durrishin. Në vitin e fundit, në komunën tonë janë mbi 20 milionë € investime vetëm nga kjo ministri. Rruga Rahovec-Krushë, rruga për Brestoc, rruga prej Samshit deri në Rahovec, rruga për Pataqan, së fundi rruga Fortesë – Celinë dhe në fund mund ta kemi një lajm po ashtu të mirë, sepse i kemi edhe disa rrugë që mund t'i realizojmë pikërisht nga kjo ministri. Është e vetmja ministri që mund të bëhemi krenarë, që ka punuar vitin e fundit. Për këto tjerat, zoti t'falte shpirtin. Do të përfshihet gjithashtu ai segmenti, prej kompleksit përkujtimor dhe do të jetë një alternativë shumë e mirë, nëse e krahasojmë me këtë që është ekzistuesen. Pra, buxheti i komunës po mbrohet shumë, sepse investimet janë nga ministria. Mirë që po ndodh kjo, sepse na "sosën" me kontratën kolektive. Ne jemi "për" kontratën kolektive, por që këto para t'i siguron ministria dhe jo komuna. Deri tani janë marrë 1.6 milionë, në proces janë edhe 1.8 milionë. Të shohim tutje! Unë këtë vit kam qenë edhe anëtar i komisionit të granteve për t'i përfaqësuar komunat e Kosovës, konstruktivisht mbi 4 orë kemi debatuar me ministrin Hekuran Murati dhe përgjigje për kontratë kolektive ende nuk kemi marrë. Për fund, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor meriton përsëritje publike, për Liburnin dhe Hysen Durrishin.

Drilon Mustafa: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, të nderuar drejtorë, asambleistë. Po e paraqes një shqetësim të lagjes "Krasniqi" dhe "Kelmendi" në Kramovik, në lidhje me kanalizimin. E di që këtë kontratë e ka KRU Gjakova, por ajo është e papërgjegjshme. I kam bërë dy postime në facebook si shenjë revolte. Ata vijnë e pastrojnë, por pas 5-6 orë del prapë. Kërkoj nga Drejtoria e Inspektoriatit që të del në terren dhe nëse nuk e kryejnë punën, le të vazhdojë me gjorbë.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit kryesues, përsëritje për të gjithë! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë, kolegë anëtarë të kuvendit, zyrtarë komunalë, media, përfaqësues të LMT-së. Kryetar, është mirë t'i tregoni drejtorit të Gjeodezisë, Afrim Oruçit, për këto të mira të qeverisë Kurti dhe për këto investime që po bëhen në komunën e Rahovecit. Drejtori i ka bërë disa video me kritika për qeverinë, thua ti veç zi e terr. Këto investime të ministrave të Albin Kurtit e kapin vlerën 20 milionë €. Dua t'i ngris disa çështje. Një pyetje e kam bërë për drejtorinë e Inspektionit gjatë KPF-së dhe e kam pranuar përgjigjen prej drejtorisë në formë të shkruar – në formë shumë profesionale. Të dhënat statistikore tregojnë që, prej vitit 2022 deri në këtë periudhë janë shqiptuar 275 gjoja mandatore në vlerë të përgjithshme prej 115.000 € për ndërtimet pa leje. Me këtë pjesë jemi në rregull, por produktiviteti i Inspektoriatit nuk mund të matet me gjoja. Ne jemi të vetëdijshëm që ndërtime pa leje ka shumë. Prej qendrës deri te komuna duhe ardhur, ne i evidentojmë vetëm me sy shumë ndërtime pa leje. Pajtohemi që ndoshta drejtoria ka mungesë të stafit, por përdorisa brenda vitit 2024 mund t'i shqiptojë 109 gjoja, atëherë nuk bën të krenohemi me këtë, por duhet ta gjejmë modulën që qytetarëve t'u tregojmë dhe t'i udhëzojmë për t'u pajisur me leje ndërtimore. Te kjo pjesë kam kritikë për zyrtarët e Drejtorisë së Urbanizmit, për vështirësitë në procedura dhe për kriteret që ata i vendosin, si dhe nuk trajtohen të gjithë qytetarët që aplikojnë në formë të barabartë. Përparësi ka më i forti dhe kjo qasje është gabim. Me shqetësues është fakti ku ka ankesa të qytetarëve që inspektorët bëjnë dëme në pronat e huaja. Kjo është shqetësuese, sepse të ankohet qytetari për një inspektor të caktuar që ai po bën dëm e në fakt ai duhet t'i dënojë ata që bëjnë dëm. Pres nga drejtoria që të ketë masë ndëshkuese ndaj tyre. Një temë tjetër: kam marrë pjesë në dëgjimin buxhetor për qarkoren e parë. Besoj që ne duhet ta diskutojmë brenda kuvendit, sepse fakti është shqetësues se si është implementuar qarkorja e parë dhe si është bërë ndarja buxhetore. Kategoria për paga dhe mëditje ka më shumë mjete për vitin 2026 se sa ka pasë për vitin 2025, shkak i ligjit të pagave dhe rritjes së koeficientit. Shqetësues është fakti që buxheti është ndarë

në proporcion me numrin e banorëve dhe realisht komuna e Rahovecit po penalizohet shkak i zvogëlimit të numrit të banorëve. Buxheti është në rregull. Problemi është te Drejtoria e Arsimit dhe e Shëndetësisë, ku ka staf tepër, në Drejtorinë e Arsimit janë më tepër 200 mësimdhënës dhe me këtë ndarje buxhetore qeveria nuk i ka ndarë mjetet për ta. Prej vitit 2026 kushdo që mund të bëhet kryetar, do të ketë pengesa në operim. Kategoria mallra dhe shërbime nuk ka rritje, kur parashihet të ketë probleme në vitin e ardhshëm, sidomos në shkolla nuk do të ketë pajisje elementare për procesin mësimor, ndoshta s'do të ketë edhe shpuza. E kam edhe një propozim: Për ngricat në bujqësi, Ministria e Bujqësisë e ka hapur një komision për verifikimin e dëmeve vetëm në sektorin e vreshtarisë. Nëse ministria e ka bërë këtë, është shumë mire, sepse ia lehtëson punën komunës. Njëkohësisht, Drejtoria e Bujqësisë e ka bërë një komision tjetër për verifikimin e këtyre dëmeve në bujqësi, por ky komision është për komplet kulturat. Te vreshtaria është e panevojshme, sepse mund të kemi një moment kur të dalin raportet dhe të mos jenë në përputhje me njëri - tjetrin. Një propozim tjetër: Për lagjen "Vëllezërit Frashëri" e kam bërë edhe në KPF dhe kam kërkuar që për seancën e sotme të shtohet edhe një pikë shtesë. Janë dy lagje në qytet që kanë probleme me energjinë elektrike. "Vëllezërit Frashëri" dhe "Lagja e Epërme". Dua ta hapi si temë diskutimi, mënyrën se si komuna ta gjejë një alternativë dhe besoj që fundi i këtij mandati duhet të jetë momenti i fundit që ne ta rregullojmë qështjen për këto dy lagje, që janë ndër më të banueshme të qytetit. Si anëtar i kuvendit dhe si banor i asaj lagjeje, propozoj që, nëse është e pamundshme ta gjejmë një hapësirë të vogël për vendosjen e një trafo, atëherë propozoj që, të sigurojmë më shumë mjete që komuna t'i shpronësojë 3-4 ari. Këtë propozim e kam për dy lagjet, vlera e shpronësimit nuk mund të jetë shumë e madhe, sepse shkon në bazë të vlerës së tregut. Në një pjesë të këtyre parcelave të vendosjet trafaja, pjesa tjetër të mbetet pronë e komunës dhe në të ardhmen të bëhet ndonjë projekt.

Kryetari: Ne trafon e kemi siguruar, KEDS-i e ka siguruar dhe jemi në proces të zgjidhjes për pronë. Ju e dini historinë si ka ndodh. Më 5 qershor do të ishte dashur të vendoset trafaja. Kemi para për blerjen e pronave me shpronësim dhe besoj që është me interes të madh ta kryejmë këtë punë, sepse ne do të jemi bashkë edhe në mandatin e ri. Sa i përket falënderimit që e bëra për Libumin dhe Hysenin, i falënderova sinqerisht, sepse vitin e fundit jemi "okej". Qeverinë dhe ministrinë tjera nuk i falënderova. I falënderoj për këto dy projektet që i kemi për Fortesë dhe Ratkoc, për riorganizimin e kadastrit. Me kryeshefin kam nënshkruar momerandum dhe ma tregoi një sekuencë, kur dikush pas gjysmës së natës ka urdhëruar t'i nënshkruan tokat e manastritit të Deçanit dhe ky nuk ka pranuar për t'i regjistruar në kadastrë. Pra, mos mendoni që gjithçka merrë frymë për gabzherri të një lëvizje politike që sot është në pushtet. Sa i përket qarkores, punëtorët e arsimit janë të aprovuar nga Ministria e Financave. Regjistrimi i popullësisë na penalizoi, por asnjëri nuk largohet nga puna. Tani na bjen si barrë, por do të luftojmë mos të jetë barrë e jona. Tani e tutje, duhet të kujdesemi në konkurse, sepse duhet të fillojmë ta normalizojmë situatën. Duhet ta ndjekim rrugën që mos të hapim konkurse, veç atëherë kur duhet me patjetër. Fjala është për arsim dhe shëndetësi. Te ndërtimet pa leje: Po, ka ndërtime pa leje, por jam i bindur që deri më tani inspektorati ynë e ka kryer punën në mënyrë profesionale, duke hartuar procesverbale, me gjoba, dërgesa në gjykata. Te aspekti i rrënimit ende nuk kemi arritur, besoj që duhet të kalojnë edhe 10-15 vjet që të aplikohet rrënimi. Unë nuk i përjashtoj elementet subjektive, sepse jemi njerëz. Më parë ta kryej ty një punë (supozoj), por brenda afatit ia kryej edhe Merisë. Dikush është ankuar për këtë gjë. Kanë ardhur krimet e rënda, i kanë hulumtuar dosjet dhe ka dalur që gjithçka është brenda kornizave.

Defrim Kafexhiu: Kryetar, nuk e kam me tendencë te puna e Urbanizmit dhe te Inspektorati. Qytetari tash është inteligjent. E ka më të lehtë ta paguaj një gjobë 500€, duke i vazhduar punimet, se sa që vjen në Drejtori të Urbanizmit që të pajiset me kushte ndërtimore, por për shkak të trajtimit ose qasjes jo të duhur, ose për shkak të vendosjes së kritereve shumë të vështira, sepse edhe aplikimi i kushton aq sa dënimi me gjobë. Nëse gjobitet prej Inspektionit nuk bëhet zgjidhja e problemit të ndërtimit pa leje. Nëse qytetari i lehtësohet puna te procedurat e kushteve ndërtimore në Drejtori të Urbanizmit, në anën tjetër Drejtoria për Punë Inspektuese do ta ketë më të lehtë punën dhe do të ketë më pak nevojë për gjoba, sepse në këtë rast qytetarët do të vetëdijesohen dhe do të pajisen me leje ndërtimore. Aty ka probleme me arkitektin e inxhinierin, të cilët punojnë privatisht dhe shkak që favorizohen disa tjerë. Duhet ta luftojmë

këtë fenomen brenda Drejtorisë së Urbanizmit, le të punon secili, sepse ne nuk jemi që t'ia ndalim dikujt punën, por palët brenda afateve të trajtohen të barabartë. Të mos këtë kritere ekstra, apo të mos maltretohen në kuptimin e qasjes palët që kanë vullnet ta marrin lejen ndërtimore, sepse në fund thonë "Okej, le t'më dënon Inspeksioni, e unë po i vazhdoj punimet".

Kryetari: Ejalë ka, thashethëna ka, vërejtje gjithashtu, por sektori i Urbanizmit zbaton ligjin e ndërtimit, të cilin arkitektët dhe inxhinierët e njohin më mirë. Që të pajisesh me kushte ndërtimore ka standard, të cilat nuk i vendosim ne, por burojnë prej akteve ligjore dhe udhëzimit administrativ. Ai që e pret gjobën e inspektorit, ai nuk mund të pajiset me leje, sepse nuk i plotëson kriteret, psh. Për çështje të pronës. Ai e vazhdon ndërtimin, ne e denojmë dhe ia vendosim shiritat. Lënda shkon në gjykatë. Gjykata të dënon 2-3000€, ndërsa investimi i tij është 50.000. I vetmi mekanizëm është buldozheri. Përpjekja jonë është që në start t'i ndalojmë ndërtimet pa leje. Ne kemi rënëuar objekte, por kemi pasur edhe raste ku nuk kemi mundur të rënojmë, sepse lënda ka shkuar në gjykatë dhe neve na mbetet ta presim vendimin e gjykatës. Pavarësisht vërejtjeve dhe interpretimet që bëhen nga palët, ne jemi të përkushtuar në punë.

Sejfullah Sejfullahu: Faleminderit kryesues! I kam 3-4 kërkesa, por për përgjigje s'kam nevojë. Kryetar, e përmende memorandumit me mikun tënd të vuajtjeve, Liburnin, nëse e takon edhe një herë i thua për rrethin e Krushës. Tani e kemi sezonën e ujitjes dhe provo të flasësh me Radoniqin që bile 10-15 ditë përpara ta lëshojnë ujin. Për drejtorin e Kulturës e kam një kërkesë: Të jetësohen kamerat te Shtëpia Muze – Ukshin Hoti. Te drejtori i Shërbimeve Publike: Pasi e përmendi Lirigzoni, në Krushë kanë mbetur edhe 6-7 rrugë të parregulluara.

Kryetari: Faleminderit Seff! Po, është e vërtetë që edhe miqësitë ndonjëherë kryejnë rol. Unë në këtë projekt nuk jam vetëm. E kam një edhe në sallë, që ka qenë në burgje me të. Ka vullnet të na ndihmojë edhe është shumë mirë. Te rrethrotullimi në Krushë është një projekt për zgjerimin e rrugës rajonale, Prizren-Gjakovë. E dijnë që është shqetësim i madh, por do t'ja përmendi ministrit.

Merisa Shaku: Përsëritje për të gjithë! Te tema e urbanizmit: U vonova për në sallë, sepse 1 orë e gjysmë u vonova. Pas insistimit tim për t'u pajisur me leje, një qytetar i yni vendosi të marrë leje. I thash që duhet të më autorizojë për të aplikuar lart. Shkuam te noteri, këtij zotërisë nuk ka 1 muaj që i ka vdekë prindi ... (u ndal ryma)

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-01022-0, ZK-Hoçë e Madhe:

Afrim Oruçi: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të kuvendit. I nderuar asambleist Kafexhiu, kohën e patzës e shfrytëzoja me kryetarin dhe më njoftoi për punët e mira që po i bën ministri Aliu dhe zy ministri Durnishi dhe në fund më tha që këta nuk janë më me Vetëvendosjen. Kalojmë te pika: Kryetari i komunës i propozon kuvendit dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër. Prona është e komunës P-01022-0, ZK-Hoçë e Madhe, me sipërfaqe të përgjithshme 95 ari e 74m². Prej kësaj sipërfaqe të përgjithshme propozojmë që t'i japim në shfrytëzim vetëm 30 ari për 15 vjet. Qëllimi: Bujqësi, blektori dhe nevoja të tjera.

Ilir Pallqa: Më intereson se cila pronë është, a lidhet me rrugën kryesore?

Afrim Oruçi: Rruga Rahovec-Suharekë, në anën e majtë në drejtim të Suharekës, e kalojmë fabrikën e kartonit dhe futemi në zonë për Hoçë të Madhe. Kjo që është e theksuar me vija të ndërprera me kuq e zi.

Kryesuesi: Nëse nuk kemi diskutime të tjera, pikën e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Konstatoj që unanimisht (22) votohet pika e tretë.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-01022-0, ZK-Hoçë e Madhe:

Afrim Oruçi: Vendim për formimin e komisionit për parcelën e njëjtë, për 15 vjet, në zonë të njëjtë. Komisioni ka 5 anëtarë, 2 prej tyre nga ekzekutivi, 2 nga kuvendit dhe një nga sektori joqeveritar.

Hasan Përboqi: AAK – propozojmë asambleistin Feriz Thaqi

Lirigzon Kastrati: LDK – nuk kemi propozim.

Vlora Vuçitërna: LVV – nuk kemi propozim

Bejtullah Delli: PDK – propozojmë Sejfullah Sejfullahun.

Kryesuesi: Faleminderit! Atëherë, nga kuvendi i komunës kemi këto propozime: Feriz Thaqi AAK dhe Sejfullah Sejfullahu PDK.

Kryetari: Nga ekzekutivi: Berat Duraku dhe Besmirë Bytyqi. Kërkoj votë edhe për përfaqësuesin e sektorit joqeveritar, por emrin e jap më tutje.

Kryesuesi: Faleminderit kryetar! Atëherë këtë përbërje e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Me 24 vota "për" votohet edhe pika e katërt.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-01830-0, ZK-Rahovec- Respektivisht lokali te parku i qytetit:

Erhan Morina: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të kuvendit dhe ju të pranishëm. Para jush kemi propozimin e kryetarit për dhënien në shfrytëzim lokal, i cili gjendet te parku i qytetit – te shtatorja e dy heronjve "Tonin e Mici". Bëhet fjalë për kafiterinë 01830-0, me sipërfaqe prej 132m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 5813m². Jepet në shfrytëzim për periudhën 5 vjeçare. Qëllimi ka të bëjë me ruajtjen dhe rritjen e vlerës së pronës komunale. Sipas certifikatës së pronësisë, kjo pronë edhe pronë e komunës së Rahovecit. Aktualisht ky objekt ka kontratë deri në fund të këtij viti, por për shkak që është vit zgjedhor dhe të mos krijohet ndonjë situatë ku mund të shfrytëzohet objekti pa kontratë, po i zhvillojmë procedurat më herët.

Bejtullah Deliu: Drejtor, faleminderit për prezentimin e kësaj pike. Zakonisht në prezente të tilla kemi afat kohor prej 1 – 15 vite nëse nuk gaboj? Është afat i shkurtër për dhënie në shfrytëzim. Në shumë pika e kemi arsyetuar që duhet t'i rrisim vitet për dhënie në shfrytëzim, sepse nuk është efektive për pak vjet dhe kjo është dëshmuar edhe me parkun e qytetit. Është mirë të caktohet 1 deri në 15 vite, e më pas kuvendi të vendosë, por jo të caktohet vetëm 5 vite. Personalisht, mendoj që 5 vite për një lokal afarist është shumë pak dhe për këtë arsye investime nuk ka, sepse në gastronomi e dimë që lokali duhet të rinovohet gati për çdo vit. Ju lutem që ta përkrahni këtë kërkesë timen dhe afati të jetë minimum 10 vjet e deri në 15.

Kryetari: Do të isha dakort plotësisht, por së shpejti do të kemi zhvillime në shesh aty dhe ideja është që atë objekt mos ta lëmë pa kontratë, sepse është vit zgjedhor dhe pas dekretit të presidentes nuk kemi të drejtë ta japim në shfrytëzim. Do të ishte shumë më mirë më afatgjatë, por mund të ketë kapitull të ri të investimeve pas përfundimit të sheshit. Kemi pasur rast kur i njëjti lokal ka qenë në shfrytëzim edhe 3 vjet, por kësaj radhe është 5. Ju ftoj për mirëkuptim.

Bejtullah Deliu: Kryetar, e potencuat që ka qenë 3 vjet e tani është 5. E dhatë faktin që ka mundësi të bëhet ndonjë ndryshim për në kohë më afatgjatë. Këto ndryshime mund të ceken në kontratë. Jo rastësisht është rritur nga 3 në 5 vjet, sepse nuk ka kush që e merr atë objekt dhe të ketë punë të mirëfilltë, shërbim të mirë dhe investim gjithashtu. Me këto vite, cilido që e merr nuk do të ketë komoditet, ashtu siç kërkohet në gastronomi. Nëse është për 5 vjet, nuk luan rol të madh nëse është edhe për 10 vjet, kur vendosim kushte që ai të harmonizohet me projektin që është në ardhje.

Kryetari: Ne kemi një projekt, i cili parasheh veprime investive edhe në pjesën ku është lokali. Aty nuk parashihet diçka e madhe, sepse tani nuk guxojmë të ndëryjmë në projekt. Pas përfundimit të projektit thash që mund të ketë ide të reja për atë hapësirë. Në të ardhmen e afërt mund të ketë ide për veprime të tjera që korrespondojnë me sheshin qëndror, me turizmin dhe agroturizmin. Sot, nuk guxojmë që këtë hapësirë ta lëmë vakum. Sa më shumë që e kufizojmë sot këtë vendim, për një vendim tjetër që planifikohet të jetë afatgjatë në të ardhmen, është më mirë dhe më lehtë. Bejtë, dëgjom mua këtu, sepse kur është për të dëgjuar ty të dëgjoj.

Defrim Kafexhiu: Debat është mirë të bëhet, por të lutem kryesues menaxhoje pak kohën. Shkaku që merret koha duke folur pa leje, e dikujt ia ndërpreu fjalë e dikujt jo. P.sh në një rast kur unë ia filloj të flas pa mikrofon, mua më ndërprehet fjala, e në këtë rast foli Vlora e kolegët tjerë... Atëherë, për këtë pikë të rendi të ditës e kam bërë një pyetje drejtuar drejtorit të Ekonomisë. Pyetja ka qenë për çështjen e ankandit publik. Nëse një pronë publike jepet për 5 vjet sikur në këtë rast, besoj që duhet të forcohen kriteret që të jepet në shfrytëzim ajo pronë, sepse tani prona

në atë vend ka vlerë më të madhe. Çështja e marrëveshjes për mirëmbajtje duhet të respektohet më shumë, kushdo që e merr në shfrytëzim, sepse shfrytëzuesit e mëhershëm e kanë pasur mirëmbajtjen më të mirë. Te puna e komunës përveç kriterëve, secila do pronë jepet në shfrytëzim për periudhë 5 vjeçare dhe pas 5 viteve duhet t'i nënshtrohet ankandit publik, në çfarë forme? Unë u informova që në mandatin e kaluar, shfrytëzuesit që e kanë pasur pronën për 5 vjet, kanë pasur disa pikë si përparësi që i njëjti të ketë përparësi më të madhe se sa aplikuesit tjerë. Nëse nuk është kjo tani, atëherë krijon pasiguri te investitorët që të krijojnë biznes. Nëse dikush i investon 50.000€ për 5 vjet, aq sa e ka kontratën, në fund si mund që i njëjti t'i nënshtrohet përsëri ankandit publik në kushte të barabarta me konkurruesit tjerë? Si mund ta luftojë komuna këtë pjesë, e cila shkakton pasiguri te njerëzit që kanë interes të marrin në shfrytëzim prona publike?!

Kryetari: U përmend sikur dikush flet pa leje! Pa leje unë nuk flas, vazhdimisht ia kërkoj fjalën kryesuesit. Është e vërtetë kur foli Vlora, të tjerët bënin debat. Një nga qëllimet e ligjit është rritja e vlerës së pronës komunale. Gjatë kohës është e vërtetë që asaj prone nuk iu ka rritur vlera dhe gjendja na lë për të dëshiruar. Po ju pyes juve: Kur keni qenë për herë të fundit për të pirë kafe aty? Ose keni qenë rrallë, ose hiç! Brenda 5 viteve ai ka për detyrë të investojë sipas planit të biznesit, me të cilin ai e ka lidhur kontratën. Kemi raste kur dikush e tejkalon kontratën e dikush tjetër nuk e zbaton fare. Ligji na obligon që të formohet një komision monitorues, të ecurisë së zbatimit të kontratës. Në rastin konkret, jam dakort që t'i forcojmë kriteret, disiplinën dhe mbikëqyrjen. Në momentin që përfundon kontrata, ligji nuk e thotë që ka përparësi që ai që paraprakisht e ka në shfrytëzim. Pas skadimit të kontratës, në ankand të drejtat e barabarta i kanë të gjithë. Defrim, jam "për" asaj që e the, që ta forcojmë mbikëqyrjen dhe t'i forcojmë kriteret. Ju ftoj me mirëkuptim që ta votoni.

Merisa Sharku: Të gjithë pajtohem që gjendja momentale nuk është e mirë në park, por a ka ndodh ndonjëherë që komuna ta ndërprejë kontratën nëse ai nuk e respekton atë. Nëse në kontratë është që ai çdo muaj ta kositë barin, ndërsa ai kalon 3-4 muaj nuk e mirëmban, pse atëherë komuna nuk ia ndërprente kontratën? Në këtë aspekt duhet të jemi më të ashpër. E the edhe vetë që a keni qenë për të pirë kafe? Njerëzit nuk shkojnë, sepse ambienti nuk mirëmbahet. Nëse parku do t'i kishte disa lodra më të mira, nuk do të ishte nevoja që ne t'i dërgonim fëmijët në Xërxë.

Kryetari: Kurrë mos llogaritni që jam njeri pa përvojë. Ndryshe është kur kontrata i ka 5 vjet, më lehtë është kur i ka 3 vjet, ende në ndryshe kur i ka 15 vjet, sepse ne mund t'i bëjmë veprimet, por pala ka të drejtë ta marrë një avokat, duke e përdorur masën e sigurisë dhe të bllokohet krejt. Pra, të jemi më të saktë. Ne mund ta vendosim në votim edhe propozimin për 10 vjet, por së pari e vendosi timin, sepse unë jam kryetar. Unë fillimisht kam insistuar tre vjet, sepse nuk dihet se çka prodhon sheshi tutje dhe mund të ndodh ndonjë standart tjetër i angazhimit për një profit më të madh. Nëse kjo ndodh, atëherë ne duhet ta shkëpusim këtë kontratë dhe ta lidhim një tjetër për 15 vjet, 40, apo 99 vjet. Ju ftoj ta votoni propozimin për 5 vjet dhe më besoni që do e shqyrtoja nëse ka zëra për 4 ose 3 vjet.

Bejtullah Deliu: Nuk kam pretendime për ndonjë interes diçka, por duhet të bisedoj dhe të ju dëshmoj që jam duke folur për të mirën e qytetarëve, për të mirën e përdorimit të asaj prone. Hoteli ka pasur kontratë edhe 2 vjet e gjysmë, por ia ndërpreme sepse nuk iu ka përmbajtur kushteve. Propozimi tjetër për hotel ka qenë 30 vjet, unë kam qenë ai që kam kërkuar që të jepet për 99 vjet, mirëpo me kriterë më të forta. Jam i tharë që edhe ky vend në park të jepet pak më gjatë, sepse patëm kritika prej asambleistëve që nuk mirëmbahet, ose nuk ka kënd të mirë të lodrave për fëmijë. Pse? Sepse nuk është i sugurt a do të vazhdojë i njëjti mas 3 viteve apo 4! Prandaj, kur jepet me afat më të gjatë dhe i kërkon kushte: kënd të lodrave, gjelbrim, ulëse, mirëmbajtje, ndriçim etj... Mendoj që, nëse jepet më gjatë, investimet janë më të sigurta nga cilido investitor që e merr. Për këtë propozim, kërkoj mbështetje nga kolegët asambleistë, por jo domosdoshmërisht.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! E dëgjova kryetarin, i cili i dha arsytet. Gjithashtu edhe Bejtullahu, por ju e dini se në këto raste gjithmonë kemi këmbëngulur se në qoftëse afati është më i gjatë, investitori ka siguri më të madhe dhe mund të bëhet diçka më shumë. Këto janë fjalët e kryetarit, i citova. Kryesues, ti duhet t'i përcjellës

kuvendarët dhe propozimin e zotëriut Bejtullah Deliu, ta vendosësh në votim. Kuvendarët janë ata që vendosin, numrat vendosin.

Kryetari: Nuk e di pse merremi me fiksimë, sepse nuk jam as unë që duhet të insistoj në qështje fikse. Mos e harroni faktin që aty nuk parashihet të bëhet diçka më shumë, përveç përmirësimeve të gjendjes ekzistuese dhe disiplinës së shtuar nga operatori. Më vonë, pas përrurimit të sheshit mund të ketë ide të reja.

Kryesuesi: Faleminderit kryetar! Pas diskutimeve të shumta, shkojmë me propozimin e Bejtullah Deliu, që periudha kohore të jetë deri në 10 vite. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 8 vota pro, 10 vota kundër dhe 1 abstenim nuk kalon propozimi i kuvendarit Bejtullah Deliu. Të nderuar anëtarë të kuvendit, tani e vendosim në votim propozimin për 5 vite. Kush është "për"?... Me 13 pro, 2 kundër dhe 1 abstenim kalon propozimi i kryetarit.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-01830-0, ZK-Rahovec - Respektivisht lokali te parku i qytetit:

Erhan Morina: Të nderuar anëtarë të kuvendit, formimi i komisionit ndërlidhet me pikën paraprake për dhënien në shfrytëzim të lokalit te parku i qytetit. Bëhet fjalë për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave. Komisioni i ka 5 anëtarë; 2 nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga shoqëria civile.

Hasan Përboqi: AAK, propozojmë asambleisten Dafina Gashi dhe ju ftoj që ta votoni.

Lirigzon Kastrati: LDK, propozojmë asambleistin Faton Ramadani.

Sejfullah Sejfullahu: PDK, nuk ka kandidat.

Defrim Kafexhiu: LVV, propozojmë Vlora Vuçitërna për anëtare të komisionit dhe i ftoj të gjithë anëtarët e kuvendit komunal që ta votojnë për hir të integritetit të saj.

Kryesuesi: Atëherë, nga AAK është Dafina Gashi dhe e vendosim në votim këtë propozim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Vazhdojmë me LDK-në, Faton Ramadanin, kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Kush është për Vlora Vuçitërna?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, Dafina Gashi ka 16 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Faton Ramadani, 11 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim dhe Vlora Vuçitërna me 20 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Nga kuvendi i komunës janë Dafina Gashi dhe Vlora Vuçitërna dhe me këtë përbërje e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (20) votohet edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. E kam një kërkesë që gjatë procesit të votimit, t'i ngritni duar lart dhe mos t'i ulni deri sa numrimi i votave të përfundojë.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.46/25 të datës 29.04.2025, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale për rastet e veçanta:

Afrim Oruqi: Me kërkesë të stacionit policor - drejtorisë së përgjithshme në Prishtinë, muajin e kaluar bashkë e kemi votuar një vendim edhe pse ka ardhur me vonesë, me mirëkuptimin e juaj kemi marr vendim që të japim në shfrytëzim afatgjatë në procedurë të veçantë. Gjatë përgatitjes së lëndës dhe gjatë përditësimit është gjetur një manual i vitit 1994 dhe pjesa që është menduar t'ju japim në shfrytëzim stacionit policor, veçse ka qenë pjesë e tyre prej këtij viti, por nuk ka qenë e përditësuar. Kjo është arsyeja që duhet ta shfuqizojmë vendimin me numër 46/25 të datës 29.04.2025.

Lirigzon Kastrati: Drejtor, ne këtu e kemi veç vendimin për shfuqizim, ndërsa arsyetimin e dhatë ju. Më mirë do të ishte që vendim të shfuqizimit të ceket kjo çështje dhe materialin të na përcjellni edhe neve anëtarëve të kuvendit komunal.

Kryesuesi: Nëse nuk kemi diskutime të tjera, pikën e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 22 vota "për", asnjë kundër dhe asnjë abstenim votohet pika e shtatë e rendit të ditës.

8. Vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 50 vjet, P- 02240-76, zona kadastrale Rahovec:

Erhan Morina: Të nderuar anëtarë të kuvendit, para jush keni vendimin e kryetarit dhe raportin e komisionit, i cili më datë 26.12.2024 është formuar në kuvend për zhvillimin e procedurave të ankandit publik për parcelën 02240-76 te Maja e Shkodranit, me sipërfaqe prej 25.000m², e cila sipas certifikatës së pronësisë është pronë e komunës. Pas miratimit nga kuvendit komunal dhe pas konfirmimit të ligjshmërisë nga ministritë përkatëse, komisioni ka mbajtur mbledhje më datë 24 prill dhe ka caktuar kriteret e dhënies në shfrytëzim të kësaj parcele. Pas caktimit të kriterëve është shpallur ankandit publik dhe ka qenë i hapur nga data 25 prill – 12 maj, deri në ora 15:00 pasdite. Pas përfundimit të ankandit publik, më datë 13 maj është mbledhur komisioni dhe i ka hapur ofertat. Pas vlerësimit ka konstatuar se në ankand ka ofertuar vetëm një aplikant, i cili është person fizik që i ka përmbushur kriteret e thirrjes. Komisioni ka shpallur fituese zonjën Flutura Durguti me adresë në Rahovec, rruga “Xhelal Hajda-Toni”. Ju njoftojmë që ofertuesi para komisionit ka paraqitur një plan ideor biznesi, ku shihet qëllimi i shfrytëzimit me një investim deri në 2 milion €. Aty parashihet aktivitet biznesor (restorant, bujtina), projekt ky që do t’i shërbejë promovimit dhe zhvillimit të turizmit në komunën tonë. Çmimi i ofertimit në këtë ankand sipas ofertimit ka qenë minimal, 625€ për muaj. Ftoj anëtarët e kuvendit që ta votojnë këtë pikë, me qëllim që kryetari i komunës z. Smajl Latifi të ketë mundësinë ta lidh kontratën me përfituesin e ankandit publik.

Kryesuesi: A kemi diçka rreth pikës së fundit? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 20 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim votohet pika shtesë dhe pika e fundit për këtë mbledhje. Të nderuar anëtarë, ju falënderoj për vëmendjen! Shihemi në mbledhjen e radhës dhe urime Festën e Kurban Bajramit!

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

K R Y E S U E S I

Arbër Zenuni



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



**INFORMATË RRETH AKTIVITETEVE TË KKSBB-SË PËR 6
MUJORIN E PARË TË VITIT 2025**



JANAR – QERSHOR, 2025

HYRJE

Të nderuar kuvendarë/e të Kuvendit Komunal të Rahovecit,

Bazuar në ligjin Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave të neneve 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL dhe Statutin e Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin vjetor lidhur me aktivitetet, punët, angazhimet dhe arritjet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi përgjatë periudhës janar- qershor 2025.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, është themeluar me vendim të Kuvendit Komunal, më datë 25.1.2022, ku anëtarët e këtij këshilli janë përzgjedhur sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL, ku është bërë shpallje publike në të cilën janë përcaktuar kriteret të cilat duhet t'i plotësojë një kandidat për të qenë pjesë e këtij këshilli.

QËLLIMI I INFORMATËS

Përmes kësaj informate, jemi munduar të krijojmë një pasqyrim të qartë për kuvendarët/et dhe qytetarët, lidhur me aktivitetet dhe punët që janë kryer në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Kjo informatë ka për qëllim që ta rrisë transparencën dhe llogaridhënien e Kuvendit të Komunës së Rahovecit karshi qytetarëve.

FUNKSIONIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI NË KOMUNËN E RAHOVECIT

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi funksionon në bazë të legjislacionit, i cili është në fuqi në Republikën e Kosovës, ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave të neneve 3 dhe 4, Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL dhe vendimit të Kuvendit Komunal, më datë 25.1.2022.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi udhëhiqet nga Kryetari i Komunës, z. Smajl Latifi dhe Koordinatori i KKS-së, z. Skender Hamza.

ANËTARËT E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI JANË:

- 1.1. Smajl Latifi - Kryetari i Komunës, kryesues;
- 1.2. Fazli Morina - Komandanti i Stacionit të Policisë;
- 1.3. Nysret Abazibra - Bashkësia Islame – Rahovec;
- 1.4. Ylvi Shehu - Teqeja e Madhe "Shejh Sylejmani";
- 1.5. Sabahudin Durguti - Teqeja e "Haxhi Shej Iliaz Shehut";
- 1.6. Milan Stanojevic - Kisha ortodokse serbe;
- 1.7. Biljana Nakalamic – Komuniteti serb;
- 1.8. Egzon Hamza - Komuniteti egjiptian;
- 1.9. Valon Berisha - Komuniteti Rom;
- 1.10. Bujar Morina - Komuniteti ashkali;
- 1.11. Bajram Morina, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete;
- 1.12. Abestrim Rexhepi - përfaqësues i FSK-së;
- 1.13. Alban Gashi - Zyrtar për Barazi Gjinore;
- 1.14. Avni Morina - Drejtor i Drejtorisë për Arsëm;
- 1.15. Erseka Cana - Kryetare e Këshillit të Prindërve;
- 1.16. Enis Berisha - KLSP;
- 1.17. Beqir Hamza - KEVSB;
- 1.18. Shani Hoti – Ratkoc, KLSP- Sektori C;
- 1.19. Besmire Bytyqi - Drejtore e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim;
- 1.20. Vjollca Gurguli - SHL-Kosova;
- 1.21. Lendrit Qelaj - ZKKK;
- 1.22. Shaip Shala - Medie lokale;
- 1.23. Mustaf Korenica - Komuniteti i bizneseve;
- 1.24. Lulzim Krasniqi- Përfaqësues i Komitetit të Personave me Afësi të Kufizuara.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT E KKSBSË

Përgatitja e planit vjetor të punës dhe zhvillimi i projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi, identifikimi i dukurive negative, që mund të prishin sigurinë publike dhe rekomandojnë planet e veprimit, bashkëpunojnë me policinë për parandalimin e veprimeve të cilat e kërcënojnë sigurinë në bashkësi. Bashkëpunojnë me institucionet qendrore, që merren me sigurinë publike, me qëllim të krijimit të një ambienti më të sigurt në bashkësi. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KKSBS-të, të komunave fqinje për çështjet e sigurisë në bashkësi, që i tejkalojnë kufijtë e komunës së tyre. Sigurimi i financimit të projekteve nga Kuvendi i Komunës që kanë të bëjnë me sigurinë në bashkësi. Përmes Komunës, kërkon nga ndonjë organizatë joqeveritare financimin e projekteve që lidhen me sigurinë në bashkësi, fiton në takimet e tyre përfaqësuesit nga MPB-ja dhe institucione të tjera gjegjëse, kërkon nga policia përgjigje për rastet që janë me rëndësi për sigurinë në bashkësi, duke mos ndërhyrë në procesin e hetimeve policore. Mbajtja e takimeve të rregullta, bëhet sipas nenit 11, të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012MPB-03/2012 MAPL.

Kuvendi i Komunës, ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe të plotësimit të këtij vendimi të anëtareve të KKSBS-së.

Anëtarët e KKSBS-së kanë mandat të njëjtë me anëtarët e Kuvendit Komunal.

AKTIVITETET E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI JANAR-QERSHOR 2025

Në 6-mujorin e parë të vitit 2025, kryetari i Komunës i ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje të rregullta, ku të gjitha këto mbledhje janë mbajtur sipas planit të aprovuar më 26.12.2024, pra janë respektuar të gjitha pikat e rendit të ditës së planit, gjithashtu ka pasur edhe pika shtesë, kjo është varur nga gjendja dhe situata e cila ka qenë në kohën kur është mbajtur takimi.

Përpos diskutimeve dhe debateve që janë bërë në këto takime, sa u përket pikave të rendit të ditës, gjithmonë në fund të takimeve janë marrë rekomandimet dhe konkluzat.

Më poshtë do t'ju paraqesim 3 takimet nga mbledhjet e Këshillit për Siguri në Bashkësi, si dhe pikat e rendit të ditës, po ashtu edhe diskutimet e shkurta që kanë dalë nga këto takime.

Mbledhjet e mbajtura janar-qershor 2025 nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi janë:

Pikat e rendit të ditës nga Mbledhja e KKS-së, e mbajtur më 24.01.2025

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë rreth aktiviteteve të KKS-së, gjatë vitit 2024;
3. Analizë e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për vitin paraprak 2024;
4. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Siguria në trafik,
 - Ushtrimi i kontrollit më të shpeshtë të trafikut rrugor për të zvogëluar aksidentet me fatalitet.
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit.
5. Trajtimi i qenave endacakë;
6. Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje;
7. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme;
8. Organizimi i trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënësit e shkollave;
9. Mbrojtja e Ambientit në Komunën e Rahovecit;
10. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;
11. Të ndryshme.

Konkluzion nga takimi i KKS-së, i datës 31.01.2024

Diskutimet, Kryetari - Rreth pikës së tretë dhe katërt: Gjendja e sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit është e qetë, stabile dhe pa ndonjë ndryshim thelbësor nga mbledhja e kaluar. Vazhdojmë të kontribuojmë bashkërisht në sigurinë e përgjithshme në komunën e Rahovecit. Konkluzion rreth pikës së tretë: Kërkoj nga Inspektorati dhe nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, të shenjohej parkimet nëse nuk janë të shënuara.

- **Diskutimet rreth pikës së pestë:** Komuna e Rahovecit ka një kontratë për trajtimin e qenve endacakë dhe komuna në bazë të kësaj kontrate i trajton qentë endacakë në territorin administrativ të komunës. Mbi bazën e kësaj kontrate trajtohen rreth 1000 qen
- **Diskutimet rreth pikës së shtatë:** Gjatë kësaj periudhe, sigurinë në shkolla e kemi trajtuar si çështje të përditshme. Në bashkëpunim me drejtorët, me policinë dhe me kryetarët e këshillave të shkollave e kemi përcjellë gjendjen e sigurisë, e cila është stabile. Për t'i parandaluar të gjitha dukuritë negative që ndodhin nëpër shkolla, ne si DKA kërkojmë bashkëpunimin e prindërve.
- **Diskutimet rreth pikës së tetë:** Është bërë zakon që njësia e zjarrfikësve, bashkë me stafin e Drejtorisë për Shpëtim, në bashkëpunim me DKA-në të mbajmë trajnime-ligjërata, kryesisht me nxënësit e shkollës së mesme. Këto trajnime mbahen për t'u mësuar se si të reagojmë në raste emergjente, jo vetëm të zjarrit, por në të gjitha rastet emergjente që mund të kanosen. Këtë vit do të mundohemi të trajnojmë edhe personelin që punon nëpër shkolla dhe nëpër institucionet tona publike.
- **Diskutimet rreth pikës së nëntë:** Gjatë kësaj periudhe, sektori i mjedisit në kuadër të Drejtorisë për Punë Inspektuese ka kryer gjithsej 93 inspektime. Nga këto inspektime janë shqiptuar 52 gjoba mandatore, 30 leje të reja biznesore nga bizneset që operojnë në komunën e Rahovecit, 6 gjoba për mungesë të lejes mjedisore dhe 8 fletëparaqitje. Drejtoria e Inspektoratit është e përkushtuar të mbrojë mjedisin dhe të gjitha hapësirat publike.
- **Diskutimet rreth pikës së dhjetë:** Te sektori i tregut, gjatë vitit 2024 kemi mbikëqyrë të gjitha bizneset dhe tregtarët për të siguruar që ata të ofrojnë produkte të sigurta, të respektojnë normat dhe çmimet e tyre. Gjatë kësaj periudhe janë shqiptuar 8 gjoba mandatore për mungesë dokumentacioni dhe mospërputhje çmimesh.





Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSBS-së e mbajtur me 24.03.2025

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Siguria në trafik;
 - Analizimi i vjedhjeve në territorin e Komunës së Rahovecit.
 - Vetëdijësimi i nxënëseve për rrezikun nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyera nga lufta.
 - Trotualet dhe shenjat sinjalizuese në territorin e Komunës
 - Identifikimi dhe lirimi i hapësirave publike konkretisht trotuareve.
3. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme;
4. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit ndëretnik, multikulturor dhe ndërfetar.
5. Mbrojtja e Ambientit në Komunën e Rahovecit.
6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore.
7. Takimi i anëtarëve të KKSBS-së, me përfaqësuesit e lagjeve urbane dhe fshatrave të Komunës së Rahovecit.
8. Të ndryshme.

Konkluzion nga takimi i KKSBS-së, i datës 24.03.2025

Diskutimet rreth pikës së dytë: Dëshiroj ta theksoj faktin që ne kemi organe ligjore me detyra dhe përgjegjësi në fushëveprimtari të caktuara dhe të gjitha këto na japin të drejtën të themi që, gjendja e sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit është e qetë, stabile dhe pa ndonjë ndryshim thelbësor nga mbledhja e kaluar dhe nuk kemi ndonjë situatë që e ka cenuar këtë gjendje të qëndrueshme. Vazhdojmë të kontribuojmë bashkërisht në sigurinë e përgjithshme në komunën e Rahovecit.

Diskutimet rreth pikës së tretë: Policia e Kosovës në bashkëpunim me DKA-në, që merren me anti-drogën, me edukim dhe trajtim në vetëdijesimin e nxënësve nëpër shkolla. Në komunën tonë, shkollat kanë siguri, sepse janë të instaluara edhe kamerat e sigurisë dhe po vazhdojmë me investime në rrethojat e shkollave. Organet drejtuese të shkollave, gjithashtu e ndihmojnë formimin e klimës së sigurisë në shkolla.

Diskutimet rreth pikës së katërt: Sa i përket bashkëpunimit ndëretnik, fakti që në një institucion si KKSBJ-ja, marrin pjesë përfaqësuesit e grupeve të ndryshme etnike, shumica që janë shqiptarët, tutje romët, ashkalinjtë, egjiptasit, serbët, shoqëritë civile dhe përfaqësuesit e bizneseve etj... Besoj që promovimi i nivelit të bashkëpunimit mund të jetë edhe i nivelit kulturor dhe sportiv, sepse komuna e Rahovecit respektin parimin e barazisë, të diversitetit kulturor-etnik dhe ndërfetar.

PO ashtu po i njoftoj anëtarët e KKSBJ-së se do ta caktoj një ditë dhe do t'i ftoj në një takim dhe në një drekë pune krerët e bashkësive fetare, ku do të jetë edhe komandanti i policisë dhe dikush nga ekipi im. Kjo është një nismë e mirë që t'i shkurtojmë distancat, ndërmjet jush dhe ndërmjet komunës dhe organeve tona shtetërore.

Diskutimet rreth pikës së pestë: Të gjithë jemi të vetëdijshëm që mbrojtja e ambientin është një nga sfidat më të mëdha me të cilën po ballafaqohemi, si dhe një ndër prioritetet kryesore të qeverisë komunale. Si komunë kemi marrë iniciativë, si për pastrimin e deponive ilegale, ashtu edhe për parandalimin e ndotjes së mjedisit, konkretisht përmes masave ndëshkimore nga inspektorët e Komunës së Rahovecit. Për këtë periudhë i kemi shqyrtuar 21 gjopa mandatore në mjedis. Sigurisht që, në funksion të mbrojtjes së ambientit kemi edhe shumë punë tjera për të bërë. Ju lus të gjithëve që të denonconi sa herë që shikoni që ndotet mjedisi. Në fillim të Pranverës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, kemi marrë një aksion për pastrimin e të gjitha deponive ilegale. Kontribuoni dhe denonconi secilin rast që e shihni. Sot, veçse i kemi pasur dy inspektime që kanë përfunduar me masa ndëshkimore. Nuk mjaftojnë vetëm gjobat dhe pastrimi, na duhet një sensibilizim dhe një fushatë vetëdijësuese për krejt qytetarët e komunës së Rahovecit.

Diskutimet rreth pikës së gjashtë: Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore është proces i rëndësishëm për mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve, si dhe sigurimin e një tregtie me ushqim cilësor. Ju kemi informuar edhe më herët që, si inspektorat komunal nuk kemi të drejtë t'i ndëshkojmë subjektet që kanë gjëra pa afat, ose nuk janë me higjienë të rregullt, por, në bashkëpunim me inspektorët e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë këtë muaj kemi bërë kontrole intensive dhe janë gjobitur më shumë se 25 subjekte. Gjobat kanë qenë për mungesë të higjienës dhe për afat të skadimit. Për subjektet që i kanë shkelur të drejtat e konsumatorit, i kemi shqyrtuar 4 gjopa me vlerë nga 1 mijë euro. Inspektorët e tregut janë mjaftueshëm me numër dhe mund t'i mbulojnë, marketet, super-marketet, restaurantet, furrat, tregjet, etj... Pasi ka qenë edhe "Java e Mbrojtjes së Konsumatorit", ju lus dhe ju bëj thirrje të gjithëve që për secilën shkelje që e evidentoni të thirrni në këtë numër, pa pagësë: 080011000, ose në e-mailin.





KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC



Skender Hamza

Udhëheqës i Sektorit për Punë të Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Informatë për gjendjen e mbeturinave në Komunën e Rahovecit



Raporti i punës për periudhën kohore janar – dhjetor të vitit 2025 paraqet një përmbledhje të raporteve të rregullta të hartuara nga zyrtarët e KRM “Ekoregjioni” Sh.A. Njësia Operative Rahovec.

Në këtë raport janë të prezantuara aktivitete financiare , operative , administrative.

Nr.	Pjesërisht kanë raportuar të dhënat e kërkuara
1	Prishtinë
2	Fushë - Kosovë
3	Graçanicë
4	Lipjan
5	Podujevë
6	Mitrovicë Jugore
7	Skenderaj
8	Pejë
9	Klinë
10	Deçan
11	Suharekë
12	Dragash
13	Gjakovë
14	Malishevë
15	Junik
16	Ferizaj
17	Han i Elezit
18	Shtërpçë
19	Gjilan
20	Kamenicë

Nr.	Kanë raportuar të gjitha të dhënat e kërkuara
1	Drenas
2	Istog
3	Prizren
4	Rahovec
5	Kaçanik

Nr.	Nuk kanë raportuar
1	Obiliq
2	Vushtrri
3	Mitrovicë e Veriut
4	Zveçan
5	Zubin-Potok
6	Leposaviq
7	Mamushë
8	Shtime
9	Partesh
11	Ranillug
12	Novobërdë

Nr.	Nuk kanë raportuar
1	KRM "Pastrimi"
2	KRM "Uniteti"
3	KRM "Ambienti"
4	KRM "Ekoregjioni"
5	KRM "Çabrat"
6	KRM "Pastërtia"

KLIENTËT DHE KATEGORITË E TYRE

KRM "Ekoregjioni" sh.a. Prizren Njësia Rahovec vazhdon punën e vet bazuar në vijueshmërinë historike të saj. Sa i përket vendbanimeve Njësia e Rahovecit shërben në qytetin e Rahovecit si dhe në 13 fshatra.

Inkasimi I mjeteve rethh 584.246.02 nga Ekoregjioni

Grumbullimi i mbeturinave

KRM"Ekoregjioni" sh.a. Njësia Rahovec shërben në qytetin e Rahovecit dhe në 13 fshatra.

Shërbimet kryhen në qytet në rrugën kryesore çdo ditë ndërsa në rrugët tjera njëherë në javë apo katër herë në muaj , shërbimi kryet derë më derë

Gjatë periudhes janar-maj 2025 ne baza mujore i kemi shërbyer rreth 8640 klient te anvisërisë , 788biznese dhe 41 Institucione.

Pershendetje , po ju dergojme mesataren e numrit te klienteve te sherbyer per periudhen 01.01.2025 - 31.05.2025

Rahovec	3880
Brestovac	271
Celine	383
Bellacerke	471
Hoqe e Vogël	297
Hoqe e Madhe	90
Krushe e Madhe	855
Nagavc	158
Opterushe	355
Reti e Ulet	108
Retije	129
Xerxe	609
Zatnig	44
Zoqlisht	172
Biznese	788

Për shërbimin e këtyre kategorive (anivisni,biznese,institucione)janë angazhuar këto asete:

Ekodrinia ka Numri I Ekonomive familjare 3204 kurse biznese 86 dhe institucione 25

Inkasimi 152.548.49 euro

Evidentimi i deponive ilegale dhe pastrimi i tyre ne territorin e komunes se Rahovecit nga dt.17.04.2025 deri me dt.25.04.2025

Vendbanimi	Lokacioni	Deponite ilegale-sasia	Vrejtje
BRATOTIN(Rr. Bratotin-Drenoc)	Rruga "Bratotin-Drenoc"	1	PASTRUAR
GURI I KUQ	Rruga "dalje te fshatit pjesa jugore"	1	PASTRUAR
KRAMOVIK	Rruga "Kramovik-Petkovic"	1	PASTRUAR
DRENOC	Rruga "Drenoc-Nashpalle"	1	PASTRUAR
PATAQAN I POSHTEM	Rruga "Pataqan-Rahovec"	1	PASTRUAR
XERXE	Rruga "Vreshlave"-drejtim Ratkocit	1	PASTRUAR

NJOFTIM PËR AKSIONIN E MBLEDHJES DHE RIPARIMIT TË MBETURINAVE TË VËLLIMSHME

Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me kompanitë "Ekoregjioni" dhe "Ekodrinia", njofton qytetarët se nga data 7 maj deri më 14 maj 2025 do të zhvillohet aksioni për mbledhjen dhe riparimin e mbeturinave të vëllimshme.

Cka përfshihet në këtë aksion?

- Orendi shtëplake (dollapë, karrige, tavolina, kuzhina, shtrretër, etj.);

- Pajisje që mund të riparohen dhe të ripërdoren

Ju lutemi që këto objekte t'i vendosni para shtëpiave tuaja, sipas orarit dhe datës së caktuar për vendbanimin tuaj!

Të gjitha mbeturinat do të dërgohen në deponinë legale për mbeturina të vëllimshme, e cila gjendet përgjatë rrugës Rahovec – Drenoc.

Orari	Fshatrat
E mërkurë, 07.05.2025 (08:00 – 12:00)	Brestoc, Hoqë e Vogël, Nagavc, Krushë e Madhe, Celinë
E enjte, 08.05.2025 (08:00 – 12:00)	Kramovik, Cifilak, Polluzhë, Guri i Kuq, Pastasellë
E diel, 11.05.2025 (08:00 – 12:00)	Opterushë, Zaqishtë, Reti, Retijë e Ulët, Hoqë e Madhe
E hënë, 12.05.2025 (08:00 – 12:00)	Sapniq, Pataqan i Ulët, Pataqan i Epërm, Nashpall, Drenoc, Senoc
E martë, 13.05.2025 (08:00 – 12:00)	Qyteti i Rahovecit dhe fshatrat: Fortesë, Bërnjak, Xërxe
E mërkurë, 14.05.2025 (08:00 – 12:00)	Dejnë, Ratkoc, Vranjak, Bratotin, Radostë, Gexhe





Raportim ne Ministrin e Mjedsit dhe Planfikimit dhe Mbrotje e Mjedsit me 31 mars 2025























Me respekt Bjondina RAMAJ FAZLIU



REPUBLICA E KOSOVES
Leveritje e Kuvendit dhe e Komitetit te Komiteteve
Ministria e Financave
Ministry of Finance
Prishtine - Pristina

Udhëzimi
Nr. 06/440 R.M. 1502/2025
Prishtine, 15.05.25

PRISTINEJA



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria- Executive Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve- Ministry of Finance, Labour and Transfers

Zëri i Ministrisë- Ministerial Office- Cabinet of the Minister

DATA	15.05.2025
PËR Z.A.	Ministrit, Kryetarëve të Komiteteve, Kryeshefit të Agjencioneve, Drejtorëve të Organizatave buxhetare, Drejtues të Drejtorive Komiteteve, Zyratave kryesore të financave,
NGA QUTORUMI	Deklan Murti, Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferëve
TEMA/SUBJEKTI (SUBJECT)	Qarkorja Buxhetare 2026-01

Të nderuar,

Me leptoni t'ju shpreh falënderimin tim për kontributin tuaj të çmuar në hartimin e projeksioneve buxhetore për periudhën 2026-2028, të cilat përbejnë bazën për përgatitjen e buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2026.

Ne vijim, ju përçojmë Qarkoren Buxhetore 2026-01, e cila përmban kufijtë fillestare buxhetorë për secilin Organizatë Buxhetore në nivel qendror, si dhe kufijtë buxhetorë për nivelin komunal për periudhën 2026-2028.

Duke marrë parasysh se procesi i regjistrimit të popullsisë ka përfunduar, ju informojmë se kufijtë buxhetorë të përcaktuar në këtë qarkore janë bazuar në të dhënat e reja të regjistrimit të popullsisë, të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin 2024, dhe të aprovuara me Vendimin e Qeverisë Nr.08/251, datë 12.03.2025.

Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve mbetet në dispozicionin tuaj për të ofruar mbështetje dhe vëmendje gjatë procesit të hartimit të Projektllogarit për vitin buxhetor për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026.

Mi falënderojmë për bashkëpunimin.

Me respekt!

Deklan Murti

Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferëve

Për:



Qarkorja Buxhetore 2026/01

1. Qëllimi

Në përputhje me nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ministri për Financa, Punë dhe Transferime është i autorizuar dhe përgjegjës të lëshojë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore, me qëllim të ofrimit të udhëzimeve për përgatitjen e Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri lëshon Qarkoren Buxhetore 2026/01, e cila përmban udhëzimet e para për hartimin e buxhetit për vitin 2026, si dhe vlerësimet për vitet 2027 dhe 2028. Kjo qarkore përfshin gjithashtu kalendarin kohor indikativ për procesin buxhetor dhe kufijtë fillestarë buxhetore për vitin 2026, përkatesisht vlerësimet për vitet 2027-2028 për secilën organizatë buxhetore.

Në rast nevojë, pas kësaj qarkoreje do të lëshohen edhe qarkore të tjera plotësuese deri në finalizimin e plotë të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2026 dhe vlerësimeve për vitet pasuese.

2. Konteksti për përgatitjen e buxhetit për 2026-2028

Planifikimi i buxhetit për vitin 2026 mbështet në Deklaratën e Prioriteteve të Qeverisë 2026-2028 dhe kornizën makro-fiskale për të njëjtën periudhë. Qeveria është e përkushtuar që duke ruajtur stabilitetin fiskal të përkrahë kërkesat e organizatave buxhetore, në përputhje me orientimin sektorial buxhetor dhe prioritetet e përcaktuara në Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë.

Objektivat strategjike të Qeverisë janë përcaktuar përmes Programit të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe strategji sektoriale, si dhe nëpërmjet dokumenteve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian, si Programi për Reformë në Ekonomi 2025-2027 dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Prioritetet e Qeverisë për periudhën trevjeçare të ardhshme përqendrohen në ri-orientimin e ekonomisë drejt prodhimit dhe eksportit, rritjen e punësimit, dhe rritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, që mbrojnë mjedisin dhe sigurojnë ruajtjen e tij për brezat e ardhshëm. Po ashtu, një tjetër prioritet është orientimi drejt transformimit digjital.

Projeksionet fiskale kanë përcaktuar burimet e mundshme të financimit që Qeveria mund të disponojë për shpenzime në vitin 2026, si dhe vlerësimet për vitet 2027-2028. Çdo tejkallim i kufijve të shpenzimeve të përcaktuara në këtë qarkore do të bëjë të detyrueshëm ndryshimin e burimeve të financimit, përfshirë mundësinë e rritjes së burimeve të financimit dhe/ose ndryshimin e politikave tatimore për të siguruar të hyra shlesë.

Gjatë procesit të hartimit të buxhetit, duhet të merren parasysh zotimet tona ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare. Në këtë kuadër, Qarkorja Buxhetore 2026/01 është hartuar në përputhje me obligimet e deritanishme nga marrëveshjet financiare ekzistuese dhe ato në proces negociate, duke pasqyruar përkushtimet për politikën fiskale në përputhje me kërkesat e Fondit Monetar Ndërkombëtar.



3. Parashikimet për implementimin e buxhetit 2026

Para paraqitjes së kërkesave buxhetore për vitin 2026, organizatat buxhetore duhet të paraqesin në Ministrinë e Financave, Planit dhe Transferesve një parashikim të realizimit të buxhetit për vitin 2025, deri në fund të tij, në nivelin e programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve individuale. Gjithashtu, organizatat buxhetore janë të obliguara të identifikojnë dhe të informojnë Ministrinë për nënshpenzimet eventuale në buxhetin aktual, si dhe për prishmëritë për mbi-shpenzimet para se të paraqesin kërkesat buxhetore për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028.

4. Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit për 2026-2028

Procesi buxhetor për vitet 2026-2028 ka për qëllim të lidhë planin dhe politikat buxhetore me prioritetet e Qeverisë. Në nivel sektorial, kjo është realizuar duke prioritetizuar sektorët buxhetorë sipas projeksioneve për periudhën 2026-2028. Përmes kësaj qarkoreje, kërkohet që organizatat buxhetore të konkretizojnë kërkesat e paraqitura, duke detajuar përgatitjen e buxhetit në nivelin e programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve specifike.

Kërkesat për shpenzime të reja duhet të paraqiten vetëm nëse ka hapësirë fiskale të lirë dhe nëse ato janë përfshirë në projeksionet për periudhën 2026-2028. Gjatë procesit buxhetor, Ministria e Financave, Planit dhe Transferesve duhet të sigurohet që totali i shpenzimeve për të gjitha organizatat brenda një sektori të mos e kalojë shumën e parashikuar në projeksionet për sektorin për vitet 2026-2028.

Organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së kërkesave të tyre, t'u japin prioritet:

- Projekteve që kontribuojnë në realizimin e prioritetëve të Qeverisë dhe dokumenteve strategjike.
- Projekteve që janë në vazhdimësi nga vitet e kaluar dhe kanë obligime kontraktuale, përfshirë edhe ato të shpronësimit të lidhura me këto projekte.
- Zotimeve të Qeverisë për Planin e Veprimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe për programin Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA).
- Legjislacionit të ri ose ndryshimit dhe plotësimit të legjislacionit ekzistues.
- Obligimeve për financim të jashtëm për projekte individuale, të cilat duhet të përfshihen brenda ndarjeve buxhetore.
- Aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me Agjendën e reformave në kuadër të Planit të riutjes.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këtu aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale;
- Prezentimi në formë të tabelës mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2026 dhe projeksionet për vitet 2027-2028 dhe



- Gjatë procesit buxhetor vëmendje e shtuar duhet t'i jepet nga OB-të në nivel qendror dhe lokal zbatimit të çështjeve si në vijim:
 - OB-të të mos propozojnë aktivitete apo projekte të reja pa i dhënë prioritet buxhetimit të obligimeve për aktivitetet/projektet kapitale. Në përputhje me rekomandimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, OB-të të dërgojnë në MFPT informata lidhur me padinë e ngritura së bashku me një vlerësim nga zyrat ligjore për mundësinë e materializimit/shndërrimit të tyre në obligime;
 - OB-të janë të obliguara të plotësojnë të dhënat që kërkohen në sistemet buxhetore SZHMB dhe PIP si dhe duhet të parandalojnë keq klasifikimin e shpenzimeve buxhetore. Nëse me rastin e dorëzimit të propozim buxhetit nga OB qendrore apo lokale analiza buxhetor do të identifikojë keq klasifikimet, Departamenti i Buxhetit të njëjtat do t'i largojë nga buxheti, duke përfshirë jo vetëm keq klasifikimet për projektet e reja por edhe ato që janë në vazhdimësi nga viti i kaluar;
 - Projektet e propozuara kapitale të jenë projekte në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. Projektet të cilat nuk zbatojnë standardet dhe kriteret e parapara ligjore nuk do të lejohen të bëhen pjesë e buxhetit.
 - Me rastin e propozimit të projekteve të reja kapitale, OB-të të dorëzojnë në MFPT arsyeshmërinë për secilin projekt sipas rregullave të sistemit PIP dhe udhëzimeve administrative përkatëse;
 - Nga OB-të kërkohet që të bëhet regjistrimi i zotimeve shumëvjeçare në sistemin PIP. Ministritë duhet të ndajnë mjete buxhetore brenda hapësirës fiskale vetëm për realizimin e atyre projekteve kapitale për të cilat në bazë marrëveshjeve të mirëkuptimit me komunat kanë krijuar obligime në të kaluarën;
 - Buxhetimi i projekteve kapitale të bëhet në përputhje me rregullat në fuqi, ku pjesë e kostos së projektit të jenë edhe shpenzimet e shpronësimit. Organizatat buxhetore qendrore dhe lokale, pas një analize paraprake, duhet të planifikojnë shpenzimet e shpronësimit për çdo projekt individual në kuadër të kostos totale të projektit, e jo të planifikojnë lujtë të veçantë për shpronësim.
 - Për projektet e reja kapitale të natyrës teknologjike informative Organizatat Buxhetore para se të aplikojnë për mjete buxhetore duhet të marrin miratim paraprak nga Agjencia e Shërbimit të Informacionit- ASHI (MPB) se një projekt të tillë nuk mund të zbatohet nga ASHI-ja.

Qeveria mund të ndryshojë strukturën e shpenzimeve me qëllim anijen e prioriteteve të saj, si brenda programeve të një organizate buxhetore, ashtu edhe duke zhvendosur buxhetin nga një organizatë në tjetrën të nivelit qendror, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kërkesat buxhetore duhet të mbështesin politikat prioritare të Qeverisë dhe të fokusohen në fushat e politikave sektoriale, në përputhje me Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2026-2028.

Shpenzimet rrjedhëse: Organizatat buxhetore duhet të paraqesin kërkesat e tyre brenda kufizimeve buxhetore të caktuara. Është thelbësore që të gjitha organizatat buxhetore të respektojnë kufijtë e përcaktuar në Shtojcat e bashkangjitura.

Punësimi: Pozitat e reja do të lejohen vetëm brenda numrit të aprovuar të pozitave dhe buxhetit për pozitat e paplotësuara sipas udhëzimeve të dhëna me qarkore.

Pagat dhe shtesat: Për kalkulimin e pagave për vitin 2026 për pozitat aktuale është marrë për bazë për përllogaritje muaji mars 2025 duke përfshirë rritjen e planifikuar të koeficientit për 0.5 sipas Ligjit



mbi udhjetet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025. Ndërsa për punëtorët e papunësuar është përllogaritur paga mesatare dhe është buxhetuar vetëm deri 40%, brenda kufizimeve buxhetore.

Mallta dhe shërbime. Organizatat buxhetore do t'i mundësohet financimi në fushat e rëndësishme dhe të domosdoshme. Organizatat buxhetore duhet të identifikojnë burimet brenda skenarëve brezë të tyre nga ato fusha me performancë jo të mirë, ose që nuk janë në përputhje të mjaftueshme me prioritetet e nivelit të lartë të Qeverisë.

Shpenzimet komunale: priten të ketë pjesëmarrje përfërsisht të njëjtë krahasuar me vitin 2025.

Subvencionet dhe transferet: Në kuadër të kësaj kategorie do të vazhdohet me ndarjen e mjeteve për zbatimin e skemave sociale dhe pensionale për të shpërndarë këtu edhe rritjen natyrale të skemave pensionale, subvencionimet në bujqësi si dhe politikat e reja tani më të aprovuara në Qeveri.

Investimet kapitale përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe, në periudhën afatmesme, pritet të përfaqësojnë rreth 26% të shpenzimeve totale. Gjatë kësaj periudhe, pritet të realizohen projekte kapitale të bazuar në një listë prioritetesh, që përfshijnë iniciativa me ndikim në përmirësimin e rritjes të transportit, përmirësimin e rritjes të energjisë elektrike, si dhe përmirësimin e kushteve në sektorin e arsimit, shëndetësisë, sistemit social, mbrojtjes dhe sigurisë, etj. Pjesa më e madhe e investimeve kapitale gjatë periudhës afatmesme pritet të financohet nga buxheti i regullt, ndërkohë që një numër i madh i projekteve në sektorë të ndryshëm planifikohen të financohen përmes huazimit të jashtëm, duke përdorur klauzulën e investimeve.

Përparësi në financim do të kenë projektet që janë në fazën e realizimit, si dhe ato që janë plotësisht në përputhje me prioritetet e Qeverisë. Kufijtë buxhetorë për investimet kapitale nëpër organizatat buxhetore janë indikativë, dhe Qeveria mban të drejtën t'i rregullojë ato në përputhje me arsyeshmërinë e projekteve që propozohen nga organizatat buxhetore.

Për organizatat buxhetore që konkurojnë për fonde huamarrjeje (nga deficitin buxhetor prej 2%, përmes fondit 04) dhe nga klauzola e investimeve – përmes fondit 06 (ku aplikimi për fonde nga klauzola mund të bëhet vetëm për projekte kapitale), është e domosdoshme që projektet të përmbushin kriteret e përmendura më parë. Kjo përfshin gjithashtu analizën e shpenzimeve rrethëse para, gjatë dhe pas përfundimit të projektit, të cilat duhet të jenë të përshtatshme dhe të përfshira në projeksionet financiare të organizatës buxhetore.

5. Programi për investime publike (PIP)

Planifikimi i buxhetit për investime kapitale realizohet nëpërmjet rregullave dhe sistemit të Programit për Investime Publike (PIP). Prioritetet strategjike të Qeverisë, të përcaktuara në "Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2026–2028", përbëjnë bazën për përgatitjen e kërkesave buxhetore dhe për identifikimin e projekteve kapitale.

6. Indikatorët e performancës

Organizatat buxhetore, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë komunal, janë të obliguara të prezantojnë indikatorët e performancës të përmbledhur sipas objektivave dhe aktiviteteve përkatëse në nivelin e tyre organizativ, në përputhje me nenin 21 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Çdo organizatë buxhetore duhet të paraqesë nga 1 deri në 5



objektiva, të cilat lidhen drejtpërdrejt me strategjitë përkatëse dhe mbulojnë programet më të rëndësishme të saj). Udhëzimi parashikon që, aty ku është e aplikueshme, të paktën një nga objektivat e paraqitura të synojë promovimin e barazisë gjinore, i shoqëruar me indikatorë të performancës dhe aktivitetet konkrete për realizimin e tij. Gjithashtu, çdo kërkesë për fonde shtesë duhet të shoqërohet me një arsyeim të qartë se si ajo ndihmon në arritjen e objektivave të organizatës. Organizatat buxhetore duhet të rishqyrtojnë aktivitetet e tyre në funksion të arritjes së këtyre objektivave, ndërsa indikatorët për matjen e performancës së aktivitetëve duhet të jenë të qartë, të matshëm dhe konkretë për secilin aktivitet.

Forma e ofrimit të këtyre informatave dhe një shembull konkret janë dhënë në Aneksin 2. Për secilin organizatë buxhetore duhet të ofrohen informacionet e mëposhtme:

- **Objektivat e outputit:** Këto përshkruajnë rezultatet e pritshme nga ofrimi i shërbimeve, të cilat janë nën kontrollin e organizatës buxhetore.
- **Treguesit e outputit:** Këta tregues matnin aktivitetin e institucionit, si p.sh. sasinë apo cilësinë e shërbimit ose produktit të ofruar.
 - a) Indikatorit treguesi bazë
 - b) Indikatorit treguesi i synuar
- **Aktivitetet:** Këto përshkruajnë veprimet që do të ndërmerren për arritjen e objektivave të deklaruara.

7. Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ)

Duke vepruar në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020 (2015), institucionet e Kosovës kanë përgjegjësinë për "përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i domosdoshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve" (Neni 5.1.5.). Për këtë arsye, organizatat buxhetore duhet të pasqyrojnë ndikimin e shpenzimeve publike në barazinë gjinore në buxhetin vjetor për vitin 2026. Kjo do të kontribuon gjithashtu në mirënjohjen dhe transparencën në menaxhimin e financave publike. Komunal duhet të marrin parasysh këto udhëzime gjatë hartimit të qarkores së brendshme buxhetore komunale, e cila do të shërbejë si dokument bazë për planifikimin e buxhetit komunal për periudhën 2026-2028. Në rast të paqartësive, organizatat buxhetore mund të kërkojnë ndihmë nga analistët përkatës në kuader të Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave. Forma e ofrimit të këtyre informacionave është dhënë në Aneksin 1. Po ashtu, organizatat buxhetore duhet të publikojnë këto të dhëna.

8. Kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore të nivelit qendror për 2026-2028

Organizatat buxhetore të nivelit qendror duhet të marrin parasysh kufijtë buxhetorë të dhënë në tabelën e mëposhtme gjatë përgatitjes së buxhetit të tyre për vitin 2026 dhe për dy vitet në vijim. Ju lutemi të keni parasysh se këta kufij buxhetorë mund të ndryshojnë në varësi të lëvizjeve fiskale apo vendimeve të Qeverisë, të cilat do të pasqyrohen nëpërmes Qarkoreve Buxhetore pasuese, si dhe në varësi të kualitetit të kërkesave buxhetore.

Më poshtë në Tabelën 1 janë kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore qendrore për 2026-2028.

[illegible]



9. Fazat e procesit buxhetor për vitin 2026 për nivelin qendror

Pjesa në vijim prezanton kalendarin kuor të buxhetit, hapat dhe veprimet gjatë procesit buxhetor për vitin 2026.

- **15 Maj** - Lëshimi i Qarkores së parë buxhetore 2026/01. Kjo qarkore përmban udhëzimet për procesin buxhetor, kufijtë buxhetor dhe kalendarin buxhetor.
- **26 Qershor** - Organizatat buxhetore duhet të dorëzojnë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferimeve (MFPT) kërkesat buxhetore sipas dokumentacionit perkates, duke i përshkruar programet dhe kategoritë e shpenzimeve. Kërkesat duhet të jenë të plotësuara dhe të awsyetuara përmes përdorimit të sistemit të SZHMB-së dhe PIP-it.
- **27 Qershor** - Departamenti i Makroekonomisë paraqet komizën e re makro-fiskale, e cila përcakton parametritë e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin buxhetor 2026.
- **11 Korrik** - Lëshimi i Qarkores së dytë buxhetore 2026/02, e cila do të adresojë çështjet specifike të reja që kanë dalë pas lëshimit të Qarkores së parë buxhetore.
- **25 Korrik** - Nëse kërkohen informata shtesë sipas Qarkores së dytë buxhetore, ato duhet të dorëzohen nga organizatat buxhetore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferimeve – Departamentin e Buxhetit deri në këtë datë.
- **21 Gusht – 29 Gusht** - Dëgjimet buxhetore. Pas pranimit të materialeve nga organizatat buxhetore, do të zhvillohen dëgjime me pjesëmarrës nga organizatat buxhetore, stafi i MFPT, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, dhe përfaqësues të Komisionit Parlamentar për Buxhet, Punë dhe Transferime. Orari i dëgjimeve do të bashkëngjitet Qarkores buxhetore 2026/02. Mundësia e arritjes së marrëveshjes për shumat totale të buxhetit të organizatës për vitin 2026 mund të shqyrtohet gjatë këtyre dëgjimeve.
- **12 Shtator** - Departamenti i Makroekonomisë paraqet vlerësimet e fundit për indikatorët makro-ekonomik, sidomos ata që lidhen me procesin buxhetor 2026-2028.
- **17 Shtator – 21 Shtator** - Konsultime në Qeveri për caktimin e kufijve final buxhetor. Gjatë kësaj periudhe, do të diskutohet dhe përcaktohen kufijtë përfundimtarë të buxhetit.
- **26 Shtator** - Lëshimi i Qarkores së tretë buxhetore, e cila do të përmbajë kufijtë final buxhetor. Këta kufij mund të ndryshojnë nga ato të përcaktuara në Qarkoren e parë dhe të dytë.
- **30 Shtator – 3 Tetor** - Ankesat nga Organizatat Buxhetore. Organizatat do të mund të parashitrojnë ankesat e tyre në lidhje me kufijtë buxhetor të caktuar.
- **7 Tetor – 10 Tetor** - Takimet e Qeverisë për të shqyrtuar ankesat e organizatave buxhetore dhe për të vendosur mbi çështjet që kanë lindur gjatë procesit të shqyrtimit.
- **17 Tetor** - Drafti i parë i buxhetit për vitin 2026 do të paraqitet në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferimeve dhe do të dërgohet në Qeveri për shqyrtim.
- **20 Tetor – 24 Tetor** - Miratimi final i Draft Buxhetit në Qeveri. Pas shqyrtimit të tij, Qeveria do të miratojë buxhetin përfundimtar për vitin 2026.
- **29 Tetor** - Dorëzimi i Draft Buxhetit 2026 në Kuvendin e Republikës së Kosovës për miratimin e tij.

Kërkesa për buxhet nga organizata buxhetore të nivelit qendror duhet të përfshijë:

- Një tabelë me parashikimet deri në fund vit të implementimit të buxhetit 2025, në nivel programi dhe nën-programi, si dhe komentet përcjellëse për nën-ekzekutimin apo mbi-ekzekutim nga udarjet e buxhetit 2025;
- Tabelat 3.1, 3.1 A, 3.2 B si dhe Formularët e PCF-ve të shtypura nga sistemi i SZHMB-së;
- Tabelat 3.2, 3.2 B dhe Formularët e shtypur nga Sistemi PIP;
- Tabelat e Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinnor;
- Tabelat e Buxhetimit në baze të performancës,



- Kërkesa buxhetore duhet të jetë e konsoliduar në nivel të organizatës buxhetore, duke përfshirë gjithashtu agjencitë ekzekutive;
- Shkresa kërkesë (shkresa përcjellëse) e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm ose Kryeshefi i agjencisë, e cila shoqëron të gjitha materialet buxhetore;
- Përshkrimi i kërkesës në formë narrative duhet të paraqitet me këto të dhëna:
 - Arritjet e deritanishme, me fokus të veçantë në realizimin e objektivave të caktuara në dokumentet strategjike.
 - Çfarë është parashikuar të arrihet me ndarjet buxhetore për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028?
 - Organizatat buxhetore duhet të informojnë Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferëve nëse kërkesa buxhetore përfshin vazhdimin e politikave ekzistuese, ose parashikon përfundimin e aktiviteteve aktuale dhe nisjen e aktiviteteve të reja.

Për aktivitetet e reja, organizatat buxhetore duhet të specifikojnë bazën ligjore (si koncepti dokumenti, udhëzim administrativ, projektligj, etj.) dhe të informojnë nëse është kryer Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor për këtë bazë ligjore, në përputhje me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 03/2015, lidhur me Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor për Nismat e Reja Qeveritare.



Niveli Komunal

1. Hyrje

Me qarkoren buxhetore janë përcaktuar grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2026 dhe orientimet për vitet 2027-2028, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, qarkorja përcakton edhe nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2026 si dhe parashikimin afatmesëm 2027-2028.

Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2026, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LPPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitura nga Ministria e Financave, Punës dhe Transferimeve siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Me rastin e regjistrimit të popullsisë, të dhënat të cilat janë publikuar zyrtarisht nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin 2024, Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 12.03.2025 ka aprovuar shtojcën I me të dhënat e reja nga regjistrimi i Popullsisë, në përputhje me nenin 35, paragrafi 2 të Ligjit N.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, të dhëna të cilat kanë shërbyer për përgatitjen e buxhetit komunal për vitin 2026-2028.

Procesi i buxhetit komunal merit parasysh këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumë vjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe
- Përcaktimi i strukturës së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve.

Projektet kapitale shumë vjeçare duhet të raportohen në sistemin e Projekteve të Investimeve Publike (PIP) bazuar në performancë. Si rrjedhojë, nga komunat kërkohet të hartojnë strategjinë kornizë bazuar në synimet dhe objektivat të orientuara në rezultate.

2. Burimet e Financimit Komunal për vitin 2026-2028

2.1. Granti i Përgjithshëm

Bazuar në Tabelën 1, të paraqitur në vijim, të përgatitur nga Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transferimeve në përputhje me LPPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2026 është në shumë prej 345 milion euro, në të cilën është përfshirë edhe kostoja nga regjistrimi i popullsisë në shumë prej 6.5 milion euro, për të mbuluar ndikimin negativ në disa komuna, bazuar në nenin 35.3 të LPPL.

Kjo ndajje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LPPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, duke përfshijtur: mbështetjen buxhetore dhe grantet, grantet e përcaktuara të donatorëve, të hyrit nga tatimi në pronë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale.

Siq paraqitet në tabelën në vijim, bazuar në vlerësimet të Departamentit të Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar Financiar, të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2026 pritet të jenë 3,544.3 mil. euro. Nga kjo shumë, zbriten ato të hyra siç specifikohet në nenin 24 të LFPL dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, i cili grant për vitin 2026 është në shumë prej 338.53 milion euro.

Tabela 1: Përcaktimi i vlerës së Grantit të Përgjithshëm për komuna 2026-2028 (mil. Euro)

Përshkrimi	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
A. Të hyrat e përgjithshme të Qeverisë	2,676.30	2,985.32	3,227.19	3,544.30	3,812.40	4,094.30
Zbritet:						
Mbështetja buxhetore dhe grante	(10.5)	(18.0)	(22.5)	(22.5)	(22.5)	(22.5)
Tatime në prapë	(44.6)	(49.3)	(45.0)	(50.0)	(55.0)	(55.5)
Grantet për kulturën të donatorëve	(12.0)	(12.0)	(12.0)	0.0	0.0	0.0
Taksa rregullim dhe të tjera nga Qeveria Lokale	(54.0)	(56.2)	(70.0)	(73.5)	(77.2)	(77.2)
Të hyrat nga interes	(3.1)	(5.0)	(2.8)	(13.0)	(12.7)	(12.7)
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 20.05.2025 - 10:08
Komuna / Opština / Municipality: RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Rahovec / Orahovac / Rahovec
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i objektit kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i objektit Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Pershkrimi Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar më datën Aktualizirano Updated
P-71510057-08970-1	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Prone private / Privatna imovina / Privately owned Land	Rural	4692	0142/87,Nc.163-2024.rfp, nr. 13.142004	14.02.2024	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvane Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar më datën Aktualizirano Updated
			14.02.2024	

A.2 LLOJIT I SHFRYTËZIMIT / VRESTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Bregj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vresa koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutme koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i blanis Kualitet blane Quality Class	Siçerfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujësi/Polljorëvrednë/Agriculture	Kullës/Pashajet/pature	Kullës E Klasis 3/Pashajet 3 Klase/3rd Class Pature	823
1	Bujësi/Polljorëvrednë/Agriculture	Ardhënjive/Ardhe	Ardhë E Klasis 5/5jive 5 Klase/5th Class Arable Land	3869

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Te drejtat Prava Rights	Emri i Ime Name	Nr. personat Licen broj ID. No.	Vendbanimi Frehobalise Resident	Kodi postel Postanski kod Postal code	Hollësihtë e adreshës Pojednostoi adrese Address details	gjesa e proris Doe imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Ashurnar Asurano Updated
Poseidim individual / Individuelna Drazvina / Single possessor	Isma Avduramon (Isen)	1002747487	RAHOVEC/ ORAHOVAC / RAHOVEC /		Riz Mirzahu Isma	1/1	0142-87	26.12.2024





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Rahovec

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m²
P-71510057-08970-1	Parcelë / Parcela / Parcel	4692



Shkalla/Razmera/Scale: 1:822

Punci/Obradio/Created: Albina Durguti

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:




Data/ Data/Date: 20.05.2025

Koha/ Vreme/ Time: 10:10:14

Skicë Terreni

Z.K. Rahovec

Shk.zv. 1:1000



1. Pjese e parceles kadastrale nr.5483-0 ZK Rahovec
S=223 m²

Rahovec, dt. 22.05.2025



Kompania Gjeodete
GEOLINE





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Šipërtin Rahovec/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108, nenit 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2024, merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026 - 2028 për Komunën e Rahovecit

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me nr. prot. 02/6134/25, i datës 16.06.2024 dhe merret vendimi për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026 - 2028 për Komunën e Rahovecit.
2. Shtojë e këtij vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026 - 2028 për Komunën e Rahovecit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtorët e drejtorive të Komunës së Rahovecit.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim bën në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Aktave të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Kryetarit të Komunës,**
- **Drejtorëve të drejtorive,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr. ____/25
Rahovec, 30.06.2025

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Oraševac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Predsednik Opštine / Municipal Mayor

2024.03.14. 14:25

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108, nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi I dhe 4 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.3.2017. Kryetari i Komunës, u:

PROPOZON

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit, që të merret vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026 - 2028 për komunën e Rahovecit.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026 - 2028 për komunën e Rahovecit.
3. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Shërbimi i Kuvendit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Propozimi hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

Me propozim të njoftohen:

- Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,
- Sekretaria e Kuvendit, dhe
- Arkivi,





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit / Municipality of Rahovec



KORNIZA AFATMESME BUXHETORE (KAB)

2026-2028

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Përmbajtja:

Përmbajtja:	1
I HYRJE.....	3
II STRATEGJIA ZHVILLIMORE KOMUNALE - DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME	4
2.1. PRIORITETET.....	5
2.1.1. BUJQËSI E QËNDRUESHME DHE MODERNIZIM I SEKTORIT AGRAR.....	5
2.1.2. MBROJTJA DHE MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I MJEDISIT	5
2.1.3. ZHVILLIMI I AGROTURIZMIT DHE I SEKTORIT TË TURIZMIT RURAL.....	5
2.1.4. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE PËRKRAHJA E BIZNESEVE LOKALE	5
2.1.5. ARSIMI, SHËNDETËSIA DHE PËRKUJDESJA SOCIALE	5
2.1.6. INFRASTRUKTURA PUBLIKE E QËNDRUESHME DHE SHËRBIMET PËR QYTETARË.....	5
2.1.7. PROMOVIMI I KULTURËS, PËRKRAHJE PËR TË RINJTË, PROMOVIMI I TRASHËGIMISË DHE I VLERAVE TONA	6
2.2. ZOTIMET.....	6
2.3. SYNIMET	7
III FORCIMI I EKONOMISË KOMUNALE DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM	7
3.1. Zhvillimi i agroturizmit dhe i turizmit rural.....	7
3.2. Investime në infrastrukturë turistike dhe mjedisore	7
3.3. Promovimi i bujqësisë së qëndrueshme dhe organike	7
3.4. Zhvillimi i infrastrukturës bazë për bujqësinë dhe për mjedisin	8
3.5. Fuqizimi i kapaciteteve lokale dhe edukimi për zhvillim të qëndrueshëm	8
3.6. Nxitja e turizmit kulturor dhe e trashëgimisë lokale	8
3.7. Lehtësimi i procedurave për investime dhe ndërmarrësi	8
3.8. Parku ekoturistik dhe edukativ.....	8
3.9. Tregu i produkteve lokale dhe ekologjike	8
3.10. Festivali i verës dhe i kulturës së Rahovecit	8
3.11. Zhvillimi i infrastrukturës për sportet ekstreme dhe rekreative.....	8
3.12. Iniciativa për përdorimin e energjive të rinovueshme.....	8
3.13. Programi për rinovimin dhe rregullimin e shtëpive tradicionale	8
3.14. Promovimi i gastronomisë lokale	9
IV PROMOVIMI I TURIZMIT DHE FORCIMI I SEKTORIT TË BUJQËSISË NË KOMUNËN E RAHOVECIT	9
4.1. Përkrahje e fermerëve duke i klasifikuar për secilin sektor	9
4.2. Realizimi i investimeve kapitale për ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës bujqësore	9
4.3. Zhvillimi i sektorit të agroturizmit	10
V PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS SHKOLLORE DHE VEPRIME QË SYNOJNË RRITJEN E CILËSISË NË ARSIM.....	10
VI PËRMIRËSIMI I SHËNDETËSISË DHE I MIRËQENIES SË QYTETARËVE.....	11
6.1. Rritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.....	11
6.2. Mbështetje për shëndetin mendor dhe shërbime sociale.....	11
6.3. Përmirësimi i kujdesit shëndetësor për fëmijët dhe gratë shtatzëna.....	11


6.4. Shërbime të avancuara dhe kujdes paliativ	12
6.5. Parandalimi i sëmundjeve dhe edukimi shëndetësor	12
6.6. Përmirësimi i menaxhimit dhe i kapaciteteve njerëzore	12
6.7. Kujdesi për personat e moshuar dhe angazhimi i vullnetarëve	12
6.8. Menaxhimi i sëmundjeve kronike	12
6.9. Siguria shëndetësore dhe përgatitja për emergjencë	12
VII MBROJTJA E MJEDISIT, PLANIFIKIMI URBAN DHE SHËRBIMET PUBLIKE KOMUNALE	13
7.1. Mbrojtja e mjedisit dhe inovacioni digjital	13
7.2. Urbanizimi i qytetit dhe fasadimi i objekteve kolektive dhe individuale	13
7.3. Infrastrukturë e qëndrueshme dhe moderne	13
7.4. Zhvillimi i hapësirave publike dhe përmirësimi i cilësisë së jetës	14
VIII ADMINISTRATË E PËRGJITHSHME	14
IX KULTURA, RINIA DHE SPORTI	14
X KORNIZA FISKALE KOMUNALE	15
10.1. Indikatorët ekonomikë komunalë	15
10.2. Të hyrat komunale dhe parashikimi afatmesëm 2026 - 2028	15
10.3. Tendencat e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afatmesëm 2026 - 2028	19
XI ANALIZA GJINORE - BUXHETIMI GJINOR	28

I HYRJE

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Rahovecit, që po prezantojmë, është një dokument strategjik i nivelit të lartë komunal, i cili miratohet në parim çdo vit nga Kuvendi Komunal. Ky dokument siguron një analizë të detajuar të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB-i ofron mekanizmat e nevojshëm për realizimin e objektivave dhe të prioritetëve të identifikuar në dokumentet strategjike të Komunës, duke siguruar integritet të plotë në procesin buxhetor.

Kuadri ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore është detyrim për institucionet buxhetore komunale, i përcaktuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2026/01, të lëshuara nga Ministria e Financave, në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Ky dokument shërben si bazë për përcaktimin e sektorëve dhe prioritetëve të zhvillimit, si dhe për identifikimin e mënyrës së shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2026-2028. Procesi i zhvillimit të KAB-it përfshin katër (4) faza kryesore me afate të përcaktuara, të cilat ilustrohen në figurat e mëposhtme:



II STRATEGJIA ZHVILLIMORE KOMUNALE - DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME

Komuna e Rahovecit gjendet në pjesën jugore të Kosovës, në rajonin e Dukagjinit (gjegjesisht në subrajonin e Anadrinit). Është njëra nga komunat e mesme me popullsi dhe pozita gjeografike i mundëson asaj lidhje të mira me qendra të tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Rahovecit ka gjithsej 33 fshatra, 2 vendbanime të vogla dhe një qendër urbane, e ndarë në 5 lagje, me një popullsi prej 41,799 banorë, sipas regjistrimit të vitit 2024, e organizuar në 9,180 ekonomi familjare.

Bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunën e Rahovecit, mbi 2,215 biznese operojnë brenda komunës sonë, të cilat kategorizohen, si: Aktivitete shërbyese të pijeve 10.65 %; Tregti tjetër me pakicë në dyqanet jo të specializuara: 10.70 %; Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani: 10.29 %; Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve: 8.76 %; Tregtia me shumicë, jo e specializuar: 8.26 %; Transporti rrugor i mallrave: 8.40 %; Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore: 7.95 %; Përfundim dhe finalizim i punëve të tjera të ndërtesave: 6.7%; Punime suvatimi: 6.5 %; Aktivitetet e tjera shërbyese të ushqimit: 6.68 %; Aktivitete të tjera: 14.90 %.

Administrata komunale është e strukturuar nëpërmjet zyrave qendrore dhe lokale, që ofrojnë shërbime direkte për qytetarët. Administrata e komunës aktualisht ka në përdorim 5 (pesë) e-klosqe për vetëshërbimin qytetar, duke u mundësuar atyre qasje më të lehtë dhe efikase për t'u pajisur me dokumentet e nevojshme administrative.

Pas konsultimeve të gjera me aktorët kyç politikë, ekonomikë dhe shoqërorë, si dhe në përputhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2026 - 2028 të Qeverisë së Kosovës dhe Qarkoren Buxhetore Komunale, është përcaktuar një vizion i ri dhe i fokusuar për zhvillimin e Komunës së Rahovecit.

Vizioni i Komunës së Rahovecit 2026 - 2028:

Rahoveci synon të zhvillohet si një komunë model i qëndrueshmërisë, ku bujqësia moderne dhe inovative është shtylla kryesore e ekonomisë lokale. Me urbanizim të planifikuar mirë dhe me infrastrukturë të avancuar, komuna do të ofrojë kushte optimale për jetesë dhe punë, duke ruajtur një mjedis të pastër dhe natyrë të mbrojtur. Investimet në energji të ripërtëritshme dhe eficiente, ku shërbimet cilësore publike dhe teknologjia digjitale do të forcojnë zhvillimin ekonomik dhe social. Rahoveci do të afirmohet si një qendër e kulturës, e arsimit dhe e sportit, duke krijuar mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët dhe duke u integruar fuqishëm në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare.

Atributet kryesore që do të karakterizojnë këtë vizion, janë: komunikimi i hapur, transparencë, llogaridhënia dhe përfshirja e qytetarëve në vendimarrje. Për të arritur këtë, prioritetet strategjike të Komunës janë të fokusuara në shtatë (7) prioritet kryesore, të shoqëruara me zotimet përkatëse, të cilat do të sigurojnë realizimin e vizionit dhe të zhvillimit afatmesëm të komunës sonë.

Prioritetet strategjike Afatmesme të Komunës së Rahovecit (2026 - 2028)

Në kuadër të realizimit të vizionit, Komuna e Rahovecit ka identifikuar prioritetet kryesore strategjike për periudhën 2026-2028, të cilat përqendrohen në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social, duke i vënë në theks të veçantë sektorët kyç të zhvillimit lokal.

2.1. PRIORITETET**2.1.1. BUJQËSI E QËNDRUESHME DHE MODERNIZIM I SEKTORIT AGRAR**

- PËRKRAHJA DHE PROMOVIMI I PRAKTIKAVE BUJQËSORE INOVATIVE DHE TË QËNDRUESHME;
- ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË FERMERËVE DHE PËRMIRËSIMI I SISTEMEVE TË PRODHIMIT BUJQËSOR;
- ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS PËR MAGAZINIM, PËRPUNIM DHE TREGTIM TË PRODHIMEVE BUJQËSORE.

2.1.2. MBROJTJA DHE MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I MJEDISIT

- PËRFORCIMI I MASAVE PËR MBROJTJEN E BURIMEVE NATYRORE, PËRFSHIRË UJËRAT, PYJET DHE TOKËN BUJQËSORE;
- NXITJA DHE PËRKRAHJA E PROJEKTEVE TË ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME (SOLARE, ME ERË, ETJ.) DHE EFICIENCËS ENERGJETIKE NË OBJKTET E SEKTORIT PUBLIK DHE PRIVAT;
- MENAXHIMI I DUHUR I MBETURINAVE DHE PROMOVIMI I RICIKLIMIT DHE I VEPRIMEVE PËR REDUKTIMIN E NDOTJES;
- EDUKIMI DHE SENSIBILIZIMI I KOMUNITETIT PËR RUAJTJEN E MJEDISIT DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE.

2.1.3. ZHVILLIMI I AGROTURIZMIT DHE I SEKTORIT TË TURIZMIT RURAL

- PROMOVIMI I PRODUKTEVE LOKALE DHE ZHVILLIMI I RRUGËVE TURISTIKE QË PASUROJNË OFERTËN E AGROTURIZMIT;
- INVESTIMI NË INFRASTRUKTURËN TURISTIKE, PËRFSHIRË AKOMODIMIN, SHËRBIMET DHE AKTIVITETET KULTURORE DHE AMBIENTALE;
- BASHKËPUNIMI ME AKTORË LOKALË DHE NDËRKOMBËTARË PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT TË QËNDRUESHËM DHE RITJEN E VIZITORËVE;
- PËRKRAHJA E SIPËRMARRËSVE NË SEKTORIN E TURIZMIT RURAL DHE OFRIMI I TRAJNIMEVE PËR SHËRBIME CILËSORE.

2.1.4. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE PËRKRAHJA E BIZNESEVE LOKALE

- KRIJIMI I KUSHTEVE TË FAVORSHME PËR INVESTIME LOKALE DHE TË HUAJA;
- PËRKRAHJA E BIZNESEVE TË VOGLA DHE TË MESME, VEÇANËRISHT ATYRE NË SEKTORËT AGRARË DHE TURISTIKË;
- ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS PËR BIZNESET DHE OFRIMI I SHËRBIMEVE TË NEVOJSHME PËR RITJEN E TYRE.

2.1.5. ARSIMI, SHËNDETËSIA DHE PËRKUJDESJA SOCIALE

- INVESTIME NË INFRASTRUKTURË DHE PAJISJE MODERNE PËR INSTITUCIONET ARSIMORE PËR TË SIGURUAR ARSIM CILËSOR DHE BASHKËKOHOR;
- ZGJERIMI I KAPACITETEVE NË INFRASTRUKTURË TË SHËNDETËSISË PRIMARE DHE SHËRBIMEVE SOCIALE;
- QASJE MË E LEHTË DHE CILËSORE PËR SHËRBIMET SOCIALE

2.1.6. INFRASTRUKTURA PUBLIKE E QËNDRUESHME DHE SHËRBIMET PËR QYTETARË

- PËRMIRËSIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE, E UJËSJELLËSIT, E KANALIZIMEVE DHE E INFRASTRUKTURËS KOMUNALE;

- ZHVILLIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE CILËSORE DHE EFIKASE, DUKE PËRDORUR TEKNOLOGJI BASHKËKOHORE;
- ADMINISTRATË EFIKASE QË OFRON SHËRBIME TRANSPARENTE, TË SHPEJTA DHE ME CILËSI TË LARTË.

2.1.7. PROMOVIMI I KULTURËS, PËRKRAHJE PËR TË RINJTË, PROMOVIMI I TRASHËGIMISË DHE I VLERAVE TONA

- MBROJTJA DHE PROMOVIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE DHE HISTORIKE;
- MBËSHTETJA E AKTIVITETEVE KULTURORE, SPORTIVE DHE RINORE QË FORCOJNË IDENTITETIN TONË;
- ZHVILLIMI I BASHKËPUNIMIT RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR NË FUSHAT E KULTURËS DHE TË SPORTIT.

2.2. ZOTIMET

- KOMUNË E HAPUR, ME PERFORMANCË TË LARTË DHE TRANSPARENTE NDAJ QYTETARËVE, KU INFORMACIONI ËSHTË I QASSHËM DHE LLOGARIDHËNIA ËSHTË STANDARD I PANDRYSHUESHËM;
- QEVERISJE E DREJTË, LIGJORE DHE EFEKTIVE, QË RESPEKTON LIGJIN DHE SYNON REZULTATE TË QËNDRUESHME PËR QYTETARË;
- SHËRBIME PUBLIKE GJITHPËRFSHIRËSE, CILËSORE DHE TË BARABARTA PËR TË GJITHË QYTETARËT, PA ASNJË FORMË DISKRIMINIMI;
- PROMOVIM I QEVERISJES MODERNE DHE I STANDARDEVE TË LARTA ADMINISTRATIVE, ME FOKUS NË EFIKASITET DHE SHPEJTËSI NË SHËRBIME;
- PËRKUSHTIM PËR MBROJTJEN DHE RUAJTJEN E MJEDISIT NATYROR, DUKE ZHVILLUAR POLITIKA DHE PROJEKTE QË NXISIN MENAXHIMIN E QËNDRUESHËM TË BURIMEVE DHE PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË JETËS;
- ZHVILLIM I QËNDRUESHËM I BUIQËSISË DHE I AGROTURIZMIT, ME MBËSHTETJE PËR FERMERËT DHE SIPËRMARRJET LOKALE QË KRIJOJNË VENDE PUNE DHE RRISIN POTENCIALIN EKONOMIK;
- RUAJTJE DHE PROMOVIM I TRASHËGIMISË KULTURORE, HISTORIKE DHE NATYRORE, SI ELEMENT KYÇ I IDENTITETIT DHE ZHVILLIMIT SOCIAL;
- RESPEKT I PALËKUNDUR PËR TË DREJTAT DHE DINJITETIN E ÇDO QYTETARI, DUKE KRIJUAR NJË AMBIENT TË PËRFSHIRJES, TË TOLERANCËS DHE TË BASHKËJETESËS;
- PËRKUJDESJE E VEÇANTË PËR QYTETARËT ME NEVOJA TË VEÇANTA, DUKE SIGURUAR MBËSHTETJE DHE MUNDËSI TË BARABARTA PËR TË GJITHË;
- PJESËMARRJE AKTIVE E QYTETARËVE NË PROCESET VENDIMMARRËSE, PËR TË GARANTUAR QË ZHVILLIMI I KOMUNËS TË JETË NË SHËRBIM TË INTERESAVE REALE TË QYTETARËVE;
- BASHKËPUNIM I NGUSHTË ME SEKTORIN PRIVAT, ORGANIZATAT JOQEVERITARE DHE KOMUNITETET LOKALE, PËR TË NDËRTUAR NJË EKOSISTEM ZHVILLIMI GJITHËPËRFSHIRËS DHE TË QËNDRUESHËM;
- INVESTIM NË EDUKIM, SHËNDETËSI DHE INFRASTRUKTURË SOCIALE, PËR TË PËRMIRËSUAR CILËSINË E JETËS DHE MIRËQENIEN E PËRGJITHSHME;
- TREFISHIM I BUXHETIT PËR PËRKRAHJEN E BIZNESEVE TË REJA (START UP);
- SUBVENCIONIMI I FËMIJËVE NË ÇERDHET PUBLIKE.

2.3. SYNIMET

- HARTIMI DHE ZBATIMI I PLANEVE RREGULLIESE URBANE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM DHE MENAXHIM TË HAPËSIRAVE PUBLIKE;
- MBROJTJA DHE PËRMIRËSIMI I MJEDISIT PËRMES MENAXHIMIT TË MBETURINAVE, TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË ZEZA DHE PROJEKTEVE TË GJELBRA;
- MBËSHTETJE E BUJQËSISË SË QËNDRUESHME PËRMES INVESTIMEVE NË TEKNOLOGJI, TRAJNIME DHE INFRASTRUKTURË RURALE;
- MODERNIZIMI I INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, I RRUGËVE DHE I LIDHJEVE MË TË MIRA NDËRMJET ZONAVE URBANE DHE RURALE;
- PROJEKTE PËR NGRITJEN E CILËSISË NË ARSIM PËRMES INVESTIMEVE NË SHKOLLA, PAJISJE, TEKNOLOGJI, TRAJNIM TË MËSIMDHËNËSVE DHE QASJE TË BARABARTË PËR NXËNËSIT;
- PROMOVIMI DHE ZHVILLIMI I KULTURËS DHE I AKTIVITETEVE SPORTIVE;
- PROJEKTE QË ZGJEROJNË SHËRBIMET, AVANCOJNË CILËSINË E TYRE, SI DHE PROJEKTE TË KUIDESIT SOCIAL PËR TË GJITHË QYTETARËT.

III FORCIMI I EKONOMISË KOMUNALE DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Qeverisja jonë do të ndërtojë një ekosistem ekonomik gjithëpërfshirës që mbështet të gjitha kategoritë e biznesit, nxit zhvillimin rural, promovon inovacionin dhe përmirëson mirëqenien e qytetarëve, duke ruajtur mjedisin dhe pasuritë kulturore.

3.1. Zhvillimi i agroturizmit dhe i turizmit rural

- Promovim i fshatrave me potencial turistik përmes: vizitave në fermat lokale, degustime të produkteve tradicionale (verë, fruta, produkte blegtorale) dhe aktivitete kulturore;
- Mbështetje për ngritjen e shtëpive mikpritëse (home stay) dhe organizimi i ngjarjeve tradicionale dhe festivaleve sezonale për të tërhequr turistë vendorë dhe të huaj.

3.2. Investime në infrastrukturë turistike dhe mjedisore

- Mirëmbajtja e shtigjeve për ecje, rrugëve rurale dhe pikave rekreative për sporte natyre, si: çiklizmi, ecje malore dhe shëtitje;
- Përmirësim i shërbimeve në zonat turistike: ndriçim, tabela informative dhe vende pushimi.

3.3. Promovimi i bujqësisë së qëndrueshme dhe organike

- Mbështetje për fermerët që përdorin praktika organike dhe të qëndrueshme përmes subvencioneve, trajnimeve dhe qasjes në tregje lokale dhe rajonale;
- Nxitje e kooperativave bujqësore për fuqizim në marketing dhe shitje.

3.4. Zhvillimi i infrastrukturës bazë për bujqësinë dhe për mjedisin

- Përmirësim i sistemeve të ujitjes dhe i trajtimit të ujërave, me fokus në kursimin e ujit dhe mbrojtjen e burimeve natyrore;
- Investime në menaxhimin e mbeturinave dhe promovim i riciklimit në nivel komunal.

3.5. Fuqizimi i kapaciteteve lokale dhe edukimi për zhvillim të qëndrueshëm

- Organizim i trajnimeve për fermerë, sipërmarrës dhe të rinj në teknologji, marketing dhe menaxhim të qëndrueshëm;
- Përfshirje e komunitetit në aktivitete ekologjike dhe edukim mjedisor në shkolla dhe në hapësira publike.

3.6. Nxitja e turizmit kulturor dhe e trashëgimisë lokale

- Restaurim dhe promovim i monumenteve historike dhe kulturorë të Rahovecit dhe të zonave përreth;
- Organizim festivalesh kulturore, panaire artizanale dhe ngjarje që forcojnë identitetin lokal.

3.7. Lehtësimi i procedurave për investime dhe ndërmarrësi

- Modernizim i shërbimeve administrative për bizneset dhe qytetarët, me platforma digjitale për transparencë dhe lehtësim;
- Konsulencë falas dhe asistencë për aplikime në projekte zhvillimore dhe fonde evropiane.

3.8. Parku ekoturistik dhe edukativ

- Krijimi i një parku natyror me shtigje edukative dhe pika informuese mbi florën dhe faunën lokale, me aktivitete për fëmijë, nxënës dhe familje, për të rritur ndërgjegjësimin ekologjik dhe turizmin.

3.9. Tregu i produkteve lokale dhe ekologjike

- Organizimi i tregjeve javore ose mujore ku fermerët dhe artizanët vendas shesin produkte autentike, organike dhe artizanale, duke e kthyer tregun në një atraksion për banorë dhe turistë.

3.10. Festivali i verës dhe i kulturës së Rahovecit

Ngjarje (vjetore) me koncerte, ekspozita artizanale, gara sportive dhe kuzhinë lokale që promovojnë trashëgiminë kulturore dhe tërheqin vizitorë nga rajoni dhe më gjerë.

3.11. Zhvillimi i infrastrukturës për sportet ekstreme dhe rekreative

- Investime në fusha për biçikletë malore, vrapim dhe sporte të tjera aktive, duke rritur turizmin rinor dhe aktiv.

3.12. Iniciativa për përdorimin e energjive të rinovueshme

- Projekte pilot për instalimin e paneleve diellore në ndërtesa publike dhe fermat e mëdha, për uljen e kostove dhe promovimin e qëndrueshmërisë energjetike.

3.13. Programi për rinovimin dhe rregullimin e shtëpive tradicionale

- Mbështetje për restaurimin e shtëpive tradicionale, duke i kthyer ato në pika referimi të turizmit rural dhe kulturor, përmes subvencioneve dhe trajnimeve për artizanët lokalë.

3.14. Promovimi i gastronomisë lokale

- Organizim i kurseve dhe i punëtorëve (work shop-eve) për gatime tradicionale dhe produkte autentike si përvojë turistike.

IV PROMOVIMI I TURIZMIT DHE FORCIMI I SEKTORIT TË BUJQËSISË NË KOMUNËN E RAHOVECIT

Ky seksion përfshin prioritetet strategjike dhe ndarjet buxhetore për vitin 2026 në sektorin e bujqësisë, në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit Rural të Ministrisë së Bujqësisë për periudhën 2022–2027.

Prioritetet kryesore për këtë periudhë janë:

- Zbatimi i projekteve që mbështesin drejtpërdrejt fermerët dhe risin produktivitetin e tyre;
- Realizimi i investimeve kapitale për ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës bujqësore;
- Zhvillimi i turizmit rural dhe i agroturizmit si nxitës i zhvillimit ekonomik lokal dhe krijimit të vendeve të punës.

4.1. Përkrahje e fermerëve duke i klasifikuar për secilin sektor

Perimekulturë, pemëtari dhe vreshtari

- Përkrahje fermerëve me farëra;
- Plehra kimike;
- Inpute bujqësore;
- Preparate për trajtim të sëmundjeve;
- Mbështetje për fermat multifunksionale që ofrojnë prodhim, përpunim, shitje dhe turizëm në të njëjtin vend;
- Investime në sipërfaqe të mbrojtura – serra;
- Përkrahja e bujqve për ngritje të fidanishteve për prodhim të fidanëve cilësorë;
- Sektori i blegtorisë - shërbime veterinarë (vaksinimi, kontrollimi i kafshëve, ripelimi etj.);
- Fuqizimi i qendrave grumbulluese të qumështit, stimulimi i tyre;
- Sektori i bletarisë – furnizim me ushqim për bletë;
- Fuqizimi i qendrave grumbulluese dhe përpunuese të pemëve dhe të perimeve;
- Fuqizimi dhe përkrahja e bodrumeve për përpunimin e rrushit;
- Këshillimi i fermerëve dhe marrja përsipër e përgatitjes së të gjitha dokumenteve dhe planeve të biznesit për aplikim në institucione të ndryshme, duke angazhuar ekspertë.

4.2. Realizimi i investimeve kapitale për ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës bujqësore

- Ndërtimi i rrugëve fushore, me theks të veçantë mirëmbajtja e tyre;
- Ndërtimi i kanaleve të kulimit në zonat ku paraqiten vërshimet që rrezikojnë tokat bujqësore;
- Pastrimi dhe zgjerimi i përrrenjve që krijojnë probleme të vazhdueshme për fermerë;
- Mbrojtjen e tokave bujqësore nga degradimi – erozioni;
- Drenazhimi i tokave bujqësore;
- Përkrahje për praktika bujqësore të qëndrueshme dhe mbrojtjen e tokës;

- Investime në ujitje moderne dhe përdorim racional të ujit, me theks të veçantë në sistemin e ujitjes pikë-pikë.

4.3. Zhvillimi i sektorit të agroturizmit

Në përputhje me shtyllën III të Strategjisë së Zhvillimit Rural 2022–2027, që synon diversifikimin ekonomik në zonat rurale dhe zhvillimin e aktiviteteve jobujqësore, Komuna e Rahovecit do të fokusohet në zhvillimin e agroturizmit si mundësi për: Rritjen e të ardhurave të fermerëve; Ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore; Përmirësimin e mirëqenies në zona rurale.

4.3.1. Investimet kryesore

- Mbështetje për modernizimin dhe përmirësimin e kapaciteteve akomoduese në fermat agroturistike;
- Trajnime për standarde mikpritjeje dhe shërbime turistike cilësore;
- Integrim të turizmit me gastronominë lokale dhe produktet tradicionale;
- Bashkëpunim me agjencitë turistike dhe institucionet arsimore për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

4.3.2. Mbështetje direkte për prodhimin bujqësor dhe agropërpunimin

- Subvencione për inpute bujqësore dhe teknologji inovative;
- Përkrahje për prodhimin primar dhe certifikimin e produkteve lokale (BIO, PGI etj.).

4.3.3. Zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe i inovacionit

- Trajnime për fermerë, gratë dhe të rinjtë në teknologji dhe marketing;
- Bashkëpunim me institucione arsimore dhe me qendra këshilluese.

4.3.4. Menaxhim i qëndrueshëm i resurseve natyrore

- Përkrahje për praktika bujqësore ekologjike dhe mbrojtje të tokës;
- Investime në sisteme moderne të ujitjes, veçanërisht teknologjinë "pikë-pikë".

4.3.5. Agroturizmi si prioritet për diversifikim rural

- Zhvillimi i fermave mikpritëse për ofrimin e eksperiencave bujqësore autentike;
- Krijimi i skemave për investime në infrastrukturë agroturistike;
- Promovim i produkteve dhe i përvojave përmes marketingut dhe platformave digjitale.

V PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS SHKOLLORE DHE VEPRIME QË SYNOJNË RITJEN E CILËSISË NË ARSIM

- Rivlerësim i nevojave për objektet shkollore në qytet dhe në fshatra, me investime për riparime apo ndërtim të shkollave fillore dhe të mesme sipas nevojës;
- Përmirësim i kushteve infrastrukturore të shkollave për të rritur cilësinë e arsimit;
- Masat për eficiencë energjetike në shkolla, duke aplikuar për fonde nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë;
- Investime në pajisje laboratorike, teknologji informative, tabela digjitale dhe furnizim me libra për bibliotekat shkollore;
- Digjitalizim dhe vizualizim i materialeve mësimore për nxënësit nga parashkollorja deri në klasën e nëntë;

- Bashkëpunim i përhershëm midis organeve drejtuese të shkollave, këshillave të prindërve dhe nxënësve;
- Angazhim i psikologëve dhe i pedagogëve për mbështetje profesionale në shkolla;
- Ofrim i trajnimeve profesionale për mësimdhënësit, me fokus te mësimdhënësit fillestarë;
- Monitorim i vazhdueshëm i procesit edukativo-arsimor nga ekipi i DKA-së;
- Funksionalizim i plotë i çerdhes së re në qytet, planifikuar për përfundim në vitin 2025;
- Organizim i garave periodike të diturisë për nxënës të të gjitha niveleve;
- Monitorim i përdorimit të pakos pedagogjike në shkolla;
- Vazhdim i funksionimit të qendrave arsimore për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian për edukim shtesë;
- Vazhdim i funksionimit të qendrave të karrierës në shkollat profesionale "Xhelal Hajda-Toni" dhe "Selajdin Mullabazi – Mici";
- Bursa për studentë dhe nxënës, përkrahje për profesionistët që na përfaqësojnë me sukses;
- Edukim dhe përkrahje për nxënësit me nevoja të veçanta, duke ofruar transport dhe kushte të përshtatura për mësim;
- Organizim i vizitave shëndetësore sistematike në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe QKMF-në.

VI PËRMIRËSIMI I SHËNDETËSISË DHE I MIRËQENIES SË QYTETARËVE

Qëllimi kryesor: Të ofrohet kujdes shëndetësor cilësor, i qasshëm për të gjithë qytetarët, duke përmirësuar kapacitetet institucionale dhe duke rritur mirëqenien sociale dhe shëndetësore.

6.1. Rritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore

- Caktimi i mjekut familjar për çdo qytetar, për të siguruar kujdes të vazhdueshëm dhe të personalizuar;
- Ofrimi i shërbimeve mjekësore mobile për zonat rurale dhe më të largëta, që qytetarët të kenë qasje më të lehtë;
- Sigurimi i barnave esenciale për të gjithë qytetarët, me subvencionim të barnave për personat me të ardhura të ulëta.

6.2. Mbështetje për shëndetin mendor dhe shërbime sociale

- Angazhimi i ekipeve multidisciplinare (mjekë familjarë, psikologë, punëtorë socialë, logopedë) për trajtim dhe mbështetje të shëndetit mendor;
- Bashkëpunim i ngushtë me Qendrën Rajonale të Shëndetit Mendor në Gjakovë për koordinim dhe referim të rasteve;
- Zhvillimi i programeve për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve mendore, me përfshirje të komunitetit dhe të familjeve;
- Ofrimi i këshillimeve dhe trajtimeve për persona në nevojë, përfshirë ndihmën në situata emergjente dhe për sëmundje terminale.

6.3. Përmirësimi i kujdesit shëndetësor për fëmijët dhe gratë shtatzëna

- Shërbime mjekësore të rregullta në çerdhe dhe kopshte, për monitorimin e shëndetit të fëmijëve 0-6 vjeç;
- Organizim i vizitave sistematike shëndetësore në shkolla për nxënësit;

- Krijimi i klasave edukative për shtatzëna në njësinë e maternitetit, me ofrim të informacioneve dhe të këshillave shëndetësore.

6.4. Shërbime të avancuara dhe kujdes paliativ

- Zhvillimi i kujdesit paliativ dhe shtëpiak për pacientët me sëmundje kronike dhe terminale;
- Zgjerimi i shërbimeve laboratorike në QKMF, duke përfshirë analiza të ndryshme dhe teste diagnostikuese;
- Ofrimi i shërbimeve këshilluese për pacientët me sëmundje kronike dhe edukim për menaxhimin e sëmundjeve;
- Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i rregullt i të gjitha objekteve shëndetësore, objekteve arsimore, objekteve të tjera publike, si dhe i hapësirave publike.

6.5. Parandalimi i sëmundjeve dhe edukimi shëndetësor

- Organizimi i fushatave të rregullta për vaksinim dhe parandalim të sëmundjeve ngjitëse;
- Promovimi i stilit të shëndetshëm të jetesës përmes aktiviteteve edukative në shkollë dhe institucione të tjera edukative;
- Funkcionalizimi i dhomave për edukim dhe promovim shëndetësor në QKMF dhe qendrat shëndetësore në fshatra.

6.6. Përmirësimi i menaxhimit dhe i kapaciteteve njerëzore

- Krijimi i numrit të personelit shëndetësor në të gjitha nivelet, duke përfshirë infermierë, mjekë, psikologë dhe punonjës socialë;
- Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme profesionale për stafin shëndetësor për përmirësimin e shërbimeve;
- Krijimi i sistemeve të monitorimit të cilësisë dhe të performancës së shërbimeve shëndetësore në nivel lokal;
- Investime në teknologji informative për menaxhimin e shërbimeve dhe të dhënave shëndetësore.

6.7. Kujdesi për personat e moshuar dhe angazhimi i vullnetarëve

- Shërbime mobile dhe monitorim i shëndetit për personat e moshuar;
- Organizimi i aktiviteteve sociale dhe edukative për përmirësimin e mirëqenies psikologjike.

6.8. Menaxhimi i sëmundjeve kronike

- Sisteme monitorimi dhe trajnime për menaxhimin e diabetit, hipertensionit dhe sëmundjeve kardiovaskulare.

6.9. Siguria shëndetësore dhe përgatitja për emergjencë

- Trajnime për menaxhimin e emergjencave shëndetësore;
- Krijimi i planeve për situata krizash dhe furnizimi me pajisje të duhura emergjence;
- Hapësira për karantinë, në rast nevojë.

VII MBROJTJA E MJEDISIT, PLANIFIKIMI URBAN DHE SHËRBIMET PUBLIKE KOMUNALE

7.1. Mbrojtja e mjedisit dhe inovacioni digjital

- **Platforma digjitale për raportimin e ndryshimeve në mjedis dhe ndotjes** - Krijimi i një aplikacioni apo portali online ku qytetarët mund të raportojnë në kohë reale ndotjen, shkeljet e mjedisit apo probleme të tjera, duke përfshirë foto dhe pozicion gjeografik. Inspektorët komunalë do të marrin njoftime automatike për ndërhyrje të shpejta.
- **Edukimi dhe përfshirja e qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit** - Programi "Qyteti ynë, ambienti ynë" që përfshin fushata ndërgjegjësuëse, gara dhe aksione për pastrimin e lagjeve dhe shpërblime për kontribute konkrete në mbrojtjen e ambientit.

7.2. Urbanizimi i qytetit dhe fasadimi i objekteve kolektive dhe individuale

- **Fasadimi i objekteve të banimit kolektiv me materiale bashkëkohore dhe me eficiencë të qëndrueshme të energjisë** - Organizimi i një programi subvencionues për banorët dhe pronarët e ndërtesave kolektive, ku ndihmohet me materiale izolimi, panele diellore dhe dizajn modern të fasadave, për një pamje estetike dhe kursim energjie.
- **Shëtitore dhe hapësira multifunksionale në zonat kryesore të qytetit** - Krijimi i zonave pa trafik automjetesh në sheshin qendror dhe rrugët pranë tij, të pajisura me elemente të gjelbërimit, pajisje urbane funksionale (stola, pika karikimi për biçikleta elektrike) dhe hapësira për aktivitete kulturore e tregtare.
- **Rikualifikimi i lagjeve të vjetra me arkitekturë moderne dhe ekologjike** - Përfshirja në projektet e planifikimit urban të praktikave që përfshijnë hapësira të gjelbra, rrugë të përshtatshme për këmbësorë dhe biçiklistë, zona lojërash për fëmijë dhe ndriçim me teknologji led.

7.3. Infrastrukturë e qëndrueshme dhe moderne

- **Rrjeti i biçikletave dhe i transportit alternativ** - Zgjerimi i shtigjeve të biçikletave në zonat urbane dhe periferike, me pika të sigurta parkimi dhe stacione karikimi për biçikleta elektrike dhe skuterë elektrikë, si alternativë ndaj makinave;
- **Smart lighting – Ndriçim publik i mençur** - Implementimi i sistemit të ndriçimit publik inteligjent që përshtatet me lëvizjen e njerëzve dhe të automjeteve, me qëllim kursim energjie;
- **Bashkëpunim me KEDS-in për furnizim të stabilizuar me energji elektrike** - Përmirësim i rrjetit elektrik me ndërrim të shtyllave, instalime nëntokësore dhe përdorim të teknologjive inteligjente për monitorim dhe mirëmbajtje;
- **Bashkëpunim me K.R.U. "Gjakova" dhe me partnerë për ujë të pijshëm cilësor** - Projekte për përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm, me investime dhe mbështetje nga donatorë për rrjetin e ujësjellësit;
- **Trajtimi i ujërave të zeza dhe i ujërave atmosferike** - Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të kolektorëve dhe implantëve për trajtimin e ujërave të zeza në zonat urbane dhe rurale, si dhe sistemet e përthithjes dhe të largimit të ujërave atmosferike për parandalimin e përmytjeve;
- **Investime në asfaltimin dhe riasfaltimin e rrugëve në qytet dhe fshatra**: rruga Rahovec – Drenoc, Senoc, Patasel, Polluzhë, rruga Drenoc – Pataqan i Epërm – Pataqan i Poshtëm – Fortesë dhe rruga Fortesë – Celinë. Gjithashtu, riasfaltimi i rrugëve urbane dhe trajtimi i infrastrukturës për ujëra atmosferike dhe fekale;

- **Përmirësimi i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta** - Adaptimi i rrugëve, i trotuareve, ndërtesave dhe hapësirave publike për qasje sa më të lehtë dhe të sigurt për personat me aftësi të kufizuara.

7.4. Zhvillimi i hapësirave publike dhe përmirësimi i cilësisë së jetës

- **Parku qendror multifunksional dhe Ballkoni panoramik** - Ndërtimi i parkut të qytetit me zona të gjelbra, pista për vrapim dhe biçikleta, kënde lojërash, hapësira për aktivitete kulturore dhe ballkoni panoramik me pamje unike të qytetit;
- **Hapësira për edukim dhe ndërgjegjësim ambiental në QKMF dhe shkolla** - Krijimi i dhomave dhe i qendrave për edukim ekologjik dhe promovim të shëndetit, ku qytetarët dhe nxënësit mund të mësojnë rreth riciklimit, kursimit të energjisë dhe kujdesit ndaj mjedisit;
- **Wi-Fi falas në hapësirat publike dhe pikat kryesore të qytetit** - Për të rritur lidhjen digjitale dhe qasjen në informacion, duke krijuar mundësi lidhjeje më të mira me shërbime interneti dhe përditësim me zhvillimet urbane dhe ambientale.

VIII ADMINISTRATË E PËRGJITHSHME

- Avancimi i mëtejshëm drejt një administrate digjitale, transparente dhe efikase, që u shërben qytetarëve me shpejtësi;
- Votim elektronik në Kuvendin Komunal për efikasitet dhe pjesëmarrje demokratike;
- Digjitalizim i dokumentacionit për menaxhim më të lehtë dhe më të sigurt;
- E-kiosqet, shërbime të reja, të shpejta dhe të kombinuara;
- Sportele të veçanta për mërgatën;
- Adaptim i shërbimeve dhe i ambienteve për personat me nevoja të veçanta;
- Vendosje kamerash për siguri në pika kyçe publike;
- Furnizim me teknologji moderne dhe trajnime për staf, për administratë më profesionale dhe bashkëkohore;
- Digjitalizim i sallës së mbledhjeve;
- Riorganizim i objekteve dhe i mjediseve në administratën komunale.

IX KULTURA, RINIA DHE SPORTI

- Përfundimi i punimeve dhe funksionalizimi i Qendrës për Art, Kulturë dhe Inovacion, një hapësirë multifunksionale për ngjarje artistike, trajnime dhe iniciativat e të rinjve;
- Ndërtimi i fushave sportive moderne me standarde UEFA, stadiumi në Rahovec dhe vazhdimi i ndërtimit të terreneve sportive nëpër fshatra e vendbanime ku është e nevojshme;
- Kujdesi i vazhdueshëm për objektet e trashëgimisë kulturore, përfshirja e tyre në listën e monumenteve nën përkujdesje institucionale, si dhe restaurimi dhe mirëmbajtja e muzeve, komplekseve përkujtimore, busteve dhe përmendoreve të dëshmorëve;
- Funksionalizimi i ansamblit profesional të këngëve dhe valleve të Rahovecit dhe përkrahje për festivalet dhe ngjarjet kulturore dhe sportive tradicionale dhe rinore;
- Pasurimi i fondit librar në bibliotekat komunale dhe organizimi i fushatave për nxitjen e leximit;

- Mbështetje konkrete për ide kreative dhe artistike të rinisë, përfshirë promovimin e projekteve të OJQ-ve në fushën e kulturës dhe të sportit;
- Programi "Ambasadorët e trashëgimisë kulturore" për nxënësit, përfshirja aktive në ruajtjen dhe promovimin e monumenteve historike dhe organizimi i tureve dhe aktiviteteve multimediale;
- Programi "Sporti për të gjithë", që përfshin aktivitete sportive për grupet me nevoja të veçanta dhe të moshuarit, që është më gjithëpërfshirës;
- Fushata për promovimin e leximit "Libri në çdo dorë" me takime me autorë, shfaqje teatrore dhe shpërndarje librash falas;
- Realizimi i projekteve muralistike dhe "Street art" në hapësira publike për të promovuar dhe shfaqur në mënyrë artistike identitetin tonë dhe për të zbukuruar qytetin;
- Programi vjetor "Kampionët e rinisë" për shpërblimin dhe promovimin e të rinjve me arritje në sport dhe në kulturë;
- Përmbyllja e punimeve në kompleksin sportiv tek "Epopeja e UÇK-së", si dhe plan i hollësishëm për ndërtimin e hapësirave të reja sportive, rekreative dhe kulturore.

X KORNIZA FISKALE KOMUNALE

10.1. Indikatorët ekonomikë komunalë

Ndonëse komuna nuk udhëheq drejtpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën 1. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me Kornizën Makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2026 - 2028, përpiluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Komponentët e politikës makroekonomike, siç janë: Bruto-produkti vendor, inflacioni dhe demografia, duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2026 - 2028 e Qeverisë së Kosovës, bazuar në të dhënat historike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme.

Komuna, nga ana e saj, do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe të rritjes së të ardhurave të tyre, rrjedhimisht të rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht, financimi komunal përfshin: **1. Të hyrat vetanake dhe 2. Grantet qeveritare.** Komunitat, po ashtu, janë pranues të granteve të donatorëve të jashtëm dhe të brendshëm (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe kanë mundësinë e huamarrjes, sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna e Rahovecit, në periudhën afatmesme buxhetore 2026 - 2028, nëse krijohen rrethanat, mund të marrë hua nga institucionet financiare për të financuar projektet e saj në projektet për menaxhimin e ujërave të zeza, eventualisht ndonjë projekt tjetër me rëndësi strategjike për komunën tonë, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

10.2. Të hyrat komunale dhe parashikimi afatmesëm 2026 - 2028

Të hyrat e Komunës së Rahovecit nga dy burimet e saj kryesore – Granti qeveritar, si dhe të hyrat vetanake komunale, kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Situata ekonomike në nivel komunal vlerësohet në mënyrë të rregullt për të reflektuar zhvillimet dhe kapacitetet fiskale të komunës në ofrimin e shërbimeve publike dhe realizimin e investimeve kapitale. Indikatorët ekonomikë kryesorë që ndikojnë në planifikimin buxhetor, përfshijnë: normën e papunësisë, nivelin e të ardhurave për kokë banori, zhvillimin e sektorit privat, kapacitetin prodhues lokal, si dhe nivelin e inkasimit të të hyrave vetanake.

Gjatë viteve të fundit, Komuna ka shënuar një trend pozitiv në rritjen e të hyrave komunale, duke reflektuar një përmirësim të administrimit fiskal, rritje të aktivitetit ekonomik lokal dhe zgjerim të bazës tatimore. Krahasuar me periudhat paraprake, janë evidentuar këto zhvillime:

- Rritje e të hyrave nga tatimi në pronë si rezultat i përditësimit të regjistrit të pronës dhe të intensifikimit të mbledhjes;
- Zgjerim i të hyrave nga lejet ndërtimore dhe shfrytëzimi i pasurisë komunale si tregues i rritjes së investimeve private;
- Përmirësim i inkasimit nga taksat komunale dhe shërbimet publike, përfshirë pagesat për shërbime administrative dhe urbane;
- Zbatimi i reformave të brendshme në menaxhimin e të hyrave dhe forcimi i mekanizmave të kontrollit dhe të transparencës.

Ky trend në rritje i të hyrave vetanake, jo vetëm që e forcon autonominë fiskale të Komunës, por gjithashtu krijon hapësirë për planifikim më të qëndrueshëm buxhetor dhe për realizimin e projekteve zhvillimore që reflektojnë prioritetet e komunitetit lokal.

Në projeksionin afatmesëm, parashikohet që të hyrat komunale të vazhdojnë të rriten në përputhje me trendin aktual, duke u mbështetur në faktorë, si: digjitalizimi i shërbimeve, rritja e transparencës fiskale dhe përfshirja më e gjerë e qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Prandaj, projeksionet tona për periudhën afatmesme për të hyrat komunale vetanake, do të jenë në trendin rritës përafërsisht 4 milionë €.

Paraqitja grafike 1: Buxheti total i Komunës në vitet 2026 – 2028, milion euro:



Në bazë të planifikimit të bërë nga viti 2025, grantet qeveritare për Komunën e Rahovecit, si tërësi së bashku me të hyrat vetanake, do të shënojnë rritje në vitin 2026. Rritja e grantit qeveritar do të jetë **1.66 %** në vitin 2026, në krahasim me 2025, po ashtu, të hyrat vetanake në vitin 2026 do të kenë një rritje prej **12.47 %** në krahasim me vitin 2025.

Tabela 1: Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2026 - 2028, në euro

Burimi i të hyrave	2025	2026	2027	2028
Plani	2,001,711.00	2,251,414.00	2,403,069.00	2,305,695.00
Buxhet dhe Financa	1,031,443.00	1,119,432.00	1,202,487.00	1,216,427.00
Tatimi në pronë	567,464.00	622,731.00	667,879.00	674,558.00
Taksa nga mbeturina	200,000.00	200,000.00	200,000.00	200,000.00
Tatimi në tokë	133,979.00	156,701.00	189,608.00	190,556.00
Taksat rrugore	130,000.00	140,000.00	145,000.00	151,313.00
Administrata dhe Personeli	115,000.00	120,000.00	123,000.00	125,000.00
Taksa - certifikatat e lindjes	15,000.00	15,000.00	15,000.00	15,000.00
Taksa - certifikatat e kurorëzimit	9,000.00	9,000.00	9,000.00	9,000.00
Taksa - certifikatat e vdekjes	2,000.00	2,000.00	2,000.00	2,000.00
Taksa - certifikatat e tjera oficerie	44,000.00	46,000.00	47,000.00	48,000.00
Taksa - për pjesëmarrje në tendera	0.00	0.00	0.00	0.00
Taksa - për verifikimin e dokumenteve	4,000.00	4,000.00	4,000.00	4,000.00
Taksa të tjera administrative	41,000.00	44,000.00	46,000.00	47,000.00
Inspeksioni	46,400.00	56,400.00	57,714.00	46,400.00
Taksa të tjera administrative	400	400	400	400
Gjobat nga inspektorati	45,000.00	55,000.00	56,314.00	45,000.00
Licencë për pranimin e lokalit	1,000.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00
Inspektimi higjienik dhe sanitar	0	0	0	0
Shërbimet Publike	241,000.00	292,714.00	333,000.00	273,000.00
Taksa për leje-gërmime	1,700.00	1,700.00	1,700.00	1,700.00
Të hyrat nga shitja e mbeturinave	1,500.00	1,500.00	1,500.00	1,500.00
Shfrytëzimi i pronës publike	2,000.00	2,000.00	2,000.00	2,000.00
Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare	5,000.00	7,714.00	8,000.00	5,000.00
Qiraja nga objektet publike	3,500.00	4,500.00	4,500.00	3,500.00
Licenca të lira individuale	600	600	600	600
Largimi dhe deponimi i automjeteve	700	700	700	700
Të hyrat nga gjykatat	46,000.00	54,000.00	64,000.00	58,000.00
Të hyrat nga gjobat e trafikut	180,000.00	220,000.00	250,000.00	200,000.00
Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	37,700.00	52,700.00	59,700.00	47,700.00
Taksa të tjera administrative	700	700	700	700
Taksa - të hyrat nga pyjet	800	800	800	800
Shfrytëzimi i pronës publike (qiraja e tokës bujqësore)	5,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00
Participimet në bujqësi	30,000.00	45,000.00	52,000.00	40,000.00
Taksa për ndërrimin e destinimit të shfrytëzimit të tokës	1,200.00	1,200.00	1,200.00	1,200.00
Ekonomia dhe Zhvillimi	230,700.00	281,700.00	295,700.00	265,700.00
Licenca të lira individuale				
Licenca për shërbime profesionale	200	200	200	200
Taksë për ushtrimin e veprimtarisë	110,000.00	135,000.00	145,000.00	145,000.00
Licenca të tjera për afarizëm	500	500	500	500
Qiraja nga vendosja e objektit tregtar	120,000.00	146,000.00	150,000.00	120,000.00
Kadastra dhe Gjeodezia	77,268.00	87,268.00	77,268.00	77,268.00
Taksa për regjistrimin e trashëgimisë	32,268.00	36,000.00	32,268.00	32,268.00
Taksa e tjera administrative	3,000.00	3,000.00	3,000.00	3,000.00
Taksa për fl. posed. dhe kopje plani	15,000.00	16,268.00	15,000.00	15,000.00
Taksa për matjen e tokës në terren	27,000.00	32,000.00	27,000.00	27,000.00
Urbanizmi	81,500.00	85,500.00	88,500.00	88,500.00
Taksa komunale për leje ndërtimi	50,000.00	50,000.00	50,000.00	50,000.00
Taksa të tjera administrative	7,000.00	7,000.00	7,000.00	7,000.00
Taksa për demolim	1,500.00	1,500.00	1,500.00	1,500.00

Taksa për legalizimin e objekteve	8,000.00	12,000.00	15,000.00	15,000.00
Inspektimi - respektimi i planit urbanistik	3,000.00	3,000.00	3,000.00	3,000.00
Leje mjedisore komunale	12,000.00	12,000.00	12,000.00	12,000.00
Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	74,700.00	74,700.00	74,700.00	74,700.00
Participimi nga shëndetësia	70,000.00	70,000.00	70,000.00	70,000.00
Taksa të tjera administrative	700	700	700	700
Taksa për verifikimin e dok. të ndryshme	4,000.00	4,000.00	4,000.00	4,000.00
Kulturë, Rini, Sport	5,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00
Shitja e shërbimeve (biblioteka)	5,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00
Arsim dhe Shkencë	63,000.00	76,000.00	86,000.00	86,000.00
Participimet - çerdhja e fëmijëve	55,000.00	70,000.00	80,000.00	80,000.00
Participimi në arsim	6,000.00	6,000.00	6,000.00	6,000.00

10.2.1. Donatorët e jashtëm (ndërkombëtar)

Financimi nga donatorët e jashtëm gjatë vitit 2026 - 2028, presim që të kemi donacione, dhe financim nga performanca.

10.2.2. Politikat e reja

Regjistrimi i popullsisë i vitit 2024 ka prodhuar efekte të dukshme në ndarjen e burimeve financiare për komunën tonë. Sipas të dhënave preliminare të publikuara nga ASK-ja, është evidentuar një zvogëlim i numrit të përgjithshëm të popullsisë krahasuar me vitet e mëparshme. Kjo rënie ka ndikuar drejtpërdrejt në uljen e buxhetit të ndarë për komunën tonë nga grantet qeveritare, të cilat bazohen në kritere, si: numri i banorëve, sipërfaqja territoriale, performanca fiskale dhe faktorë të tjerë socio-ekonomikë. Reduktimi i buxhetit si pasojë e regjistrimit, paraqet sfida shtesë për planifikimin dhe realizimin e objektivave afatmesme zhvillimore, sidomos në sektorë, si: arsimi, shëndetësia, mirëqenia sociale dhe investimet kapitale.

Granti specifik për arsim për vitin 2026 ka pësuar ulje në krahasim me vitin paraprak, si rezultat i drejtpërdrejtë i rënies së numrit të nxënësve në shkollat e komunës së Rahovecit, në përputhje me të dhënat e fundit zyrtare të regjistrimit të popullsisë. Ky grant shpërndahet në bazë të formulës standarde të aplikuar nga niveli qendror, ku numri i nxënësve përbën komponentin themelor për llogaritjen e shumës së financimit. Si rrjedhojë, çdo ndryshim demografik në popullsinë shkollore reflektohet në mënyrë proporcionale në grantin e ndarë për arsim.

Në të njëjtën mënyrë, edhe granti specifik për shëndetësi ka shënuar rënie, për shkak të uljes së numrit të përgjithshëm të banorëve dhe të rishikimit të strukturës demografike, që janë elemente përbërëse të formulës për ndarjen e këtij granti. Kjo ndikon në financimin e shërbimeve të kujdesit parësor, përfshirë numrin e ekipeve mjekësore dhe mbulimin e territorit.

Në këtë drejtim, komuna do të angazhohet për të: optimizuar përdorimin e mjeteve buxhetore në përputhje me prioritetet strategjike, forcuar kapacitetet për tërheqje fondesh alternative (donatorë, projekte IPA, PPP) dhe për të adresuar te niveli qendror nevojën për një rishikim të formulës së ndarjes së grantit, duke marrë parasysh edhe faktorë të tjerë zhvillimorë përtej numrit të banorëve.

10.3. Tendanca e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afatmesëm 2026 - 2028

Sipas rekomandimeve të misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, të komunikuar përmes Qarkores Buxhetore Komunale 2026/01, komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2026, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Mëditje:

Tabela 2. Projektionet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2026 do t'i paraqesim sipas kategorive ekonomike:

Kategoritë buxhetore	Vlera €	%
PAGA	12,499,116.00	58.01
MALLRA&SHËRBIME	2,761,006.00	12.81
SHPENZIME KOMUNALE	390,000.00	1.81
SUBVENCIONE	1,000,000.00	4.64
INVESTIME KAPITALE	4,897,610.00	22.73
TOTAL	21,547,732.00	100.00



Sqarim për kategoritë ekonomike: Në përputhje me të dhënat paraprake të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) më 31 maj 2024, komuna e Rahovecit ka një popullsi prej 41,799 banorësh, e cila paraqet ulje të ndjeshme krahasuar me vlerësimet e mëparshme që janë përdorur në ndarjen e mjeteve buxhetore gjatë viteve të fundit. Kjo ulje e bazës demografike ka ndikuar drejtpërdrejt në formulën e financimit nga niveli qendror, duke reflektuar në zvogëlimin e përgjithshëm të buxhetit të ndarë për vitin 2026 dhe vitet pasuese. Si pasojë, struktura e shpenzimeve është rishikuar dhe përshtatur në mënyrë që të ruhet stabiliteti fiskal dhe të sigurohet efikasitet në ofrimin e shërbimeve publike.

Kategoria e pagave dhe mëditjeve paraqet rritje në raport me vitin 2025, në përputhje me politikat nacionale për rritjen e pagës minimale dhe harmonizimin e koeficienteve në sektorin publik.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime, duke përfshirë edhe shpenzimet komunale, mbesin në të njëjtin nivel me vitin 2025. Kjo strukturë synon të ruajë funksionalitetin e përditshëm dhe mirëmbajtjen e shërbimeve komunale pa ngarkesa të reja.

Kjo strukturë e re është ndërtuar mbi parimet e menaxhimit të përgjegjshëm fiskal, transparencës dhe performancës, me qëllim të sigurimit të një planifikimi realist, të qëndrueshëm dhe në përputhje me nevojat aktuale të popullsisë së komunës.

10.3.1. Pagat dhe Mëditjet

Gjatë vitit 2026, krahasuar me vitin 2025, kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet **16.31 %**. Pjesëmarrja e kategorisë së pagave dhe e mëditjeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore komunale, gjatë këtyre viteve, pritet të mbetet në nivel të përafërt **58.01 %**.

10.3.2. Mallrat dhe Shërbimet

Kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime (duke përfshirë komunalitet), mbetet e njëjtë në vitin 2026, krahasuar me vitin 2025. Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, gjatë vitit 2026, pritet të jetë mesatarisht **12.81 %**.

10.3.3. Subvencionet

Në vitin 2026, Komuna e Rahovecit do të ndajë subvencionet për bujqësi, ekonomi, shëndetësi, arsim, kulturë, rini dhe sport dhe në kudër të shërbimeve publike. Gjatë vitit 2026, krahasuar me vitin 2025, kjo kategori e shpenzimeve pritet të zvogëlohet, për arsyt e cekura më lart. Pjesëmarrja e subvencioneve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore gjatë vitit 2026, mesatarisht, do të jetë: **4.64 %**.

10.3.4. Investimet kapitale

Pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të komunës në vitin 2026 është me **22.73 %**, në përputhje me kapacitetet aktuale financiare dhe qëllimet zhvillimore të përcaktuara në planifikimet komunale afatmesme dhe mundësitë buxhetore të komunës.

Tabela 3: Korniza Buxhetore Komunale 2026 - 2028, në euro.

Nr.	Përshkrimi	2025	2026	2027	2028
			(plan)	(vlerësimet)	(vlerësimet)
1.	TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	20,982,796.00	21,547,732.00	21,939,296.00	22,877,400.00
	Të hyrat vetanake	2,001,711.00	2,251,414.00	2,403,069.00	2,305,695.00
	Grantet dhe transferet qeveritare	18,981,085.00	19,296,318.00	19,536,227.00	20,571,705.00
2	SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	20,982,796.00	21,547,732.00	21,939,296.00	22,877,400.00
	Shpenzimet rrjedhëse	14,907,455.00	16,650,122.00	16,750,598.00	17,198,926.00
	Pagat dhe Mëditjet	10,746,449.00	12,499,116.00	12,539,592.00	12,588,760.00
	Mallrat dhe Shërbimet	2,761,006.00	2,761,006.00	2,821,006.00	3,132,666.00
	Shpenzimet komunale	390,000.00	390,000.00	390,000.00	477,500.00
	Subvencionet	1,010,000.00	1,000,000.00	1,000,000.00	1,000,000.00
3.	SHPENZIMET KAPITALE	6,075,341.00	4,897,610.00	5,188,698.00	5,678,474.00
	Huamarrja e jashtme	0.00	0.00	0.00	0.00

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve në komunë, në bazë të programeve apo të kategorive funksionale, si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim (tabela 4) janë ato aktuale të vitit 2025, planifikimi për vitin 2026 - 2028, si dhe projeksionet (tabela 4-5-6-7).

Tabela 4: Shpenzimet në vitin 2025, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe në nënprograme:

Programet	Stafi	Paga	Mallra dhe Shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Total
Zyra e Kryetarit	23	197,000.00	55,000.00	-	240,000.00	-	492,000.00
Administrata	40	272,000.00	198,000.00	-	-	29,500.00	499,500.00
Çështjet gjinore	1	7,200.00	2,000.00	-	-	-	9,200.00
Inspektimet	10	108,000.00	70,000.00	-	-	-	178,000.00
Zyra e Kuvendit Komunal	31	265,000.00	17,000.00	-	-	-	282,000.00
Buxheti	16	135,000.00	210,000.00	-	-	113,524.00	458,524.00
Infrastruktura publike	4	44,000.00	640,666.00	250,000.00	110,000.00	1,300,000.00	2,344,666.00
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	21	210,000.00	15,000.00	-	-	-	225,000.00
Zyra e Komuniteteve	7	107,000.00	15,000.00	-	-	20,000.00	142,000.00
Bujqësia	5	48,000.00	100,000.00	-	440,000.00	940,000.00	1,528,000.00
Planifikim i zhvillimit ekonomik	7	60,878.00	70,000.00	-	20,000.00	119,317.00	270,195.00
Shërbimet kadastrale	11	99,000.00	16,000.00	-	-	-	115,000.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	7	72,000.00	330,000.00	-	-	2,141,000.00	2,543,000.00
Shërbimet sociale	15	108,000.00	10,000.00	3,000.00	-	230,000.00	351,000.00
Shërbimet kulturore	13	102,000.00	80,000.00	-	120,000.00	357,000.00	659,000.00
Shëndetësia	198	1,896,902.00	450,000.00	70,000.00	80,000.00	120,000.00	2,616,902.00
Administrata e Arsimit	8	65,000.00	62,000.00	-	-	-	127,000.00
Arsimi parashkollor dhe çerdhet	34	260,000.00	89,000.00	8,500.00	-	-	357,500.00
Arsimi fillor	675	5,430,000.00	233,237.00	43,500.00	-	705,000.00	6,411,737.00
Arsimi i mesëm	161	1,259,469.00	98,103.00	15,000.00	-	-	1,372,572.00
Total	1,287	10,746,449.00	2,761,006.00	390,000.00	1,010,000.00	6,075,341.00	20,982,796.00

Tabela 5: Shpenzimet për 2026, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe në nënprograme:

Programet	Stafi	Paga	Mallra dhe Shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Total
Zyra e Kryetarit	23	226,900.00	55,000.00	-	230,000.00	-	511,900.00
Administrata	40	362,312.00	198,000.00	-	-	20,000.00	580,312.00
Çështjet gjinore	1	9,387.00	2,000.00	-	-	-	11,387.00
Inspektimet	10	114,751.00	70,000.00	-	-	-	184,751.00
Zyra e Kuvendit Komunal	27	257,646.00	17,000.00	-	-	-	274,646.00
Buxheti	16	153,146.00	210,000.00	-	-	130,000.00	493,146.00
Infrastruktura publike	4	45,278.00	640,666.00	250,000.00	110,000.00	1,250,000.00	2,295,944.00
Zjarrfikësit dhe inspektimet	21	198,081.00	15,000.00	-	0.00	30,000.00	243,081.00
Zyra e komuniteteve	7	105,386.00	15,000.00	-	0.00	20,000.00	140,386.00
Bujqësia	5	56,081.00	100,000.00	-	440,000.00	966,196.00	1,562,277.00
Planifikim i zhvillimit ekonomik	7	72,424.00	70,000.00	-	20,000.00	130,000.00	292,424.00
Shërbimet kadastrale	11	113,398.00	16,000.00	-	-	-	129,398.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	7	68,829.00	330,000.00	-	-	1,149,618.00	1,548,447.00
Shërbimet sociale	15	146,923.00	10,000.00	3,000.00	-	230,000.00	389,923.00
Shërbimet kulturore	13	114,464.00	80,000.00	-	120,000.00	304,000.00	618,464.00
Shëndetësia	198	2,052,616.00	450,000.00	70,000.00	80,000.00	100,000.00	2,752,616.00
Administrata e Arsimit	8	83,514.00	62,000.00	-	-	-	145,514.00
Arsimi parashkollor dhe çerdhet	34	286,750.00	89,000.00	8,500.00	-	-	384,250.00
Arsimi filior	675	6,480,094.00	233,237.00	43,500.00	-	567,796.00	7,324,627.00
Arsimi i mesëm	161	1,551,136.00	98,103.00	15,000.00	-	-	1,664,239.00
Total	1,283	12,499,116.00	2,761,006.00	390,000.00	1,000,000.00	4,897,610.00	21,547,732.00

Tabela 6: Shpenzimet për 2027, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe në nënprograme:

Programet	Stafi	Paga	Mallra dhe Shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Total
Zyra e Kryetarit	23	227,610.00	55,000.00	-	230,000.00	-	512,610.00
Administrata	40	363,678.00	198,000.00	-	-	20,000.00	581,678.00
Çështjet gjinore	1	9,410.00	2,000.00	-	-	-	11,410.00
Inspektimet	10	115,227.00	70,000.00	-	-	-	185,227.00
Zyra e Kuvendit Komunal	27	258,286.00	17,000.00	-	-	-	275,286.00
Budhetimi	16	153,647.00	230,000.00	-	-	210,000.00	593,647.00
Infrastruktura publike	4	45,460.00	680,666.00	250,000.00	110,000.00	1,300,000.00	2,386,126.00
Zjarrfikësit dhe inspektimet	21	198,906.00	15,000.00	-	-	30,000.00	243,906.00
Zyra e komuniteteve	7	105,749.00	15,000.00	-	-	21,655.00	142,404.00
Bujqësia	5	56,295.00	100,000.00	-	440,000.00	1,050,000.00	1,646,295.00
Planifikim i zhvillimit ekonomik	7	72,628.00	70,000.00	-	20,000.00	130,000.00	292,628.00
Shërbimet kadastrale	11	113,786.00	16,000.00	-	-	-	129,786.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	7	69,100.00	330,000.00	-	-	1,225,247.00	1,624,347.00
Shërbimet sociale	15	143,372.00	10,000.00	3,000.00	-	230,000.00	386,372.00
Shërbimet kulturore	13	114,956.00	80,000.00	-	120,000.00	304,000.00	618,956.00
Shëndetësia	198	2,059,414.00	450,000.00	70,000.00	80,000.00	100,000.00	2,759,414.00
Administrata e Arsimit	8	83,810.00	62,000.00	-	-	-	145,810.00
Arsimi parashkollor dhe çerdhet	34	287,551.00	89,000.00	8,500.00	-	-	385,051.00
Arsimi fillor	675	6,503,890.00	233,237.00	43,500.00	-	567,796.00	7,348,423.00
Arsimi i mesëm	161	1,556,817.00	98,103.00	15,000.00	-	-	1,669,920.00
Total	1,283	12,539,592.00	2,821,006.00	390,000.00	1,000,000.00	5,188,698.00	21,939,296.00

Tabela 7: Shpenzimet për 2028, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe në nënprograme:

Programet	Stafi	Paga	Mallra dhe Shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Total
Zyra e Kryetarit	23	228,368.00	55,000.00	-	230,000.00	-	513,368.00
Administrata	40	365,068.00	260,000.00	-	-	20,000.00	645,068.00
Çështjet gjinore	1	9,433.00	3,000.00	-	-	-	12,433.00
Inspektimet	10	115,703.00	80,000.00	-	-	-	195,703.00
Zyra e Kuverdit Komunal	27	258,926.00	18,000.00	-	-	-	276,926.00
Buxhetimi	16	154,148.00	250,000.00	-	-	260,000.00	664,148.00
Infrastruktura publike	4	45,674.00	640,666.00	320,000.00	110,000.00	1,600,000.00	2,716,340.00
Zjarrfikësit dhe inspektimet	21	199,762.00	18,000.00	-	0.00	30,000.00	247,762.00
Zyra e komuniteteve	7	106,113.00	18,000.00	-	0.00	24,281.00	148,394.00
Bujqësia	5	56,509.00	120,000.00	-	440,000.00	1,187,150.00	1,803,659.00
Planifikim i zhvillimit ekonomik	7	72,854.00	90,000.00	-	20,000.00	130,000.00	312,854.00
Shërbimet kadastrale	11	114,173.00	20,000.00	-	-	-	134,173.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	7	69,372.00	450,000.00	-	-	1,225,247.00	1,744,619.00
Shërbimet sociale	15	147,820.00	10,000.00	4,500.00	-	230,000.00	392,320.00
Shërbimet kulturore	13	115,448.00	80,000.00	-	120,000.00	304,000.00	619,448.00
Shëndetësia	198	2,066,342.00	500,000.00	80,000.00	80,000.00	100,000.00	2,826,342.00
Administrata e Arsimit	8	84,106.00	70,000.00	-	-	-	154,106.00
Arsimi parashkollor dhe çerëhet	34	288,351.00	110,000.00	10,000.00	-	-	408,351.00
Arsimi fillor	675	6,527,975.00	240,000.00	45,000.00	-	567,796.00	7,380,771.00
Arsimi i mesëm	161	1,562,615.00	100,000.00	18,000.00	-	-	1,680,615.00
Total	1,283	12,588,760.00	3,132,666.00	477,500.00	1,000,000.00	5,678,474.00	22,877,400.00

Kategoria Ekonomike – Investimet kapitale - e prezantuar në detaje më lart, paraqet një komponent të rëndësishëm të buxhetit të komunës, e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaçme në aspektin e planifikimit për Komunën e Rahovecit.

Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Prandaj, kjo kategori e shpenzimeve edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës.

Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikimi i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme.

Në këtë kontekst, përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhën afatgjate.

Shpenzimet totale të buxhetit Komunal të vitit 2025 nga granti dhe të hyrat vetanake të bartura nga vitit 2024, si dhe donacionet në pesëmujorin e parë të këtij viti, kanë arritur shumën prej 12,218,136.85 €, që përbën 56.23 % të buxhetit total.

Tabela 8. Shpenzimet nga Granti (10) dhe të hyrat vetanake (21), të barturat (22), donacionet për vitin 2024, sipas kategorive ekonomike, deri më 31.5.2025

Kategoritë e shpenzimeve	Buxheti i vitit 2025 sipas ligjit	Buxheti final 2025	Shpenzimi deri më datë 31.5.2025	Progresi përballë planit buxhetor 2025
Paga dhe Shtesa	10,746,449.00	10,746,449.00	4,647,296.80	43.24
Mallra dhe Shërbime	2,761,006.00	2,811,100.03	2,064,771.00	73.45
Shpenzime Komunale	390,000.00	390,000.00	204,195.21	52.36
Subvencione	1,010,000.00	1,060,000.00	443,548.04	41.84
Pasuritë jofinanciare	6,075,341.00	6,721,007.46	4,858,325.80	72.29
Total	20,982,796.00	21,728,556.49	12,218,136.85	56.23

Tabela 9. Shpenzimet nga Granti (10) dhe të H.V. të vitit 2024 (21), (22), donacionet sipas klasifikimit funksional (drejtorive), deri më 31.5.2025

Përshkrimi	Rregullorja buxhetore 2025 - shuma e buxhetit	Allokimi deri më 31.5.2025	Aktuale (shpenzimet) deri më 31.5.2025	Progresi përballë planit buxhetor 2025
Zyra e Kryetarit	492,000.00	215,895.42	165,268.42	33.59
Administrata	529,532.00	387,422.58	237,521.67	44.86
Çështjet gjinore	9,200.00	5,842.94	3,651.93	39.69
Inspektimet	178,000.00	123,313.24	103,734.98	58.28
Zyra e Kuvendit Komunal	282,000.00	145,332.20	113,891.45	40.39
Buxhetimi	518,524.00	384,794.58	287,764.25	55.50
Infrastruktura publike	2,470,154.03	2,215,454.37	2,011,441.00	81.43
Zjarrfikësit dhe inspektimet	225,000.00	120,488.24	94,244.16	41.89
Zyra e komuniteteve	167,772.24	87,460.88	44,133.26	26.31
Bujqësia	1,578,000.00	1,157,596.55	845,030.53	53.55
Planifikim i zhvillimit ekonomik	270,287.03	141,247.27	124,265.44	45.98
Shërbimet kadastrale	165,000.00	109,790.22	91,480.29	55.44
Planifikimi urban dhe inspeksioni	2,643,000.00	2,491,832.72	1,880,486.53	71.15
Shërbimet sociale	351,000.00	263,279.24	247,899.88	70.63
Shërbimet kulturore	869,000.00	786,324.16	511,161.13	58.82
Shëndetësia	2,655,702.00	1,633,003.66	1,405,704.51	52.93
Administrata e Arsimit	127,000.00	94,858.92	54,656.88	43.04
Arsimi parashkollor dhe çerdhet	357,500.00	203,526.62	134,785.29	37.70
Arsimi fillor	6,467,312.00	3,925,164.60	3,234,324.71	50.01
Arsimi i mesëm	1,372,573.19	802,265.09	626,690.54	45.66
Total	21,728,556.49	15,294,893.50	12,218,136.85	56.23

XI ANALIZA GJINORE - BUXHETIMI GJINOR

Komuna ka përgatitur një buxhet të përgjegjshëm gjinor të detajuar, por jemi përpjekur të vlerësojmë se si shpenzimet në Paga dhe Mëditje janë ndarë për të adresuar planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe të burrave, të djemve dhe të vajzave të punësuar, në kuadër të Komunës (administratë, shëndetësi dhe arsim), si dhe kemi bërë një analizë të hollësishme të numrit të banorëve në proporcion të burrave dhe të grave. Andaj, kemi nxjerrë të dhëna të pjesëmarrjes së gjinisë femërore në kategorinë buxhetore për Mallra dhe Shërbime, si dhe Investime kapitale (shih tabelën nr. 4).

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor

Në procesin e planifikimit dhe të shpenzimit për vitin 2026, Komuna e Rahovecit, duke u bazuar në ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020 vitit 2015, një kujdes të veçantë i ka kushtuar buxhetimit gjinor. Komuna e Rahovecit, do të ketë në fokus të vazhdueshëm edhe parashikimin dhe Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ) dhe atë sipas praktikave më të mira, të grave dhe të burrave, në mënyrë që të kontribuohet në efektivitetin dhe në transparencën e menaxhimit të financave publike, duke bërë të dukshme efektet e shpenzimeve publike.

Duhet të kuptojmë çështjet gjinore brenda komunës, si balancë mes gjinive të të gjitha grupmoshave që përfshihen në planifikim të buxhetit. Me anë të një analize gjinore gjithëpërfshirëse, komuna mund të kuptojë se ku është i nevojshëm ndryshimi dhe si buxhetet dhe programet ekzistuese ndikojnë te burrat e gratë dhe a kanë fituar njëjtë nga programet e Komunës. Kjo mund të bëhet në faza të caktuara duke identifikuar qëllimet për të rritur barazinë në mes të grave dhe të burrave.

Me mbledhjen e informatave të nevojshme të shpërndarjes së buxhetit komunal, ne mund të identifikojmë këto pabarazi, të konstatuara gjatë fazës së përpilimit (planifikimit) buxhetor, duke përdorur analiza sasiore dhe cilësore nga të gjitha drejtoritë ose programet buxhetore.

Në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve për gjininë femërore planifikojmë të buxhetojmë për vitin 2026 - 2028 (shih tabelën nr. 4):

Tabela e mëposhtme bazohet në shifrat që janë sipas listës së Pagave dhe Mëditjeve, të muajit prill 2025 dhe numrin aktual të të punësuarve.

Tabela 10. Struktura e të punësuarve sipas gjinisë

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit - gra	Numri i stafit - burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra
2023	1186	476	710	1,413,872.58	2,146,315.82
2024	1233	583	650	4,487,500.56	5,240,614.92
2025	1307	624	683	5,365,484.68	5,496,707.00
Planifikimi 2026	1283	-	-	-	-

Tabela 11. Planifikimi për vitin 2026 - Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore

Niveli i pagave	Numri i total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400	15	8	19,335.24	7	9,574.32
401-600	345	215	309,554.88	130	768,767.16
600+	947	445	4,743,176.04	502	5,011,791.84

Tabela 12. Numri i përfituesve të subvencioneve, të shërbimeve të ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)

Viti	Buxheti total i shërbimit/subvencionit të caktuar	Numri total i përfituesve	Numri total i përfituesve-gra	Numri total i përfituesve për burra	Buxheti për gra	Buxheti për burra
2024	960,402.00	1,948	1,168	780	407,109.00	553,293.00
2025	1,010,000.00	-	-	-	-	-
Planifikimi 2026	1,000,000.00	-	-	-	-	-

Tabela 13. Buxhetimi i përgjithshëm gjinor sipas kategorive ekonomike

Viti	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe Shërbime	Subvencione	Investime Kapitale
2024	3,836,086.06	1,215,165.72	45,000.00	2,959,876.52
2025	4,027,890.31	1,234,874.21	50,000.00	3,159,397.85
Planifikimi 2026	4,229,284.23	1,305,655.00	55,000.00	3,317,387.53

Në tabelën nr.13 është i përfshirë buxheti i përgjithshëm për gjininë femërore, si dhe projeksionet 2026. Në pozicionin Paga dhe Mëditje është e përfshirë gjinia femërore, të cilat janë të punësuar në kuadër të Komunës, duke përfshirë Administratën, Shëndetësinë dhe Arsimin, ku nga numri i përgjithshëm i të punësuarve prej 1287, janë 624 të gjinisë femërore me pjesëmarrje në Paga dhe Mëditje.

Në kategorinë Mallra dhe Shërbime, të dhënat janë nxjerrë nga numri i përgjithshëm i popullsisë së komunës së Rahovecit, prej 41,799 banorë, ku prej tyre, të gjinisë femërore janë: 20,879 ose 49.96 %.

Në kategorinë Investime Kapitale, të dhënat po ashtu janë nxjerrë nga numri i përgjithshëm i popullsisë së Komunës së Rahovecit, prej 41,799 banorë, ku prej tyre, të gjinisë femërore janë: 20,879 ose 49.96 %.

Kryetari i Komunës

Drejtoria për Buxhet dhe Financa



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 14/2019"), nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.06 2025, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve 2025 - 2028

1. Me këtë vendim miratohet Plani i Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve 2025 - 2028 në komunën e Rahovecit.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve 2025 – 2028
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdoset Kryetari i Komunës dhe Ekipi Komunal për të Drejtat e Fëmijëve në Komunën e Rahovecit.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetari të Komunës,
- Drejtorëve të Drejtorive,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. __/25
Datë:30.06.2025

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



**PLANI I PUNËS
PËR
EKIPIN KOMUNAL PËR TË DREJTAT E
FËMIJËVE
RAHOVEC
(2025 – 2028)**

Përmbajtja

PARATHËNIE	3
HYRJE	2
KONTEKSTI GLOBAL, NACIONAL E LOKAL	3
PARIMET DHE VLERAT	3
QËLLIMI JONË ..	5
FUSHAT E VEPRIMIT	5
OBJEKTIVAT, MASAT E VEPRIMIT	5
OBJEKTIVI 1: Ofrimi i shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijët në komunë.....	6
OBJEKTIVI 2: Zbatimi i programeve të vetëdijesimit dhe avokimit për mirëqenien e fëmijëve.....	8
OBJEKTIVI 3: Krijimi i hapësirave publike të sigurt dhe miqësore për fëmijët.....	10
OBJEKTIVI 4: Zhvillimi i fëmijëve përmes sporteve, lojës dhe rekreacionit.....	10
OBJEKTIVI 5: Sigurimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse për çështjet që lidhen me jetën e tyre	12
OBJEKTIVI 6: Bashkërendimi i veprimeve të të gjitha palëve përmes procesit të koordinimit, si dhe përmes vlerësimit dhe raportimit për gjendjen e fëmijëve në komunë. .	13
PLANI I VEPRIMIT	13
SHTOJCA: PLANI I DETAJUAR I VEPRIMIT	21

PARATHËNIE

FJALA E KRYETARIT

Plan i Punës për të Drejtat e Fëmijëve është një nismë e cila çon në drejtim të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe të drejtave të fëmijëve në qytetin tonë të Rahovecit. Në Komunën e Rahovecit jemi të vendosur të sigurojmë një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur për fëmijët tanë. Nëpërmjet Planit të Punës për të Drejtat e Fëmijëve, synojmë të rrisim ndërgjegjësimin rreth të drejtave të fëmijëve dhe të adresojmë sfidat që ata përballen në jetën e tyre të përditshme.

Padyshim, ndër qëllimet dhe prioritetet kyçe të planit tonë janë përmirësimi në arsim, duke ndërmarrë masa për të siguruar qasje të barabartë dhe cilësore në arsim për të gjithë fëmijët e komunës tonë. Kështu, do të zhvillojmë programe të cilat do të krijojnë ambiente të sigurta dhe të përshtatshme mësimore, duke mos harruar asnjëherë t'i përkrahim fëmijët me nevoja të veçanta.

Do të kujdesemi t'i mbrojmë fëmijët nga dhuna dhe abuzimi, duke mos toleruar asnjë formë të dhunës apo abuzimit ndaj fëmijëve, dhe do të ndërmarrim masa për të ndërgjegjësuar komunitetin për të siguruar ndihmë dhe mbrojtje të menjëhershme për fëmijët që janë viktimë të dhunës.

Nuk do e lëjmë pas promovimin e shëndetit dhe mirëqenies, duke pas për qëllim ta përmirësojmë shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve në komunën tonë. Do të organizojmë programe shëndetësore parandaluese, duke frymëzuar ushqyerjen e shëndetshme dhe aktivitete fizike, si dhe do të ofrojmë mbështetje psikologjike për fëmijët dhe familjet e tyre.

Gjithsesi, do të bëhen investime edhe në infrastrukturën sportive e cila do të frymëzoj më shumë aktivitete sportive në të gjitha moshat, duke ndërtuar fusha të futbollit, dhe duke ofruar hapësira të reja për talentet e ri të sportit. Do të organizohen vazhdimisht aktivitete sportive, kulturore dhe rinore për fëmijët, duke i frymëzuar ata të zhvillojnë pasionet e tyre.

Nuk do të ndalemi asnjëherë së investuari në infrastrukturën e shkollave dhe mjeteve të duhura për të përmbushur nevojat e fëmijëve, si dhe të ndërtojmë mekanizma mbrojtëse për t'i shpëtuar ata nga dhuna dhe rreziku i mundshëm.

Ne duhet të bashkëpunojmë të gjithë së bashku për të siguruar përparim të qëndrueshëm për të drejtat e fëmijëve dhe mirëqenien e tyre.

Për fund, mirënjohje dhe falenderim i veçantë për përkushtimin dhe angazhimin e Ekipit për të Drejta të fëmijëve dhe hartuesve të Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës në Rahovec (2025-2028), Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Zyrës për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZQM/ZKM) organizatave Nevo Konceptit, Save the Children Kosova/o dhe Syri i Vizionit.

Sinqerisht,

Smajl Latifi

Kryetari i Komunës së Rahovecit

HYRJE

Komuna e Rahovecit i kushton rëndësi minëqenies së të gjithë qytetarëve të saj. Me politikat dhe praktikat e saja, qeverisja komunale siguron shërbime cilësore për qytetarët, pavarësisht përkatësisë së tyre mbi çfarëdo baze. Sidoqoftë, fëmijët janë një grup i qytetarëve tanë që konsiderohen si kategori e veçantë dhe në nevojë në vështirësi të gëzimit të të drejtave të tyre të njeriut. Për shkak të moshës së tyre, ata ende nuk e kanë zhvillimin e plotë fizik, kognitiv e emocional. Prandaj varen nga të triturit në gëzimin e të drejtave të tyre. Si Komunë ne jemi të përcaktuar të vijemi në mbrojtje të të drejtave të tyre dhe në ofrimin e kushteve për zhvillim të plotë të tyre. Ky përcaktim, reflektohet në politikën qeverisëse të Komunës së Rahovecit e cila është miqësore për fëmijët

Ky Plan i Punës së Ekipit Komunal për të Drejtat e Fëmijës i hartuar do të shërbejë si dokument pune për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës, si organ i themeluar nga komuna (Vendimi nr. 5535, tq. 45, data 04.04.2025) për të mbarështuar politikat dhe praktikat në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Plan i punës është hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kombëtare dhe praktikat e promovuara të qyteteve mike për fëmijë dhe përmban fusha të ndryshme të veprimt, të nevojshme për të siguruar realizimin e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.

Procesi i hartimit të planit të punës ka qenë proces dinamik dhe me pjesëmarrje të gjerë, përfshirë sektorët komunalë, institucionet qendrore, organizatat e specializuara në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, si dhe vetë fëmijët e organizuar në Asamblenë Komunale të Fëmijëve.

Disa nga veprimet që i kanë paraprirë hartimit të kësaj strategjie janë:

- Njësia për të Drejtat e Njeriut (NDNJ) ka marrë pjesë në aktivitete për ngritje të kapaciteteve të organizuara dhe mbështetura nga akterë të ndryshëm, përfshi Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), Fondin për Fëmijë të Kombeve të Bashkuara (UNICEF) dhe organizatat Save the Children Kosovo/a dhe Syri i Vizionit.
- Janë organizuar konsultime paraprake me palë të ndryshme që kanë ndihmuar në mbledhjen e informatave themelore dhe përgatitjen e procesit të planifikimit;
- Është organizuar një punëtori dyditësh e planifikimit me pjesëmarrje, ku janë identifikuar fushat e veprimt, si dhe është përcaktuar logjika e intervenimit;
- Është organizuar konsultimi me përfaqësuesit e fëmijëve nga Asambleja Komunale e Fëmijëve për të marrë perspektivën e fëmijëve dhe sugjerimet e tyre lidhur me planin e punës;
- Është mbajtur një takim përcjellës me një grup të ngushtë punues në nivel komunal për të validuar përmbajtjen e planit të punës.

I gjithë procesi është udhëhequr nga Kryesuesi i Ekipi për të Drejtat e Fëmijës, njëherit kryetari i komunës së Rahovecit z. Smajl Latifi, Zv/kryesuesja e Ekipit znj. Saranda Sallteku, Drejtoreshë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, dhe Njësia për të Drejtat e Njeriut, në koordinim, mbështetje dhe konsultim me MAPL, organizatën Nevo Koncepti, Save the Children Kosovo/a, Syri i Vizionit, dhe Asamblenë Komunale të Fëmijëve.

KONTEKSTI GLOBAL, NACIONAL E LOKAL

Kushtetuta e Kosovës, në nivel të përgjithshëm përcakton mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kapitulli II i Kushtetutës rregullon të drejtat dhe liritë themelore duke rregulluar zbatimin e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën për të Drejtën e Fëmijës¹ e cila vendos standardet themelore në fushën e të drejtave të fëmijëve në nivel global.

Në Kosovë në vitin 2019 është miratuar Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës² i cili i ka hapur rrugën operacionalizimit të tij përmes akteve nënligjore dhe krijimit e funksionimit të mekanizmave mbrojtës për fëmijët. Kështu Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës ndër të tjera përcakton që secila komunë e Republikës së Kosovës të krijojë Ekipin për të Drejtat e Fëmijës në nivel të vendimmarrjes politike. Në nenin 20 të këtij Ligji jepen edhe konturat e fushëveprimit të këtij ekipi, gjersa Udhëzimi Administrativ 06/2022³ përcakton mënyrën e themelimit dhe aspektet e funksionimit të këtij ekipi.

Kryetari i Komunës së Rahovecit, në përputhje me UA 06/2022, më 30.03.2023 ka nxjerrë vendim për themelimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës. Mbledhja konstitutive për themelimin e Ekipit është mbajtur me datë 10 dhjetor 2024. Ekipi aktual funksionon në përputhje me Vendimin nr. 5535 të datës 04.04.2025.

Ky plan trevjeçar i punës i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës është hartuar në përputhje me parimet e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, me politikat e nivelit qendror e lokal, si dhe me konceptin e komunave mike për fëmijë.

PARIMET DHE VLERAT

Në Komunën e Rahovecit promovohet modeli i qeverisjes lokale gjithëpërfshirëse që u shërben njësorj të gjithë qytetarëve, duke u krijuar mundësi të barabarta për të shprehur potencialin e tyre dhe për të kontribuar aktivisht në mirëqenien e përgjithshme të shoqërisë. Një model i kështillë promovohet edhe në raport me fëmijët. Fëmijët nuk janë marrës pasivë të shërbimeve të të rriturve por anëtarë aktivë të komunitetit. Si të tillë edhe trajtohen, duke i përfshirë në proceset komunale që lidhen me jetën e tyre dhe duke krijuar kushtet që të zhvillojnë gjithë potencialin e tyre. Si ekip e si komunë, jemi të përcaktuar që proceset në komunë të jenë jo vetëm “për fëmijët” por edhe “me fëmijët”.

Në punën tonë si ekip, udhëhiqemi nga parimet themelore të të drejtave të fëmijëve të sanksionuara në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës:

- **Mosdiskriminimi** – i garanton fëmijës të drejtat e plota pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij, apo përfaqësuesve të tij ligjorë. Andaj, të gjitha institucionet, ofruesit e shërbimeve, profesionistët për mbrojtjen e

¹ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës <https://www.ohchr.org/sites/default/files/crc.pdf>

² Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

³ Udhëzimi Administrativ 06/2022 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61596>

fëmijës, duhet të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit.

- **Interesat më të mira të fëmijës** – sipas të cilit të gjitha veprimet dhe vendimet, në të gjitha fazat, që kanë të bëjnë me fëmijën, të ndërmarra nga prindërit, institucionet dhe nga profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, duhet të jenë në interesin më të mirë të fëmijës dhe interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.
- **Jeta, mbijetesa dhe zhvillimi** – të gjithë fëmijëve duhet t'u sigurohet mbijetesa dhe zhvillimi deri në masën më të madhe të mundshme. Zhvillimi përfshin edhe dimensionin e cilësisë: jo vetëm shëndeti fizik, por edhe zhvillimi mental, emocional, kognitiv, social dhe kulturor
- **Pikëpamjet e fëmijës** – fëmijët duhet të jenë të lirë të shfaqin pikëpamjet lidhur me çdo çështje që ndikon në ta dhe këtyre pikëpamjeve duhet t'u jepet peshë e duhur në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijëve.

Ndërtimin e komunës mike për fëmijë e ushqejnë përmes vlerave të përbashkëta. Këto vlera lidhen me komunën ku fëmijët:

- Ndjehen të pranuar, vlerësuar dhe përfshirë, pa diskriminim;
- Dëgjohen dhe kanë ndikim në vendimarrje ku preken interesat e tyre;
- Janë të mbrojtur nga çdo formë dhune, abuzimi, apo neglizhimi;
- Janë dhe ndihen të sigurt kudo që ndodhen;
- Luajnë, argëtohen dhe zhvillojnë potencialin e tyre në ambiente dhe aktivitete cilësore dhe gjithëpërfshirëse;
- Përfshihen lirshëm dhe aktivisht në jetën komunitare;
- Ndërtojnë ndjenjën e përkatësisë dhe përgjegjësisë ndaj komunitetit.

QËLLIMI JONË

Krijimi i një sistemi qeverisës komunal që siguron mbrojtjen, zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve të komunës, përmes bashkërendimit të të gjithë sektorëve komunalë dhe grupeve të interesit.

Komuna e Rahovecit do të ofrojë një model të qeverisjes lokale që si konsideratë mbizotëruese do t'i ketë interesat më të mira të fëmijëve s. Përmes bashkërendimit të punëve të të gjithë sektorëve komunalë, do të ofrojmë shërbime shumëdimensionale për fëmijët. Në të gjitha fushat e veprimit do të krijojmë lidhje bashkëpunimi me partnerët dhe komunitetin, që fëmijëve t'u krijojmë një mjedis jetësor të këndshëm, mbështetës dhe nxitësmundësues. Vëmendje të vazhdueshme do t'i kushtojmë përfshirjes aktive të vetë fëmijëve në të gjitha proceset vendimmarrëse në komunë që lidhen me jetën e tyre. Jemi të bindur se vetëm kështu fëmijët tanë do të bëhen qytetarë të ndërgjegjshëm.

FUSHAT E VEPRIMIT

Janë identifikuar gjashtë fusha të veprimit në kuadër të planit të punës. Këto fusha, ndonëse janë të veçanta, në asnjë mënyrë nuk mund të adresohen si të vetme. Përkundrazi ato janë të lidhura ngusht në mes veti dhe e plotësojnë njëra-tjerën, duke e bërë planin e punës koherent e gjithëpërfshirës.

1. Shërbimet cilësore dhe gjithëpërfshirëse për fëmijë

2. Vetëdijesimi dhe avokimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

3. Hapësira të sigurta dhe miqësore për fëmijë

4. Aktivitete argëtuese dhe edukative për fëmijë (sport, kulturë, edukim joformal, lojë dhe rekreacion

5. Pjesëmarrja e fëmijëve

6. Koordinimi, vlerësimi dhe raportimi

OBJEKTIVAT, MASAT E VEPRIMET

Këto fusha prioritare, janë përkthyer në objektiva strategjike dhe më tutje përmbajnë masa që përmbushin këto objektiva. Secila masë brenda objektivit përkatës është zbërthyer më tutje në veprime konkrete, që shërbejnë si udhërrëfim në fazën e zbatimit të planit të punës.

OBJEKTIVI 1: Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe gjithëpërfshirëse për fëmijë

Në synojmë përmirësimin e shërbimeve në sektorë kyç si mirëqenia sociale, arsimi, shëndetësia dhe shërbimet publike, duke krijuar kushte sa më të mira për zhvillimin e plotë të fëmijëve në komunë. Në secilin sektor do të identifikohen nevojat specifike dhe shërbimet që duhet të përmirësohen apo të plotësohen me ndërhyrje të reja.

Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet fëmijëve në situata më të ndjeshme, përfshirë ata nga familje përfituese të ndihmës sociale, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në rrethana të jashtëzakonshme dhe ata që u përkasin komuniteteve joshumicë.

Përveç përmirësimit të drejtpërdrejtë të shërbimeve për fëmijët, do të ofrohet mbështetje për familjet dhe komunitetin përmes programeve edukative, si dhe do të investohet në ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve për të siguruar cilësi dhe gjithëpërfshirje në ofrimin e shërbimeve.

1.1 Përmirësimi i qasjes në informata për llojet e shërbimeve sociale për fëmijë në Komunë

Do të krijohet një sistem për të mbajtur publikun të informuar për të gjitha shërbimet që ofrohen në komunë. Fillimisht do të bëhet evidentimi i të gjitha shërbimeve ndaj fëmijëve. Më tutje do të zhvillohet një katalog digjital i llojeve të shërbimeve sociale që ofrohen dhe i ofruesve të shërbimeve. Do të organizohet një fushatë informuese përmes institucioneve publike, medias lokale, ueb faqes së komunës dhe kanaleve tjera të komunikimit.

1.2 Ndarja e fondit për fëmijët në rrethana të jashtëzakonshme

Fëmijët që gjenden në rrethana të jashtëzakonshme kërkojnë përkrahje institucionale në kuptim të ofrimit të shërbimeve profesionale, por edhe ofrimit të shërbimeve logjistike, siç janë ushqimi, transporti, akomodimi, etj. Për këtë arsye do të ofrohet një financim emergjent për këta fëmijë dhe do të krijohet një sistem për menaxhimin e këtij financimi dhe këtyre shërbimeve emergjente. Do të evidentohen nevojat për shërbime emergjente dhe do të kontraktohen operatorët ekonomikë për ofrimin e këtyre shërbimeve.

1.3 Fuqizimi i konceptit të familjeve strehuese dhe farefisnore

Koncepti i familjeve strehuese dhe farefisnore është provuar si i suksesshëm, prandaj edhe është i paraparë me Ligjin për mbrojtjen e fëmijës. Ne do ta promovojmë si shërbim dhe do të ndërmarrim një fushatë për të rritur numrin e familjeve strehuese. Do të bëjmë identifikimin dhe vlerësimin e familjeve strehuese dhe farefisnore dhe do të trajnojmë këto familje. Trajtimi i fëmijëve brenda këtyre familjeve do të monitorohet.

1.4 Zhvillimi i praktikave të prindërimit të mirë dhe disiplinimit pozitiv

Do të krijohen bashkëpunimi me Organizata të Shoqërisë Civile (OshC) për përditësimin e moduleve ekzistuese të prindërimit të mirë për nevoja të komunitetit, për ofrimin e moduleve të trajnimit, ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe shpërndarjen praktikave të prindërimit të mirë përmes trajnimeve e sesioneve të informimit.

1.5 Krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët për ta regjistruar, vizuar dhe përfunduar shkollën

Arsimi i obligueshëm nënkupton që çdo fëmijë i moshës shkollore ta vijojë shkollimin. Megjithatë, edhe në komunën tonë ballafaqohemi me raste të mosregjistrimit, mosvijimit të rregullt dhe braktisjes së shkollimit. Ne do të marrim masa për gjithëpërfshirje në shkollim, me fokus të veçantë tek komunitetet joshumice. Do të krijohet një sistem i komunikimit mes shkollave dhe zyrave të regjistrimit civil për t'i marrë të dhënat e fëmijëve të moshës shkollore nga zona që gravitojnë shkollat, në mënyrë që të lehtësohet procesi i regjistrimit në shkollë. Shkollat do të mirëmbajnë bazën e të dhënave me të dhëna për nxënësit sipas modelit të Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA). Më tutje, do të funksionalizohen Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM), si dhe do të bashkëpunohet ngushtë me organizatat që punojnë në fushën e gjithëpërfshirjes në arsim.

1.6 Ofrimi i shërbimeve profesionale nëpër shkolla

Do të trajnohen mësindhënsit për identifikimin e hershëm të fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale pedagogjike dhe psikologjike dhe krijohet/funksionalizohet mekanizmi për referimin e fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale. Po ashtu do të identifikohen nevojat për mësindhëns mbështetës dhe asistentë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe do të angazhohen personel të këtyre kualifikimeve në shkollat e komunës.

1.7 Inspektimi i cilësisë së hapësirave shkollore

Gjendja e objekteve shkollore ndikon shumë në cilësinë e arsimit. Prandaj, ekipet profesionale do ta inspektojnë gjendjen e shkollave (inspekum të vjetërsisë së objekteve, sanitarisë, hapësirave për lojë e rekreacion, pajisjeve shkollore, etj). Këto ekiye do të inspektojnë objektet shkollore në baza vjetore dhe do të dorëzojnë raportet vlerësuese. Mbi bazën e raporteve do të ndërmerren masa përmirësuese me qëllim të krijimit të objekteve dhe mjediseve shkollore miqësore për fëmijë. Standardet e shkollave miken për fëmijë do të promovohen vazhdimisht.

1.8 Krijimi i mekanizmave brenda shkollave për mirëmbajtje të mjediseve shkollore

Kultura shkollore duhet ta ketë pjesë të saj të vazhdueshme mirëmbajtjen e objekteve shkollore. Prandaj për të siguruar angazhimin e të gjitha palëve në shkollë në këtë drejtim, do të vetëdijesohen nxënësit dhe palët tjera për nevojën e mirëmbajtjes dhe kujdesin ndaj mjedisit shkollor. Do të hartohet dhe publikohet një udhëzues me praktika të mira të mirëmbajtjes së hapësirave shkollore. Do të realizohen aktivitete kreative me bazë në shkollë për mirëmbajtje të mjediseve. Çdo vit do të ndahen shpërblime për komunitetet më të vyeshme shkollore.

1.9 Promovimi shëndetësor, përmes informimit, komunikimit dhe edukimit

Do të promovohet shëndeti përmes fushatës vetëdijësuese për shëndetin dhe të ushqyerit e foshnjave, fëmijëve dhe adoleshentëve, si dhe përmes edukimit shëndetësor të qytetarëve e ligjëratarëve për edukimin shëndetësor dhe reproduktiv për nxënësit e shkollave. Po ashtu, do të organizohen ligjërata për parandalimin e abuzimit me substanca psikotrope. Aktivitet tjetër i planifikuar është ofrimi i granteve për organizatat të cilat punojnë në ofrimin e shërbimeve sociale.

1.10 Organizimi i vizitave multidisiplinare shëndetësore për fëmijët, në baza periodike

Do t'i kushtohet kujdes ofrimit të shërbimeve të individualizuara shëndetësore për secilin fëmijë. Prandaj, do të zhvillohen kapacitetet e profesionistëve shëndetësorë për kujdes shëndetësor ndaj nënës dhe fëmijës, këshillim për të ushqyerit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël dhe përkrahje të zhvillimit në fëmijërinë e hershme. Do të organizohet shërbimi i vizitave sistematike nëpër shtëpi, të cilat do të kenë përveç komponentit të intervenimit shëndetësor edhe atë edukativ. Do të zbatohen praktikat efektive të kujdesit perinatal dhe vizitave për nënat dhe fëmijët. Kontrollat sistematike shëndetësore do të realizohen edhe nëpër shkolla të nivelit të mesëm të ulët.

1.11 Identifikimi i hershëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara

Do të hartohet dhe përdoret një formular për deklarimin e prindit për gjendjen shëndetësore të fëmijës, gjatë regjistrimit në shkollë. Do të përditësohet baza e të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Do të rithemelohej dhe funksionalizohet Ekipi vlerësues pedagogjik në komunë^{4,5}. Për ata fëmijë që kanë parametra që identifikojnë nevojën për kontroll më të hollësishëm, do të ndërmerren vlerësime dhe do të rekomandohen masa që duhet ndërmarrë shkolla (mësimdhënësit, menaxhmenti i shkollës, prindërit). Do të promovohen shërbimet institucionale dhe ato të ofruesve të tjerë të shërbimeve për fëmijë me aftësi të kufizuara.

1.12 Ofrimi i shërbimeve të veçanta për kategoritë e fëmijëve në nevojë

Do të ofrohen shërbime shumëdimensionale dhe rehabilitim i bazuar në bashkësi për FNV, përmes subvencionimit të organizatave të licencuara për ofrimin e këtyre shërbimeve. Do t'i kushtohet kujdes sigurimit të qasjes fizike të fëmijëve me aftësi të kufizuara në hapësirat publike duke i paraprirë me identifikimin e nevojave për sigurimin e qasjes fizike. Më tutje do të ofrohen programe të mbështetjes shtesë për fëmijët nga grupet e cënueshme (komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, fëmijët në situatë rruge/lëmoshëkërkuar, fëmijët e përfshirë në forma të rrezikshme të punës⁶, fëmijët viktime të trafikimit, etj.). Programe të tilla do të jenë mësimi shtesë përmes qendrave mësimore, përfshirja në aktivitete rekreative të qendrave rinore, Organizatave Joqeveritare (OJQ) dhe palëve tjera relevante, sesione këshillimi, etj. Për më shumë, do të avancohet komunikimi ndërmjet palëve kryesore (Qendrës për Punë Sociale, Kujdesit Parësor Shëndetësor, Personelit Arsimor, Policisë, Gjykatës, Organizatave Joqeveritare, etj) për një referim dhe kujdes ndaj fëmijëve në nevojë⁷.

OBJEKTIVI 2: Vetëdijesimi dhe avokimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

⁴ Ligji për Arsimin Parauniversitar 04/l-32 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>

⁵ Udhëzimit Administrativ 16/2017 <https://masht.rks-gov.net/ua-me-nr-16-2017-e-dt-22-12-2017-vloresimi-pedagogjik-i-femijeve-me-nevoja-te-vecanta-arsimore/> dhe <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=90272>

⁶ Udhëzim Administrativ (Qrk) - Nr. 02/ 2024 Për Parandalimin Dhe Ndalimin E Formave Të Rrezikshme Të Punës Së Fëmijëve Në Kosovë <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=89068>

⁷ Rregullore (Qrk) - Nr. 23/2023 Për Procedurat E Punës Në Tryezat Multidisiplinare Për Ndihmë Në Menaxhimin E Rastit <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=85125>

Ne duam që në bashkëpunim udhëinstitucional dhe me partnerët tanë, të krijojmë një sistem efektiv për të vetëdijësuar të rriturit dhe fëmijët për të drejtat e fëmijëve, mirëqenien e fëmijëve dhe për komunën mike. Programet për informim dhe zhvillim profesional për të gjitha palët duke përfshirë edhe politikëbërësit e zyrtarët më të lartë komunalë, janë të një rëndësie të veçantë. Në të njëjtën kohë, ne do t'i inkurajojmë organizatat e shoqërisë civile, agjencitë e pavarura që të avokojnë për fëmijët. Ndërkaq, do të shfrytëzohet edhe media për promovimin e të drejtave të fëmijës.

2.1 Ngritja e kapaciteteve të politikëbërësve dhe zyrtarëve komunalë lidhur me të drejtat e fëmijëve

Me rëndësi konsiderohet që politikëbërësit dhe zyrtarët komunalë si bartës të funksioneve, të jenë mirë të informuar dhe të kenë aftësi vlerësimi e gjykimi për aspekte të të drejtave të fëmijëve. Prandaj, do të organizohen trajnime mbi njohjen dhe promovimin e të të drejtave të fëmijëve, instrumenteve ndërkombëtare, legjislacionit dhe rregullativës që lidhet me të drejtat e fëmijëve, vlerësimin dhe raportimin të gjendjes së fëmijëve, standardeve të operimit, investimit publik në fëmijë, etj.

2.2 Organizimi i fushatave vetëdijësuese për të rriturit dhe për fëmijët

Qytetarët duhet të vetëdijësohen për atributet e komunës mike për fëmijë dhe të aktivizohen si qytetarë të përgjegjshëm. Prandaj, do të organizohen fushata vetëdijësuese për të rritur dhe fëmijë. Fushatat do të përfshijnë ligjëratat publike, shpërndarjen e materialit promovues, ofrimin e trajnimeve me profesionistë të fushave të ndryshme si dhe me prindër, etj. Ndërsa fëmijëve do t'u ofrohen programe për të drejtat e njeriut dhe qytetarinë aktive brenda kurrikulit shkollor dhe përmes edukimit joformal.

2.3 Mbështetja e Organizatave joqeveritare, Asamblesë Komunale të Fëmijëve, Këshillit të Nxënësve dhe institucioneve të pavarura në avokimin për të drejtat e fëmijës

Ne do të jemi transparentë dhe të gatshëm për të shqyrtuar e për adresuar opinionet e të gjitha palëve lidhur me qeverisjen komunale. Në vështrim të veprimit të përgjegjshëm karshi fëmijëve, do t'i mbajmë dyert e hapura për organizatat joqeveritare, koalicionet e tjetret që monitorojnë, promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Për më shumë, do të përkrahet puna e tyre. Po ashtu do të mundësohet dhe përkrahet puna e vetë Asamblesë së Fëmijëve, Këshillit të Nxënësve dhe të rinjve në avokimin për të drejtat e tyre.

2.4 Promovimi i të drejtave të fëmijës përmes medias

Shfrytëzimi i medimeve të ndryshme për të gjeneruar lajme të përgjegjshme për fëmijët dhe në interesin më të mirë të tyre është shumë i rëndësishëm. Për të siguruar këtë, do të ofrohen udhëzues dhe trajnime për zyren komunale për marrëdhënie me publikun, për sekretariatën e ekipit si dhe për mediat e profesionistët e mediave. Do të përkrahen mediat që të promovojnë të drejtat e fëmijëve dhe që të paraqesin gjendjen e fëmijëve në mënyrë transparente e reale.

2.5 Zbatimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës në të gjitha Institucionet parauniversitare

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës është zotimi dhe përgjegjësia e institucionit për të garantuar dhe siguruar mbrojtjen e fëmijës, përmes dijes dhe punës profesionale, etikës së punës, aftësisë dhe shkathësisë të personelit të institucionit arsimor, për të identifikuar dhe parandaluar

rreziqet dhe dëmet, për të vlerësuar me kompetencë ngjarjet, si dhe për të reaguar në përputhje (përshtatshmërisht) me rrethanat e ngjarjes dhe fëmijën. Qëllimi i kësaj politike është krijimi i një mjedisi të sigurtë për të gjithë fëmijët në institucionet e arsimit para-universitar publik dhe privat në Kosovë, duke vendosur parime dhe rregulla, të cilat duhet respektuar denjësisht. Politika e mbrojtjes, e fuqizon punën, përkushtimin, rregullin, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien brenda institucionit edukativ, arsimor dhe aftësues, si dhe në raport me autoritetet tjera.

OBJEKTIVI 3: Sigurimi i hapësirave të sigurt dhe miqësore për fëmijë

Ne duam që hapësirat të cilat frekuentojnë fëmijët të jenë plotësisht të parrezikshme për ta dhe t'u krijojnë atyre ndjenjën e sigurisë në çdo kohë, edhe atëherë kur janë vetëm. Komuna do të përfshijë aktivisht fëmijët dhe prindërit në konsultime gjatë rregullimeve urbanistike, do të përmirësojë higjienën kolektive, do të krijojë kushte për qarkullim të lirë e trafik të sigurt, do të shmang rreziqet në hapësira publike dhe do të krijojë mjedis ekologjik.

3.1 Sigurimi i sistemit të trafikut që është i sigurt dhe miqësor për fëmijët

Hapësirat për këmbësor jo të sigurt, dhe mungesa e ndriçimit publik dhe sinjalistikësmë së shumti kërcënon fëmijët. Për të përmirësuar këtë situatë, do të hartohen dhe zbatohen projekte për lirim të trotuareve dhe vendkalimeve për këmbësorë, vendosjen e shenjave të vendkalimeve, vendosjen e barrierave, ndriçimin publik, etj. Ndërkaq, me të gjithë pjesëmarrësit në trafik do të ndërmerret një fushatë informimi për sigurinë në trafik.

3.2 Eliminimi i rreziqeve dhe krijimi i mjedisit ekologjik

Hapësirat publike shpesh përbëjnë rrezik për fëmijët, për shkak të dëmtimeve të këtyre hapësirave. Prandaj, do të monitorohen në mënyrë sistematike hapësirat publike për të identifikuar rreziqet eventuale për fëmijët (shtretërit e lumenjve, deponitë, rrënojat, gropat e pusetat e pambuluara, trotuarët e vendkalimet e pashenjuara, lodrat për fëmijë, etj.) dhe do të merren masa për eliminimin e tyre. Komuna do të mbështetet edhe në ndihmën e publikut në raportimin e rreziqeve të tilla. Kështu, do të promovohet një linjë kontakti për publikun për raportimin e rreziqeve si dhe do të merren masa për eliminimin e tyre në afat sa më të shkurtër.

Për shkak të koncentrimit të madh të fëmijëve rreth shkollave, do të merren masa për të parandaluar rreziqet përreth shkollës, që mund të vijnë nga prania e personave të dyshimtë, persona të sëmurë mendor, shitja e artikujve të dëmshëm; duhani, alkooli, substancat psikotrope, ngasja e shpejtë e veturave, etj. Po ashtu në nivel komune dhe në bashkëpunim edhe me nivelin qendror do të bëhet sistemimi i qenve endacakë.

Më tutje do të ndërmerren veprime të rritjes së hapësirave të gjelbra e parqeve në qytet, si dhe pyjeve në pjesën rurale.

OBJEKTIVI 4: Zhvillimi i aktiviteteve argëtuese dhe edukative për fëmijë (sport, kulturë, edukim joformal, lojë dhe rekreacion

Loja, rekreacioni, sporti, edukimi e kultura janë elemente të rëndësishme të zhvillimit të fëmijëve dhe segmente ku ata shfaqin talentet e tyre. Prandaj, do të promovohet pjesëmarrja e fëmijëve nëpër klube sportive e institucione kulturore. Shkollat do të jenë institucionet që përtej kurrikulit formal do të krijojnë hapësirën dhe mundësinë për aktivitete të kohës së lirë, rekreacion e sport për nxënësit. Po ashtu, shkollat do të krijojnë lidhjet me klubet sportive, klubet artistike e kulturore, në mënyrë që të gjithë fëmijët të mund t'i zhvillojnë më tutje talentet e tyre në fushat në të cilat kanë interesim. Hapësirat publike do të adaptohen që të sigurojnë argëtim e kohë të lirë për fëmijët e qytetit e fshatit pa dallim.

4.1 Promovimi i sportit nëpër shkolla

Në nivel të shkollave do të zhvillohen kapacitetet njerëzore që do të marrin përgjegjësinë e promovimit të sportit shkollor. Do të krijohen klubet sportive në nivel të shkollave dhe do të organizohen gara shkollore në sporte të ndryshme. Rëndësi do t'i kushtohet përfshirjes gjinore dhe thyerjes së stereotipeve gjinore.

4.2 Funkcionalizimi i klubeve sportive të kategorive të reja

Do të punohet me klubet sportive ekzistuese në aktivizimin e klubeve për kategoritë e reja për vajza dhe djem. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet inkuadrimit të barabartë gjinor në këto klube. Për të rekrutuar fëmijë dhe të rinj në klube, do të bashkëpunohet me shkollat dhe OJQ-të do të mbahen kampe për identifikimin e talentëve.

4.3 Promovimi i artit, kulturës dhe teknologjisë

Do të ofrohen programe artistike e kulturore nëpër shkolla, ku fëmijët do të demonstrojnë shkathtësitë e tyre. Klubet artistike e kulturore të shkollave do të lidhen me OSHC të ndryshme, përfshi të artit e kulturës si teatro, ansamble të këngëve e valleve, klube leuare, etj., për të ofruar mundësi shtesë për vajza e djem që kanë afinitet në këto fusha. Po ashtu, do të përkrahen shkollat dhe institucionet në promovimin e hapësirave për programim, kodim, ueb dizajn, etj.

4.4 Ofrimi i hapësirave joformale për rekreacion

Lagjet duhet të ofrojnë hapësira të rekreacionit ku fëmijët mund të çlodhen e shoqërohen. Për këtë arsye, do të inspektohet situata me parqet ekzistuese dhe do të identifikohen nevojat për hapësira shtesë për lojë. Më tutje, do të intervenohet në adaptimin e hapësirave ekzistuese për lojë dhe në ndërtimin e hapësirave të reja. E gjithë kjo do të bëhet në përputhje me standardet e hapësirave të sigurta e miqe për fëmijë. Do të krijohet një partneritet mes komunës dhe komunitetit duke krijuar ekipet e përbashkëta për mirëmbajtjen e hapësirave rekreative. Për t'i kthyer keto hapësira komunitare në hapësira gjithëpërfshirëse, do të bëhet identifikimi i nevojave për rekreacion i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe përfshirja e tyre në parqet ekzistuese.

4.5 Angazhimi vullnetar i fëmijëve në aktivitete në të mirë të komunitetit

Po aq me rëndësi është që fëmijëve t'u ofrohen mundësi që këtë kohë rekreacioni ta shfrytëzojnë për aktivitete që janë me përfitim për komunitetin. Kësisoj ata i zhvillojnë vlerat qytetare dhe përgjegjësinë për komunitetin. Në bashkëpunim me OshC komunë do të organizojë kampe me fëmijë dhe të rinj nga shkollat e ndryshme, si dhe nga Asambleja e Fëmijëve. Këto kampe do të jenë të natyrës rekreative, edukative, mjedisore, etj. Qëllimi i këtyre kampeve do të jetë që

fëmijët dhe të rinjtë të motivohen për mësim shtesë në të gjitha lëndët shkollore. Përmes këtyre aktiviteteve-kampeve fëmijët dhe të rinjtë do të largohen nga përdorimi i tepruar i teknologjisë dhe dukurive të tjera negative.

Do të organizohen bashkëpunime, vizita e takime edukative e kulturore në institucionet që mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Më tutje, do të bëhet angazhimi i fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete në përfitim të komunitetit si mbjellja e drunjëve, ofrimi i ndihmës së parë, evakuimi, siguria në trafik, etj.

OBJEKTIVI 5: Sigurimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse për çështjet që lidhen me jetën e tyre

Ne duam që fëmijët, në varësi të zhvillimit gradual të aftësive të tyre, të marrin pjesë aktivisht në vendimet për komunën, sidomos në ato që lidhen drejtpërdrejt me jetën e tyre. Do të mbështesim edhe familjet që të ndjekin këtë qasje që nga fëmijëria e hershme, kurdo që vendoset për jetët e fëmijëve të tyre. Institucionet arsimore kanë një rol të madh në fuqizimin e fëmijëve në pjesëmarrje. Strukturave përfaqësuese të fëmijëve në nivele të ndryshme do t'u ofrohet hapësirë veprimi dhe përkrahje nga të rriturit në zhvillimin e kapaciteteve të tyre. Organet vendimmarrëse në të gjithë sektorët e komunës do të ndjekin procedurat e konsultimeve me fëmijë para se të marrin vendime që ndikojnë në jetën e fëmijëve.

5.1 Përcaktimi dhe zbatimi i procedurave për përfshirjen e fëmijëve në proceset vendimmarrëse që lidhen me jetën dhe interesin më të mirë të tyre

Do të përcaktohen procedurat për konsultimin e fëmijëve për të gjitha palët në komunë që marrin vendime për fëmijët dhe në përgjithësi për qytetarët e komunës. Këto procedura do të paraqiten përmes një udhëzuesi praktik. Do të monitorohet zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijë nga të gjithë sektorët komunalë me rastet e hartimit të projekteve zhvillimore, strategjive e planeve të veprimit, me rastin e planifikimit të buxhetit, etj, në çështjet që ndërlidhen me jetën e fëmijëve.

5.2 Fuqizimi i organeve përfaqësuese të fëmijëve

Këshillat e nxënësve janë organe të nxënësve të parapara me ligj. Ndonëse ato janë të themeluara në të gjitha shkollat, funksionimi i tyre duke përfshirë mënyrën e përzgjedhjes dhe mandatin e angazhimit të tyre është larg prej standardeve të përfaqësimit demokratik. Prandaj, do të nxitet funksionimi i rregullt i organeve përfaqësuese të nxënësve në të gjitha nivelet, duke filluar nga këshillat e nxënësve nëpër klasa, e deri te Asambleja Komonale e Fëmijëve. Këto organe duhet të jenë gjithëpërfshirëse në kuptim të përfaqësimit gjinor, gjeografik, etnik, të aftësive, etj. Më tutje, do të zhvillohen kapacitetet e fëmijëve për pjesëmarrje demokratike në jetën shkollore dhe të komunitetit, përmes moduleve të trajnimit për udhëheqje e aktivizim qytetar. Një aspekt qenësor është rregullimi i marrëdhënieve në mes vetë nxënësve. Për këtë arsye do të promovohet ndërmjetësimi në mes moshatarëve si qasje për të adresuar problemet, konfliktet, ngacmimet e dhunën në shkollë, në lagje dhe në të gjitha ambientet ku fëmijët mund të ndodhen. Do të identifikohen fëmijë që mund të angazhohen si ndërmjetësues dhe të trajnohen për aspekte të ndërmjetësimit në mes moshatarëve.

OBJEKTIVI 6: Bashkërendimi i veprimeve të të gjitha palëve përmes procesit të koordinimit, si dhe përmes monitorimit dhe raportimit të zbatimit të Planit

Ne duam që i gjithë procesi i zbatimit të planit të punës të refletojë qeverisjen e mirë dhe miqësore për fëmijë. Prandaj, është me shumë rëndësi që ky proces të jetë me pronësi të gjerë, ku të gjitha palët do të bashkërendojnë veprimet me qëllimin që të adresohen masat e definuara me planin e punës. Ndërsa, për të vlerësuar efikasitetin dhe siguruar cilësinë na nevojitet monitorim dhe hartimi i raporteve për zbatimin e aktiviteteve dhe gjendjen e fëmijëve të komunës.

6.1 Monitorimi dhe vlerësimi

I gjithë procesi i qeverisjes miqësore për fëmijë, i bashkërenduar përmes planit të punës ka nevojë t'i nënshtrohet procesit të monitorimit dhe vlerësimit të ndikimit që ka në fëmijë. Prandaj, fillimisht do të mbledhen të dhëna lidhur me të gjitha aspektet e qeverisjes, që do të shërbejë për monitorim e vlerësim të zbatimit të planit të punës. Pastaj, do të bëhet vlerësimi periodik i ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale dhe aspekteve të planit të punës për të drejtat e fëmijës. Raportet nga vlerësimi do të diskutohen në nivel të ekipit komunal dhe po ashtu përfshihen në politikat dhe praktikën e qeverisjes lokale.

6.2 Koordinimi me palët relevante

Qasja e bashkëpunimit me të gjitha palët, është parim i punës së qeverisjes komunale në përpjekjen për një komunë miqe për fëmijë. Prandaj, do të mbajmë komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me palët e ndryshme si në nivelin lokal (me organizata joqeveritare, grupe joformale, bashkësi lokale, këshilla, etj.), ashtu edhe në nivelin rajonal e qendror (me institucionet qendrore/rajonale që ofrojnë shërbime në nivel komunal, por edhe me vetë qeverisjen qendrore). Kjo do të na ndihmojë që të sigurojmë politika të mira për fëmijët, si dhe të kërkojmë përkrahje shtesë nga niveli qendror për nevojat e fëmijëve të komunës.

6.3 Vlerësimi dhe raportimi

Plani i veprimit do t'i nënshtrohet vlerësimit periodik në baza gjashtëmuajshe, prej nga do të nxjerren raportet, të cilat do të shërbejnë për periudhat vijuese të zbatimit. Ndërsa në fund të periudhës së zbatimit të planit trevjeçar do të bëhet vlerësimi përfundimtar i zbatimit të këtij plani dhe do të hartohet raporti i cili do të shërbejë si burim për planifikimin e planit të ardhshëm disavjeçar.

PLANI I VEPRIMIT

0	Objektiva strategjike
0.0	Masa
	Veprimi

1	Ofrimi i shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijët në komunë
1.1	Përmirësimi i qasjes në informata për llojet e shërbimeve sociale për fëmijë në Komunë
	Bëhet ekzaminimi/evidentimi i shërbimeve ndaj fëmijëve në Komunë.
	Zhvillohet katalogu digjital i llojeve të shërbimeve komunale dhe ofruesve të shërbimeve.
	Organizohet një fushatë informuese përmes institucioneve publike, medias lokale, ueb faqes së komunës dhe kanaleve tjera të komunikimit.
1.2	Ndarja e fondit për fëmijët në rrethana të jashtëzakonshme
	Identifikohen nevojat për shërbime emergjente.
	Krijohet një sistem për menaxhimin e financimit dhe shërbimeve emergjente.
	Kontraktohen operatorët ekonomikë për ofrimin e shërbimeve emergjente për fëmijët (si: mallëra, ushqim, transport, etj.).
1.	Zhvillimi i praktikave të prindërimit të mirë dhe disiplinimit pozitiv
	Përshtaten modulet/praktikat ekzistuese të prindërimit të mirë për nevoja të komunitetit.
	Krijohen kapacitetet njerëzore për ofrimin e moduleve të trajnimit (trajnim i trajnerëve), p.sh. psikologët në shkolla, edukatorët, profesionistët shëndetësorë, etj.
	Shpërndahen praktikat e prindërimit të mirë përmes trajnimeve/sesioneve informuese.
1.5	Krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët për ta regjistruar, vijuar dhe përfunduar shkollën
	Bashkëpunohet me zyrën e regjistrimit civil dhe merren informata për të gjithë fëmijëve të moshës shkollore të zonës.
	Regjistrohen nxënësit duke respektuar rregulloren komunale.
	Mirëmbahet baza e të dhënave me të dhëna për nxënësit sipas modelit SMIA-s.
	Funksionalizohen Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM).

	Bashkëpunohet ngushtë me organizatat që punojnë në fushën e gjithëpërfshirjes në arsim.
1.6	Ofrimi i shërbimeve profesionale nëpër shkolla
	Trajnohen mësime dhënë për identifikimin e hershëm të fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale pedagogjike dhe psikologjike.
	Krijohet/funksionalizohet mekanizmi për referimin e fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale.
	Identifikohen nevojat për mësime dhënë mbështetës dhe asistentë për fëmijët me aftësi të kufizuara.
	Punësohen mësime dhënë mbështetës dhe asistentë.
1.7	Inspektimi i cilësisë së hapësirave shkollore
	Angazhohen ekipe profesionale për inspektim të gjendjes së shkollave (inspektim të vjetërsisë së objekteve, sanitarisë, hapësirave për lojë e rekreacion, pajisjeve shkollore, etj.).
	Inspektohen objektet shkollore në baza vjetore dhe hartohen raporte.
	Ndërmerren masa përmirësuese bazuar në raportet.
	Promovohen standardet për shkollat mike për fëmijë.
1.8	Krijimi i mekanizmave brenda shkollave për mirëmbajtje të mjediseve shkollore
	Promovohet mirëmbajtja e shkollës tek nxënësit dhe palët tjera.
	Hartohet një udhëzues me praktika të mira të mirëmbajtjes së hapësirave shkollore.
	Realizohen aktivitete kreative me bazë në shkollë për mirëmbajtje të mjediseve.
	Shpërblehen komunitetet më të veshme shkollore.
1.9	Promovimi shëndetësor, përmes informimit, komunikimit dhe edukimit
	Ndërmerret fushatë vetëdijësuese për shëndetin dhe të ushqyerit e foshnjave, fëmijëve dhe adoleshentëve.

	Ofrimi i granteve për organizatat të cilat punojnë në ofrimin e shërbimeve sociale.
	Organizohen ligjërata për edukimin shëndetësor dhe reprodktiv për nxënësit e shkollave, përmes sistemit të ligjëratave të profesionistëve shëndetësorë.
	Organizohen ligjërata për parandalimin e abuzimit me substanca psikotrope.
1.10	Organizimi i vizitave multidisiplinare shëndetësore për fëmijët, në baza periodike
	Zhvillohen kapacitetet e profesionistëve shëndetësorë për kujdes shëndetësor ndaj nënës dhe fëmijës, për këshillim për të ushqyerit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël dhe për përkrahjen e zhvillimit në fëmijërinë e hershme.
	Organizohen vizita sistematike shëndetësore në shtëpi për nënat dhe fëmijët.
	Zbatohen praktikat efektive të kujdesit perinatal.
	Organizohet shërbimi i vizitave sistematike nëpër shtëpi, me komponentin e intervenimit shëndetësor edhe atij edukativ.
	Realizohen kontrollet sistematike shëndetësore nëpër shkolla të nivelit të mesëm të ulët.
1.11	Identifikimi i hershëm i fëmijëve me aftësi të kufizuar
	Përditësohet baza e të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuar.
	Promovohen shërbimet institucionale dhe të ofruesve të tjerë të shërbimeve për fëmijëve me thekst fëmijët me aftësi të kufizuar.
	Hartohet dhe përdoret dokumenti (formulari) për deklarimin e prindit për gjendjen shëndetësore të fëmijës, gjatë regjistrimit në shkollë.
	Rithemelohet dhe funksionalizohet Ekipi vlerësues pedagogjik në komunë.
	Bëhen vlerësime të fëmijëve në nevojë dhe rekomandohen masat që duhet ndërmarrë shkolla (mësimdhënësit, menaxhmenti i shkollës, prindërit, profesionistët psikosocial në shkollë).
1.12	Ofrimi i shërbimeve të veçanta për kategoritë e fëmijëve në nevojë
	Subvencionohen organizatat e licencuara që ofrojnë shërbime shumëdimensionale dhe rehabilitim të bazuar në komunitet, për fëmijët me aftësi të kufizuar.

	Identifikohen nevojat dhe sigurohet qasja fizike e fëmijëve me aftësi të kufizuar në hapësira publike.
	Ofrohen programe të mbështetjes shtesë për fëmijët nga grupet e cënueshme (komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, fëmijët në situatë rruge/lëmoshëkërkesit, fëmijët e përfshirë në forma të rrezikshme të punës ⁸ , fëmijët e trafikuar, etj.), të tilla si mësimi shtesë përmes qendrave mësimore, përfshirja në aktivitete rekreative të qendrave rinore, OJQ-ve dhe akterëve të tjerë relevantë, sesione këshillimi, etj.
	Avancohet komunikimi ndërmjet palëve kryesore (Qendrës për Punë Sociale, Kujdesit Parësor Shëndetësor, Personelit Arsimor, Policisë, Gjykatës, Organizatave Joqeveritare, etj) për një referim dhe kujdes ndaj fëmijëve në nevojë.
2	Vetëdijësimi dhe avokimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve
2.1	Ngritja e kapaciteteve të politikëbërësve dhe zyrtarëve komunalë lidhur me të drejtat të fëmijëve
	Ofrohen trajnimet për politikëbërësit dhe zyrtarët komunalë në fushën e të drejtave dhe mirëqenies së fëmijës.
2.2	Organizimi i fushatave vetëdijësuese për të rriturit dhe për fëmijët
	Planifikohen dhe organizohen fushatat vetëdijësuese dhe shpërndahet material promovues për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtat e tyre.
2.3	Mbështetja e Organizatave joqeveritare, Asamblesë Komunale të Fëmijëve, Këshillit të Nxënësve dhe institucioneve të pavarura në avokimin për të drejtat e fëmijës
	Përkrahet puna e organizatave joqeveritare, koalicionëve e rrjeteve që monitorojnë, promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve.
	Mundësohet dhe përkrahet puna e vetë strukturave organizative të fëmijëve dhe të rinjve.
2.4	Promovimi i të drejtave të fëmijës përmes medias
	Ofrohen udhëzues dhe trajnime për zyren komunale për marrëdhënie me publikun, për sekretariatit e Ekipit dhe mediat e profesionistët e mediave të shkruara dhe elektronike.

⁸ Udhëzim Administrativ (Qrk) - Nr. 02/ 2024 Për Parandalimin Dhe Ndalimin E Formave Të Rrezikshme Të Punës Së Fëmijëve Në Kosovë <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=89068>

	Përkrahen mediat që të promovojnë të drejtat e fëmijëve dhe që të paraqesin gjendjen e fëmijëve në mënyrë transparente e reale.
2.5	Zbatimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës në të gjitha Institucionet parauniversitare
	Harmonizohet politikat e Komunës në raport me Politikën për Mbrojtjen e Fëmijës në të gjitha Institucionet parauniversitare publike dhe private.
3	Sigurimi i hapësirave publike të sigurta dhe miqësore për fëmijët
3.1	Sigurimi i sistemit të trafikut që është i sigurt dhe miqësor për fëmijët
	Hartohen dhe realizohen projekte për lirim të trotuareve dhe vendkalimeve për këmbësorë, vendosjen e shenjave të vendkalimeve, vendosjen e barrierave, dhe sigurimin e ndriçimit publik.
	Realizohet një fushatë informimi me të gjithë pjesëmarrësit në trafik për sigurinë në trafik.
3.2	Eliminimi i rreziqeve dhe krijimi i mjedisit ekologjik
	Promovohet një linjë komunikimi/raportimi për publikun për raportimin e rreziqeve si dhe merren masa për eliminimin e rreziqeve në afat sa më të shkurtër.
	Merren masa për të parandaluar rreziqet përreth shkollës (personat e paautorizuar, shitja e artikujve të dëmshëm, etj.).
	Menaxhohen/sistemohen qentë endacakë.
	Rritet sipërfaqja e hapësirave të gjelbra e parqeve në qytet, si dhe pyjeve në pjesën rurale.
4	Zhvillimi i aktiviteteve argëtuese dhe edukative për fëmijë (sport, kulturë, edukim joformal, lojë dhe rekreacion
4.1	Promovimi i sportit nëpër shkolla
	Ngriten kapacitetet e përfaqësuesve të shkollave për promovimin e sportit shkollor.
	Krijohen/zvillohen klubet sportive shkollore.
	Organizohen gara sportive mes shkollave me përfaqësim të ndjeshëm gjinor.

4.2	Funksionalizimi i klubeve sportive të kategorive të reja
	Nxitet rekrutimi i fëmijëve djem e vajza nëpër klube sportive.
	Mbështetet komunikimi në mes të klubeve, shkollave dhe prindërve.
	Organizohen kampe për identifikimin e talenteve në sporte.
4.3	Promovimi i artit, kulturës dhe teknologjisë
	Nxitet themelimi/funksionimi i klubeve artistike e kulturore nëpër shkolla.
	Organizohen aktivitete të përbashkëta të klubeve artistike e kulturore të shkollave dhe të OshC-të përfshi të artit e kulturës si teatro, ansamble të këngëve e valleve, klube letrare, etj.
	Promovohen dhe ofrohen më shumë hapësira nëpër shkolla e gjetiu që fëmijët të zhvillojnë shkathtësitë teknologjike si: programim, kodim, ueb dizajn, etj.
4.4	Ofrimi i hapësirave joformale për rekreacion
	Inspektohen parqet ekzistuese dhe identifikohen nevojat për hapësira shtesë për lojë.
	Intervenohet në adaptimin e hapësirave ekzistuese për lojë dhe në ndërtimin e hapësirave të reja në përputhje me standardet e hapësirave të sigurta, mike dhe gjithëpërfshirëse për fëmijë.
	Krijohen ekipet e përbashkëta komunitare për mirëmbajtjen e hapësirave rekreative.
4.5	Angazhimi vullnetar i fëmijëve në aktivitete në të mirë të komunitetit
	Organizohen kampe të natyrës rekreative, edukative, mjedisore, etj. për fëmijët e shkollave dhe organizatave të fëmijëve.
	Organizohen vizita e takime në institucione për mbrojtjen e të drejtave të njeriut/fëmijëve.
	Angazhohen fëmijët dhe të rinjtë në aktivitete në përfitim të komunitetit (mbjellja e drunjëve, ofrimi i ndihmës së parë, evakuimi, siguria në trafik).
5	Sigurimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse për çështjet që lidhen me jetën e tyre

5.1	Përcaktimi dhe zbatimi i procedurave për përfshirjen e fëmijëve në proceset vendimmarrëse që ndërlidhen me jetën dhe interesin më të mirë të tyre
	Hartohet një udhëzues praktik për procedurat e konsultimit me fëmijë që në fazat e hershme të proceseve vendimmarrëse që ndërlidhen me jetën dhe interesin më të mirë të tyre.
	Monitorohet zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijë.
5.2	Fuqizimi i organeve përfaqësuese të fëmijëve
	Nxitet funksionimi i rregullt dhe demokratik i organeve përfaqësuese të nxënësve në të gjitha nivelet.
	Trajnohen përfaqësuesit/et e nxënësve për udhëheqje dhe aktivizim qytetar.
	Promovohet ndërmjetësimi në mes moshatarëve si qasje për të adresuar problemet, konfliktet, ngacmimet e dhunën në shkollë.
	Do të identifikohen fëmijë që mund të angazhohen si ndërmjetësues dhe të trajnohen për aspekte të ndërmjetësimit në mes moshatarëve.
6	Bashkërendimi i veprimeve të të gjitha palëve përmes procesit të koordinimit, si dhe përmes monitorimit dhe raportimit të zbatimit të Planit
6.1	Monitorimi dhe Vlerësimi
	Monitorohet situata, mbledhen të dhëna dhe bëhet vlerësimi periodik i të gjitha aspekteve të qeverisjes, ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale dhe aspekteve të planit të punës për të drejtat e fëmijës.
	Diskutohen raportet në nivel të ekipit komunal dhe po ashtu përfshihen në politikat dhe praktikatat të qeverisjes lokale.
6.2	Koordinimi me palët relevante
	Realizohen takime në baza tre mujore për koordinim ndërsektorial me politikbërësit, vendimmarrësit dhe akterët e tjerë relevant.
6.3	Vlerësimi dhe raportimi
	Bëhet vlerësimi periodik (çdo 6 muaj) i zbatimit të planit të punës dhe hartohet raporti për MAPL dhe ZQM.

Bëhet vlerësimi përfundimtar i zbatimit të planit të punës dhe hartohet raporti përfundimtar.

SHTOJCA: PLANI I DETAJUAR I VEPRIMIT

Plani i detajuar i veprimit (me hartësit, shtrirjen kohore, nevojat buxhetore dhe burimet e financimit) është dhënë si shtojcë në një dokument Exceli.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.60/25
Me datë:30.05.2025

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit

[illegible]

Realizimet taktike në baza të mëjorjeve të ndërtimit ndërmarrjet me politikat, vendimmarrjet dhe aktivitetet të ndërmarrjes		Pazaret / tabelat të realiteteve për bërëqet dhe risat / sistematizim nga pazaret dhe aktivitetet e ndërmarrjes, si dhe aktivitetet / pajtuesit të diskutuar nga pazaret		Zyra e Kryetarit të Komitës, Sekretariatit / Elitës		Pa kostë									
6.3. Mësimi dhe Raportimi / plani të punës						40.00									
Bëhet meqen se rezultatet dhe raportimi në baza të mëjorjeve në MPP		Raportet e përgjithshme dhe do të jenë në MPP, në përputhje të fortë, dhe risat / pajtuesit të ndërmarrjes të raportit. Raportet e përgjithshme dhe të kështu		Zyra e Kryetarit të Komitës, Sekretariatit / Elitës		Pa kostë									
TOTAL						#####									

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 00.06.2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim **SHFUQIZOHET** vendimi me nr. prot. 01 nr. 47/25, i datës 29.4.2025 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV).
2. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *MAPL-së,*
- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr. ____/25
Datë:00.06.2025

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), Planit Zhvillimor Komunal (PZhK) 2023-2031 me Nr. Prot. 01 Nr. 182/24, i datës 30.1.2024, nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit, me Nr. Prot. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.04.2025, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV)

1. Miratohet propozimi i kryetarit të Komunës, me nr. prot. 02/5421/25, i datës 18.03.2025 dhe merret vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV).
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në parcelën kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-02240-81 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2000m² (dy mijë metra katror), Zona Kadastrale Rahovec, e evidentuar në emër të Komunës së Rahovecit, parcela me nr.02240-81 do të ndahet dhe formohet parcela me numër të ri. Parcela në fjalë do të jepet në shfrytëzim drejtorisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural.
3. Parcela e cekur në pikën 2 të këtij vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZhK) 2023-2031 me Nr. Prot. 01 Nr. 182/24, i datës 30.1.2024, ka destinim: 3. Prodhim tretësor/ 31. Shërbim tregtar/ 311. Shërbim tregtar me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake.
4. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo i çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
5. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë regjistrimin e gjendjes në librat kadastrale.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 01 Nr. 29/25 i datës 28.03.2025.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284

për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadashtëri dhe Pronë,
- MAPL-së, dhe
- Arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.47/25
Me datë:29.04.2025

Arbër Zenuni
Kryesues i Kuvendit





Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), Planit Zhvillimor Komunal (PZhK) 01 Nr. 2566, i datës 30.5.2013, nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit, me Nr. Prot. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.03.2025, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV)

1. Miratohet propozimi i kryetarit të Komunës, me nr. prot. 02/5421/25, i datës 18.03.2025 dhe merret vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV).
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në parcelën kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-02240-81 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2000m² (dy mijë metra katror), Zona Kadastrale Rahovec, e evidentuar në cënër të Komunës së Rahovecit, parcela me nr. 02240-81 do të ndahet dhe formohet parcela me numër të ri. Parcela në fjalë do të jepet në shfrytëzim drejtorisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural.
3. Parcela e cekur në pikën 2 të këtij vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZhK) 2023-2031 me Nr. Prot. 01 Nr. 182/24, i datës 30.1.2024, ka destinimin: 3. Prodhim tretësor/ 31. Shërbim tregtar/ 311. Shërbim tregtar me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake.
4. Prona e palunjtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo i çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
5. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë regjistrimin e gjendjes në librat kadastrale.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Aktëve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve cse faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadestër dhe Pronë,
- MAPL-së, dhe
- Arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.29/25
Me datë:28.03.2025





Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration

No. (Faqe) 02
No. (Faqe) 02
No. (Faqe) 02
No. (Faqe) 02

No. (Faqe) 3763-2/19
No. (Faqe) 28.05.25
No. (Faqe) 28.05.25
No. (Faqe) 28.05.25

PRISHTINE / A No. 1

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration

Data 29.05.2025
Data 29.05.2025
Data 29.05.2025
Data 29.05.2025

No. (Faqe) 020-272/4
No. (Faqe) 020-272/4
No. (Faqe) 020-272/4
No. (Faqe) 020-272/4

Për:	Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit, Arbër Zenuni, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Detyrë i MAPL Jeton Qela, UD. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër në Detyrë i MMPHI Izedin Bytyqi, UD. Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Shendrita Latifi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin 1. Zyrtari konfirmues vlerësimit ligjor për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit dhe 2. Zyrtari hartues vlerësimit ligjor për Mbështetjes Ligjore
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), miratuar nga Kuvendi Komunal i Rahovecit, datë 29.04.2025.

I nderuar kryetar Latifi,
I nderuar kryesues Zenuni

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, (MMPHI) në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 08.05.2025 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), miratuar nga Kuvendi Komunal i Rahovecit, datë 29.04.2025.

MMPHI pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Rahovecit:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISE SË AKTIT

Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), miratuar nga Kuvendi Komunal i Rahovecit, datë 29.04.2025.

ARSYETIMI

MMPHI pas shqyrtimit të vendimit të lartëcekur konstatoi se:

Pika 3 e vendimit ku thuhet se: Parcela e cekur në pikën 2 të këtij vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZhK) 2023-2031 me Nr. Prot. 01 Nr. 182/24, i datës 30.01.2024, ka destinim: 3. Prodhim tretësor 3.1. Shërbim tregtar/3.1.1. Shërbim tregtar me shumicë dhe pakicë dhe riparim i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiaçe, shfrytëzimi nuk përputhet me shfrytëzimin për ndërtimin e objektit për nevojat e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë.

Poashtu, Plani Zhvillimor Komunal është dokument strategjik, me të cilin nuk mund të lëshohen kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore.

Megjithatë projekti në fjalë është investim për nevoja shtetërore, Komuna e Rahovecit është në procedurë të hartimit të Hartës Zonale të Komunës dhe kërkesa e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë mund të merret parasysh dhe trajtohet nga autoriteti përgjegjës komunal gjatë kësaj faze.

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat hgyore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.